

TRANZICION I BRISHTË NË KOSOVË

Raport për Evropë Nr. 196 – 25 shtator 2008

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	i
I. HYRJE.....	1
II. NGA “TRANZICIONI” NË “RIKONFIGURIM”	3
A. TRANZICIONI I PAPLOTËSUAR	3
1. Fitimet e serbëve të Kosovës në veri të Ibrit	3
2. Zbarkimi civil ndërkombëtar	7
B. A PO ZBEHET VULLNETI POLITIK NË KRYEQYTETET EVROPIANE?	11
C. PENGESAT NË NJU JORK.....	14
D. PROPOZIMI I BAN KI-MOON-IT PËR RIKONFIGURIM	16
III. SITUATA NË TERREN	19
A. HAPAT E PARË SHITET-FORMUES TË PRISHTINËS	19
1. Ligjëbërja.....	19
2. Qeverisja.....	20
3. Ruajtja e stabilitetit	23
4. Raporti me serbët.....	25
5. Enklavat e serbëve të Kosovës	27
B. TAKTIKAT E QEVERISË SË RE TË SERBISË	28
IV. SI TË FUNKSIONOJË RIKONFIGURIMI.....	31
A. PËRPJEKJET PËR RIKONFIGURIM.....	31
1. Roli i OKB-së	31
2. Roli i BE-së	33
3. Puna me Beogradin.....	34
B. SFIDAT E ZBARKIMIT	35
1. Gjykatat	35
2. Policia	36
3. Doganat.....	37
4. Administrata civile	39
APPENDIKSET	
A. HARTA E KOSOVËS DHE RAJONI	41
B. LISTA E SHKURTESAVE.....	42

TRANZICION I BRISHTË NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Kosova ka ndërmarrë hapat e parë drejt shtet-ndërtimit, mirëpo komuniteti ndërkombëtar nuk i ka përmbushur zotimet e veta për ofrimin e një përkrahjeje adekuate. Edhe pse marrëveshja për misionin mbi sundimin e ligjit (EULEX), si operacioni më i madh i BE-së për politikën evropiane për siguri dhe mbrojtje (PESM), është arritur në shkurt 2008, ai vetëm rishtazi ka filluar të fillojë punën e vet. Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN), e paraparë që të mbikëqyrë pavarësinë, është vetëm një guackë. OKB-ja ende funksionon pjesërisht si administratë e përkohshme, e cila negocion marrëveshje me Beogradin për serbët e Kosovës. Plani i Ahtisaarit, në bazë të të cilit 47 shtete kanë njohur Kosovën, është zhvlerësuar nga organizatat ndërkombëtare të cilat janë të parapara të ndihmojnë në implementimin e tij. BE-ja dhe ShBA-të po përballen me vështirësi me përpjekjet e Rusisë për të përshkruar përkrahjen e saj për rajonet secesioniste në Gjeorgji si pasqyrim i asaj që ata kanë bërë në Kosovë. Tani është më se urgjente që para fundit të vitit BE-ja ta operacionalizojë plotësisht EULEX-in, dhe të përdorë ndikimin e saj në qeverinë e Beogradit, e cila dëshiron anëtarësim, që të fillojë me lehtësime pragmatike ndaj statusit të ri të Kosovës.

Është shmangur dhuna e madhe, është premtuar 1.2 miliardë euro në ndihma, dhe janë ndërmarrë masat e para tentative drejt prodhimit të një shtetësie efektive. Por sipërfaqja e qetë është mashtruese. Ndarjet në mes pjesëve shqiptare dhe serbe janë rritur, ndërsa planet për një shtet të unifikuar po avullohen. Nëse de facto ndarja përforcohet, do të jetë problematike e ardhmja e dy të tretave të serbëve të Kosovës të cilët jetojnë në jug të vijës ndarëse përgjatë lumit Ibër, do të rritet presioni për rivendosjen e kufijve përgjatë vijave etnike nëpër tërë ish-Jugosllavinë, ndërsa do të mjegullohen edhe më tej planet për anëtarësim në BE për vendet e rajonit.

Sfidimi serb është përforcuar edhe më tej në veri të Ibrit, atje ku gjykatat, postet kufitare dhe të doganave të Kosovës nuk operojnë, gjersa serbët e Kosovës vazhdojnë të refuzojnë bashkëpunimin me institucionet e Kosovës apo BE-në. Më 11 maj Serbia organizoi zgjedhje në Kosovë, të cilat sollën autoritete të reja komunale në rajonet serbe, në kundërshtim me udhëzimet eksplicite të Përfaqësuesit Special të OKB-së.

Prishtina reagoi me durim, duke pritur që BE-ja të kthejë këto zhvillime mbrapa, mirëpo shpresat e saj janë tepër të mëdha.

EULEX-i ka në terren vetëm një të katërtën e personelit 2,000 anëtarësh, që planifikohet të ketë. Duke mos dashur të ballafaqohet me armiqësi në rajonet serbe, ka bërë një paraqitje të paktë nëpër tërë Kosovën, në mënyrë që t'i shmanget rritjes së ndarjes gjeografike të operacioneve ndërkombëtare. BE-ja dhe OKB-ja mund të kenë më shumë suksese në arritjen e kompromiseve me qeverinë e re dhe më të afërt ndaj BE-së të Beogradit, mirëpo liderët serbë të Kosovës janë të afërt me partitë tani opozitare të Serbisë – DSS-në dhe atë Radikale, ndërsa Presidenti Tadiq ka hapësirë të kufizuar për manovrim.

Pas disa muajsh pavendosmërie, Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon lajmëroi në qershor fillimin e rikonfigurimit të Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK), duke i hapur dyert kështu transferimit të mjeteve dhe objekteve të OKB-së. Më 23 qershor filluan diskutimet ndërmjet UNMIK-ut dhe Beogradit në gjashtë fusha të qeverisjes në rajonet serbe të Kosovës, përfshirë policinë, gjykatat dhe doganat. OKB-ja është goxha optimiste për këto bisedime, por qysh tani ka pasur vonesa. Tani që teknikalitetet e rikonfigurimit OKB/BE u pranuan më 18 gusht, është e nevojshme që BE-ja të zbarkojë plotësisht në Kosovë dhe të bëhet operacionale deri më 1 dhjetor, të fillojë punën në veri nën çadrën e OKB-së dhe të vendosë Peter Feith-in, përfaqësuesin e saj special (PSBE), figurën ndërkombëtare autoritative, si kryesues të ZCN-së.

Fusha më e ndjeshme është veriu i Ibrit, ku të gjitha palët duhet të pajtohen në aranzhimet tranzitore të cilat duhet të rishikoheshin jo më vonë se në fillim të vitit 2010, atëherë kur do të rishqyrtohen kompetencat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN). Në efekt, kjo do të thotë suspendim i përkohshëm i kushtetutës në një pjesë të territorit të Kosovës, derisa EULEX-i të punojë nën çadrën e UNMIK-ut si ndërmjetësues në mes të serbëve të Kosovës dhe Prishtinës; të bëjë rihapjen e gjykatave, ku do të zbatohet përkohësisht ligji i UNMIK-ut; të vazhdojë modelin e policimit të

UNMIK-ut atje; dhe të mbikëqyrë administrimin e doganave pa simbole të Kosovës nën një aranzhim të ndarjeve të të ardhurave ndërmjet Prishtinës dhe katër komunave veriore, gjë që do t'i jipte këtyre të fundit një shtysë për t'iu përmbajtur aranzhimit.

Që nga qershori Serbia ka qeveri të re me prioritete kundërthënëse. Presidenti Tadiq dëshiron të punojë në Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim (MSA), të cilën BE-ja e nënshkruajti me të dy javë para zgjedhjeve të majit, në mënyrë që të përshpejtohet progresi i statusit për kandidat anëtarësie, si dhe ai i liberalizimit të vizave. Mirëpo qeveria e tij, megjithëse me një ton më të butë dhe më e anueshme drejt metodave diplomatike sesa paraardhësja e saj, mund të jetë po aq e vendosur që të mos humbasë Kosovën. Ajo dëshiron një prani të OKB-së e jo të BE-së në pjesët serbe të Kosovës, dhe ende nuk e pranon, nuk e definon dhe nuk e kontrollon kufirin e saj jugor. Ajo është duke i bërë presion Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që të kërkojë mendimin këshillëdhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mbi legalitetin e shpalljes së pavarësisë nga Prishtina. Në fund, këto kundëthënie janë të paqëndrueshme. Beogradi dhe Brukseli së shpejti duhet të adresojnë çështjen e Kosovës, nëse mendojnë seriozisht për perspektivat e Serbisë në BE. Në ato bisedime, BE-ja duhet të shfrytëzojë në mënyrë strategjike procesin e anëtarësimit të Serbisë, në mënyrë që të sigurojë zbarkimin e misioneve të saj në tërë Kosovën, si dhe të përgatisë Serbinë që, edhe nëse nuk e njeh formalisht, të mësohet me statusin e ri të ish-territorit të saj.

Kosova po tregohet test i vështirë për politikën e BE-së për siguri dhe mbrojtje. Vullneti politik që ishte arritur para vendimit të përbashkët të shkurtit për vendosjen e EULEX-it dhe PSBE-së, është duke u hapërdarë. Në kohën kur BE-ja është e kyçur në bisedime të rënda me Rusinë mbi vendosjen e një misioni të ri të PESM-it në Gjeorgji, do të ishte e rrezikshme nëse tregohet pavendosmëri këtu tani.

Efektet e ngjarjeve në Gjeorgji akoma nuk janë të qarta për Kosovën, pasi Rusia kishte përmendur aksionet perëndimore në Kosovë si pjesë të arsyes së saj për njohjen unilaterale të territoreve secesioniste të Osetisë Jugore dhe Abhazisë si të pavarura. Moska mund të jetë më e gatshme se kurrë që të demonstrojë kapacitetet e saj bllokuese në OKB, dhe të dëshirojë inkurajimin e fragmentimit territorial në fqinjësinë e BE-së; ose mund të jetë e gatshme të tregojë anën e saj bashkëpunuese pasi të ketë demonstruar vetëbesimin e saj të ri dhe shqetësues. Tani është më e nevojshme se kurrë që BE-ja të zotërojë një politikë të fuqishme të jashtme dhe të sigurisë në fqinjësinë e saj të afërt.

REKOMANDIMET

Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian:

1. Të vendoset EULEX në plotësi jo më vonë se më 1 dhjetor.
2. T'i jipet Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar/Përfaqësuesit Special të BE-së (PCN/PSBE) përkrahje e plotë politike, pa bërë dallime në mes të dy roleve.
3. Të riafirmohet përkushtimi për implementimin e propozimit gjithëpërfshirës të planit të Ahtisaarit për Kosovën.
4. Të insistohet që Kosova të jetë lartë në agjendë kur të diskutohen hapat e ardhshëm me Serbinë, pas nënshkrimit të MSA-së.

Sekretariatit të OKB-së dhe UNMIK-ut:

5. Të insistohet në bisedimet për rikonfigurim me Serbinë sa i përket vendosjes në tërë Kosovën të EULEX-it, dhe sa më parë të sillen përfaqësuesit e BE-së në këto bisedime.
6. Të reduktohet UNMIK-u edhe më tej, pas tkurrjes prej 70% të planifikuar për nëntor 2008, në një prani të vogël raportuese, monitoruese dhe ndërlihdhëse, të përbërë nga më pak se 100 punëtorë, deri në fillim të vitit 2009.
7. T'i ofrohen Serbisë vetëm aso lloj kompromisesh gjatë bisedimeve mbi aranzhimet specifike për serbët e Kosovës, përderisa ato të jenë konsistente me mandatin e ZCN/PSBE-së, të kontribuojnë në vendosjen e EULEX-it dhe të ofrojnë zgjidhje praktike dhe të përkohshme, për t'u rishqyrtuar jo më vonë se në fillim të vitit 2010, dhe në veçanti të kërkohet që:
 - (a) të zëvendësohet komandanti i UNMIK-ut për policinë rajonale të Mitrovicës me një nga EULEX-i, përderisa anëtarëve serbë të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK) në pjesët me shumicë serbe në jug të Ibrit t'u ofrohet një strukturë konsultative e zyrtarëve të EULEX-it si një ndërlidhje opsionale me zënxhirin e tyre komandues të ShPK-së, rajonal dhe të Prishtinës;
 - (b) të rihapen gjykatat në veri të Ibrit, me gjykatës dhe prokurorë të EULEX-it karshi gjyqtarëve vendas, me zbatim të ligjit të UNMIK-ut; dhe
 - (c) të rregullohet që EULEX-i të mbikëqyrë administrimin e trafikut komercial nëpër dy portat e veriut, ndërsa doganat të bëjnë zbrazen e depove në kufi, dhe të bëhet ndarja e të ard-

hurave të doganave sipas një formule në pajtim ndërmjet buxhetit të Kosovës dhe katër komunave në veri të Ibrit.

Qeverisë së Kosovës:

8. Të ndërtohen dhe të mirëmbahen institucionet shtetërore dhe publike si organe llogaridhënëse, profesionale, objektive, të pavarura nga patronazhi dhe kontrolli i partive politike.
9. Të akomodohen aranzhime tranzitore njëvjeçare për policinë, gjykatat dhe doganat në pjesët me shumicë serbe, ashtu siç u përshkrua më lartë.
10. Të kyçen serbët e Kosovës në dizajnin dhe implementimin e dispozitave të decentralizimit.

Qeverisë së Serbisë dhe përfaqësuesve serbë të Kosovës:

11. Të takohen me PCN/PSBE-në, EULEX-in dhe përfaqësues tjerë të BE-së, për të rregulluar operacionizimin e plotë të dy misionëve, dhe për të siguruar pranimin e tyre nga serbët e Kosovës.

12. Të pranohen aranzhimet tranzitore, siç u rekomandua më lartë.
13. Të pranohen dispozitat për decentralizim të planit të Ahtisaarit si “neutrale ndaj statusit”, dhe të punohet me homologët e bazuar në Prishtinë, për të siguruar dobitë e tyre për serbët e Kosovës.

NATO-s:

14. Të finalizohen katër marrëveshjet teknike mbi bashkëpunimin e KFOR-it me EULEX-in, dhe të ofrohet përkrahje e fuqishme për atë mision të BE-së, e në veçanti mbrojtje për zbarkimin dhe operacionet e saj në veri të Ibrit.
15. Të vendoset plotësisht ekipi trajnues Këshilla Ushtarake Civile (KUC), dhe ajo të financojë dhe pajisë krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Prishtinë/Bruksel, 25 shtator 2008

TRANZICION I BRISHTË NË KOSOVË

I. HYRJE

Kosova ka qenë kryesisht paqësore dhe stabile që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008, mirëpo komuniteti ndërkombëtar ende nuk e ka gjetur qëndrimin e vet. Pavarësia është dashur të jetë e mbikëqyruar ndërkombëtarisht, në bazë të detajeve të “Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, të hartuar nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.¹ Plani i Ahtisaarit nuk mori pajtimin e Këshillit të Sigurimit, por ai është udhëzimi autoritativ për shtet-ndërtim, i zbatuar nga Kosova dhe përkrahësit e saj. Qeveria në Prishtinë është zotuar që ta implementojë atë, ndërsa të 47 vendet që e kanë njohur shtetin e ri, kanë vepruar kështu kryesisht në bazë të atij përkushtimi. Mirëpo deri më tani përkrahësit e Kosovës vetë kanë dështuar së respektuari zotimet e tyre ndaj planit të Ahtisaarit, për arsye të kundërshtimeve nga Serbia dhe Rusia, por edhe për arsye të vullnetit të pamjaftueshëm politik dhe dështimit për koordinim të plotë.

Plani i Ahtisaarit definoi një periudhë tranzitore 120-diëtshe, gjatë të cilës parashikohej që:

- qeveria e Kosovës të përgatiste kornizën ligjore, të nevojshme për të qeverisur;
- administrimi i përkohshëm tetëvjeçar i OKB-së (UNMIK) të transferonte tërë autoritetin e tij legjislativ dhe ekzekutiv;
- misioni për sundimin e ligjit (EULEX) i Bashkimit Evropian (BE) të vendosej, për të ofruar përkrahje vitale për siguri dhe qeverisje në tërë Kosovën,

¹ Ahtisaari, ish-presidenti finlandez, ia prezantoi dy dokumente Sekretarit të Përgjithshëm në mes të marsit 2007: “Raportin e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Statusin e Ardhshëm të Kosovës” prej katër faqesh, dhe “Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” prej 60 faqesh. Shprehjet “plan” dhe plani i Ahtisaarit” përdoren në tërë këtë raport, për t’iu referuar skemës së përgjithshme që përmban Raporti i Ahtisaarit dhe Propozimi i Ahtisaarit, të lexuara së bashku. Këto dy dokumente origjinale mund të gjenden në www.unosek.org/docref/report-english.pdf dhe www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf.

me një forcë policore kundër trazirave prej 550 policëve, dhe me mandat për të marrë kompetenca ekzekutive kur është e domosdoshme; dhe

- Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN, i cili kryeson Zyrën Civile Ndërkombëtare, ZCN, dhe ka “kapelë të dyfishtë” si Përfaqësues Special i BE-së, PSBE) të fillonte monitorimin e implementimit të planit të Ahtisaarit.

Nga 17 shkurti deri më 15 qershor, kur kjo periudhë tranzitore përfundoi me ardhjen në fuqi të kushtetutës së Kosovës, qeveria miratoi 41 ligje kyçe, mirëpo OKB-ja nuk u tërhoq, PCN-ja nuk mori rolin udhëheqës dhe EULEX-i nuk u zbankua plotësisht.

Vonesa ndodhi kryesisht sepse, pas shpalljes së pavarësisë, Rusia insistoi se çfarëdo ndryshimi i operacioneve të UNMIK-ut kishte nevojë për vendim të Këshillit të Sigurimit. OKB-ja suspendoi dorëzimin e përgjegjësive dhe mjeteve, të parapara për t’i shkuar BE-së. Në terren, pjesa me shumicë serbe në veri të lumit Ibër u bë tepër armiqësore për BE-në. Një përleshje ndërmjet serbëve dhe forcave ndërkombëtare më 17 mars 2008 rreth ndërtesës së gjykatës në veri të Mitrovicës, shkaktoi një vdekje dhe 64 lëndime në UNMIK, 24 sosh në KFOR (forca e udhëhequr nga NATO-ja), dhe rreth 70 sosh në mesin e serbëve. Serbët në veri të Kosovës refuzuan që të bashkëpunojnë me EULEX-in dhe ZCN-në, të cilët vështroheshin si agjentë të pavarësisë së Kosovës, ndërsa e pranuan me zor UNMIK-un dhe KFOR-in. Beogradi, i zënë me zgjedhjet e 11 majit dhe formimin e qeverisë deri më 7 korrik, i udhëzoi dy të tretat e serbëve të Kosovës të cilët jetojnë në enklavat në jug të Ibrit, që t’i mbahen të njëjtës vijë. I paaftë që të zbankohet në pjesët serbe, EULEX-i i është shmangur fillimit të operacioneve në pjesën tjetër të vendit, në mënyrë që t’i shmanget ndarjes gjeografike të misionit të tij.

Mu në prag të dështimit të zbankimit dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare, më 12 qershor Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Ban Ki-moon bëri publik një plan, “rikonfigurimin” e UNMIK-ut. Kjo u diskutua në Këshillin e Sigurimit tetë ditë më vonë. Në bazë të udhëzimeve që ai i dërgoi në terren më 25 qershor, si dhe bisedimeve të mëvonshme OKB-BE, filloi periudha e dytë 120-ditëshe – për një proces “rikonfigurimi” që do të zëvendësonte “tranzicionin”. Një zyrtar i lartë i OKB-së

shpjegi: “Na u desh ta kthejmë orën mbrapa në zero... sepse na u desh që të gjithë të pajtoheshin se për çfarë 120 ditësh ishim duke folur”.²

Kjo nuk ka qenë e lehtë. OKB-ja konsideronte të fillonte me udhëzimet e 25 qershorit; data për BE-në ishte 26 qershori. Tek më 18 gusht të dy organizatat arritën një marrëveshje mbi modalitetet e transferimit të mjeteve nga UNMIK-u në EULEX, e cila beson se deri në fund të nëntorit apo fillimi i dhjetorit mund të zbarkojë gjithë stafin e saj ndërkombëtar në Kosovë, por jo domosdoshmërisht edhe nëpër tërë Kosovën.³ Për Prishtinën 15 qershori dhe hyrja në fuqi e kushtetutës ka shënuar fundin e tranzicionit, ndërsa serbët as që kanë njohur fillimin e këtij procesi. OKB-ja dhe BE-ja tani shpresojnë që serbët të lëshojnë pe, ndërsa Prishtina të vazhdojë përkrahjen e saj, në mënyrë që rikonfigurimi 120-ditor të bëhet më i sukseshëm deri në fund të nëntorit.

Ban Ki-moon-i i ofroi EULEX-it “çadrën e UNMIK-ut”, koncept ky që ende mbetet të definohet plotësisht. Ai pohoi se OKB-ja akoma operon nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, dokument ky që shënoi fundin e konfliktit NATO-Serbi më 1999, dhe që filloi periudhën e tutelazhës ndërkombëtare në Kosovë. Ai po ashtu emëroi një përfaqësues special të ri (PSSP), Lamberto Zannier, që të mbikëqyrë rikonfigurimin dhe t’i ofrojë qeverisë serbe mundësinë që ai të negociojë marrëveshje të përkohshme për pjesët me shumicë serbe të Kosovës, në gjashtë fusha: polici, gjyqe, dogana, kufij, trashëgimi fetare, dhe transport e infrastrukturë. Zannier po ashtu duhet të konsultojë qeverinë e Kosovës dhe hisedarët e tjerë ndërkombëtarë.⁴ Ideja është që deri në fund të nëntorit, UNMIK-u të zvogëlohet në një masë të madhe, ndërsa EULEX-i të zbarkohet nëpër tërë Kosovën, mirëpo disa zyrtarë e pranojnë se kjo e fundit nuk do të mund të hyjë në veri të Ibrit të paktën deri në fillim të vitit 2009.⁵

Prishtina pak a shumë e ka pranuar vonesën e rikonfigurimit, por sfidat mbesin të mëdha. Rusia thotë se rikonfigurimi është i paligjshëm pa aprovim të Këshillit të Sigurimit, dhe se Ban ka tejkaluar autoritetin e tij. Serbët në veri të Kosovës tregojnë pak gatishmëri që të

bashkëpunojnë me BE-në,⁶ anipse disa nëpër enklava kanë shfaqur interes.⁷ Doganat dhe gjyqet e Kosovës nuk funksionojnë aspak në veriun serb, edhe pse ekzistojnë planet për vendosjen e gjyqësisë së UNMIK-ut në veri të Mitrovicës, ndërsa policia është joefektive atje. Qindra zyrtarë serbë nëpër enklava refuzojnë që të punojnë nën zinxhirin komandues të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), mirëpo kolegët e tyre në komunën me shumicë serbë të Shtërpces dhe shumë të tjerë në pjesët me pakicë serbe, vazhdojnë të punojnë. Është e vetmja qeveria e koalicionit pro BE-së, e formuar më 7 korrik – e përbërë nga Partia Demokratike (DS) dhe Partia Socialiste e Serbisë (SPS) – ajo që ofron shpresë se Beogradi eventualisht mund të bëhet më fleksibil.

Misioni i UNMIK-ut është i zbrazët, pasi që ka humbur pjesën më të madhe të legjitimitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës, kështu që ajo nuk mund të vazhdojë me shumicën e funksioneve të saj ekzekutive si para pavarësisë. Sektori i sigurisë, institucionet e sundimit të ligjit dhe shërbimet e doganave janë të brishta dhe kanë nevojë për monitorim, ndërtim të kapaciteteve dhe përkrahje, e cila mendohet që të ofrohet nga ZCN dhe EULEX. Koordinimi ndërmjet pranive të ndryshme ndërkombëtare është problematik, ku udhëheqësia e PCN-së është duke munguar. Vetë Kosova vazhdon të jetë thellësisht e ndarë në mes shqiptarëve dhe serbëve, në mes të territoreve të saja në veri dhe jug të Ibrit. Akoma është urgjente nevoja për decentralizim sipas planit të Ahtisaarit, në mënyrë që të ndërtohet besimi në institucionet e Kosovës në mesin e serbëve të Kosovës, dhe që të parandalohet përforcimi i ndarjes.

² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i EULEX-it, Bruksel, maj 2008.

³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 26 gusht 2008.

⁴ Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm Administrativ të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), S/2008/354, 12 June 2008, në www.un.org/Docs/sc/sgrep08.htm.

⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, gusht dhe shtator 2008.

⁶ Edhe pse liderët ekstremistë atje vazhdojnë të denoncojnë EULEX-in, më 8 shtator gjashtë gjykatës dhe prokurorë dhe katër avokatë serbë pranuan të takoheshin me zyrtarët e EULEX-it në gjykatën e Vushtrrisë. Intervistë e Grupit të Krizave, gjykatësi Kapllan Baruti, kryetar i gjykatës rajonale të Mitrovicës, Vushtri, 17 shtator 2008. Nebojsa Joviq, zëvendës i liderit ekstrem në Mitrovicën e veriut Marko Jakshiq, u takua me përfaqësuesit e ZCN-së në maj 2008.

⁷ Gjatë pjesës së dytë të gushtit 2008, shefi i EULEX-it de Kermabon vizitoi në perëndim enklavën e izoluar serbe të Gorazhdencit (ku në dhjetor 2007 serbët ia përgatitën një pritje armiqësore PSSP-së dhe komandantit të KFOR-it), mori mbështetje për EULEX-in nga politikanja e Graçanicës Rada Trajkoviç, dhe pati interesim për bashkëpunim nga serbët në enklavën lindore të Kamenicës. Raportet televizive të lajmeve dhe intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 26 gusht 2008.

II. NGA “TRANZICIONI” NË “RIKONFIGURIM”

Që nga shpallja e pavarësisë Kosova i është shmangur dhunës së madhe, ndërsa tashmë janë ndërmarrë hapat e parë tentativë drejt një shtetësie efektive. Mirëpo refuzimi serb për të njohur situatën e re, si dhe përpjekjet për të ndarë vendin në pjesë me shumicë serbe dhe shqiptare, këto e kanë ngadalësuar tranzicionin paqësor. Aty ku kanë mundur serbët e Kosovës, të përkrahur nga Beogradi, kanë dhënë dorëheqje, i kanë paaftësuar apo zapuar institucionet kyçe – autoritetet komunale, policinë, gjyqet, doganat dhe hekurudhën – si dhe i kanë përforcuar strukturat e veta paralele. Ata refuzojnë që të bashkëpunojnë me prantë e reja të BE-së, ndërsa BE-ja dhe OKB-ja ende nuk kanë formuluar një përgjigje adekuate.

Plani i Ahtisaarit përcaktonte aranzhimet tranzitore (Neni 15) për të rregulluar rolin e Kuvendit të Kosovës, atë të OKB-së dhe PCN-së në 120 ditët e para.⁸ Mirëpo, shumë nga kjo nuk ka shkuar ashtu si është planifikuar. Kuvendi ka miratuar kushtetutë të re, e cila hyri në fuqi më 15 qershor, së bashku me 41 ligje, të gjitha të aprovuara nga PCN-ja. Mirëpo OKB-ja nuk ia dorëzoi të gjitha kompetencat qeverisë dhe pranive tjera ndërkombëtare, përfshirë këtu dhe BE-në. Plani i Ahtisaarit, tashmë i ngadalësuar kur Këshilli i Sigurimit nuk e aprovoi më 2007, tashmë është edhe më shumë i dobësuar. Qeveria e ka miratuar atë, duke i bërë dispozi-tat e saj të forta mbi mbrojtjen e pakicave dhe decentral-izimin e gjerë pjesë të kushtetutës dhe ligjeve që asociohen me to. Mirëpo, problemi me përkrahësit ndërkombëtarë të Kosovës është se ai ishte i dizajnuar që të implementohej në një ambient konsensual, me autoritetin e Këshillit të Sigurimit. Situata politike në terren dhe në Nju Jork është shumë më ndryshe.

A. TRANZICIONI I PAPLOTËSUAR

Problemin më të madh e shkakton territori më shumicë serbë në veri të Ibrit. Serbët e Kosovës kanë paaftësuar apo kanë marrur nën kontroll institucionet strategjike, ndërsa refuzojnë që të punojnë nën autoritetin e Prishtinës ose të BE-së, duke thënë se “nëse nuk i kemi institucionet tona, ne nuk mund të rrimë këtu”.⁹ Nuk ka pasur sfida serioze ndaj strategjisë së Beogradit për krijimin e një realiteti alternativ në pjesët serbe, që për qëllim ka ndarjen e Kosovës si dhe mposhtjen e projektit

të saj për pavarësi. Kjo, së bashku me refuzimin e Serbisë dhe Rusisë që të pranojnë çfarëdo dorëzimi nga OKB-ja te BE-ja, ka ngrirë në një pjesë të madhe tranzicionin gjatë 120 ditëve të para të pavarësisë. Procesi filloi që të përshpejtohet diku në qershor, kur Ban Ki-moon lajmëroi fillimin e rikonfigurimit. Por në negociata me UNMIK-un, Beogradi është duke u munduar të formalizojë kontrollin e tij mbi pjesët me shumicë serbe, duke dashur ta bindë OKB-në që të legjitimojë strukturat ekzistuese dhe duke lejuar ato të rehat të hyjnë nën autoritetin serb.

1. Fitimet e serbëve të Kosovës në veri të Ibrit

Që nga shkurti 2008 serbët e Kosovës, me përkrahje nga Beogradi, kanë zhvatur aq kontroll nga UNMIK-u mbi komunat lokale, policinë, doganat, gjyqësinë dhe 40 km hekurudhë, sa që parandalohet ndonjë dorëzim i tyre nën kontrollin e shqiptarëve të Kosovës. Më veçanërisht, ata kanë marrë përsipër në veri të Ibrit:

Autoritetin komunal. Në maj Serbia organizoi zgjedhje lokale në Kosovë për të parën herë që nga viti 1996, në 23 nga 30 komunat ku jetojnë serbët e Kosovës.¹⁰ UNMIK-u i quajti ato ilegale dhe në kundërshtim me përgjegjësinë e saj nën Rezolutën 1244,¹¹ mirëpo ato vazhduan pa pengesë nga UNMIK-u, KFOR-i apo BE-ja. Kandidatët e Partisë Radikale (SRS) ishin më të suksesshmit; Partia Demokratike e Serbisë (DSS), partia e ish-Kryeministrit, ishte e dyta.

Krijimi i komunave të reja që i janë besnike qeverisë serbe ka qenë më i suksesshmi në administratën veriore të Mitrovicës, në tri komuna në veri të Ibrit, si dhe në komunën malore të Shtërpces në jug. Pasi që serbët bojkotuan zgjedhjet e nëntorit 2007 në Kosovë, PSSP-ja i atëhershëm Joakim Ryker i vazhdoi mandatet e autoriteteve ekzistuese në ato komuna për gjashtë muaj, mirëpo ata në mënyrë unilaterale u larguan nga

¹⁰ Më 1996 ato ishin bojkotuar nga shumica shqiptare.

¹¹ Në një politikë të udhëhequr nga krahu i DSS-së së qeverisë, Beogradi u mundua të bindë UNMIK-un që të pajtohet që Serbia të mbajë zgjedhjet parlamentare dhe komunale, dhe megjithatë vazhdoi me këtë plan kur kjo dështoi. Më 3 prill 2008, ministri për Kosovë i Serbisë, Samarxhiq, e pyeti Rykerin që të konfirmojë vendimin e Beogradit për të organizuar zgjedhjet në Kosovë. Rykeri theksoi se përpjekja unilaterale për të bërë këtë do të ishte “cënim i mandatit tim ekskluziv, ekzekutiv nën Rezolutën 1244”. Samarxhiqi u përgjigj që UNMIK-u duhej të ishte të paktën neutral, ekuivalente me qëndrimin e tij në shpalljen “ilegale” të pavarësisë, por njohu se “zgjedhjet mund të thirren vetëm nga UNMIK-u, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999)”.¹¹ Mirëpo në të vërtetë, UNMIK-u lëshoi pe. Kur Doganat e Kosovës kapën një maunë me material për zgjedhje, UNMIK-u urdhëroi lëshimin e tyre.

⁸ Shih Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisaarit.

⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, lider politik, Mitrovica e veriut, maj 2008.

pozitat para zgjedhjeve të Serbisë më 11 maj. UNMIK-u fillimisht i thirri “ilegale” kuvendet komunale që ishin zgjedhur rishitazi, pastaj nën Zannierin si “jolegitime”, apo thjeshtë “jovalide”, por sidoqoftë ata morën përsipër tërë stafin dhe infrastrukturën e qeverisë lokale në veri të Ibrit. Që atëherë UNMIK-ka e ka zbutur qëndrimin e tij, duke pohuar se “autoritetet e reja dhe paralele komunale tani janë duke operuar”, dhe se “Ministri i Serbisë për Kosovë ka thënë publikisht se ai pret që UNMIK-u t’i njohë ato”.¹² Zannieri është takuar me disa nga përaçësuesit e tyre, mirëpo, insiston ai, vetëm në kapacitetin e tyre si parti politike, dhe se nuk ka takuar asnjë kryetar komune.¹³

Autoriteti i ri komunal në veri të Mitrovicës tregoi muskujt e vet në korrik, duke dashur të detyrojë njohje nga komuna me shumicë shqiptare e Mitrovicës (jug), pas pengimit të projektit për vendosjen e gypave të ujit në Suhadoll, fshat ky me shumicë shqiptare në perëndim të Mitrovicës. Më 2 korrik në Shtërpce kuvendi i ri okupoi pjesë të një prej dy ndërtesave, si dhe vendosi njerëz afër një pengese rrugore për të ndaluar shqiptarët nga ndërtimet e palicencuara të shtëpive afër resorit skijor të Brezovicës, por nuk u përzien në ShPK-në multietnike të komunës, e cila ende i raporton Prishtinës.¹⁴ Ajo bashkëjeton jo lirshëm me rivalët shqiptarë të Kosovës, të zgjedhur në zgjedhjet komunale të Kosovës në nëntor 2007. U përleshën dy herë në gusht, si dhe në shtator, kur serbët provuan pa sukses që të marrin përsipër tokën komunale dhe regjistrat e pronës.¹⁵ Asnjëra palë nuk është e sigurtë për hapin tjetër, dhe nuk do të marrë përgjegjësi për vendime të cilat ato besojnë se duhet të vijnë nga më lartë.¹⁶ Në enklavat e tjera është bërë shumë pak në

drejtim të funksionalizimit të autoriteteve paralele komunale.¹⁷

Një Kuvend Serb për Kosovën u mbledh në veri të Mitrovicës më 28 qershor, për të kundërshtuar kushtetutën e re të Prishtinës, dhe për të rritur ndikimin e DSS-së karshi politikës mbi Kosovës, në kohën kur DS-ja dhe SPS-ja po i afroreshin një koalicioni qeveritar në Serbi. Kuvendi është pjellë e zëvendëskryetarit të DSS-së Marko Jakshiq, lider i Këshillit Nacional Serb-Veri (KNS), i cili efektivisht udhëheqë territorin në veri të Ibrit.¹⁸ Edhe në mesin e serbëve më radikalë në DSS-në e Jakshiqit kishte hezitime që zyrtarisht të konsolidohen pushtetet legjislative dhe ekzekutive në kuvendin e ri. Morën pjesë vetëm 30 nga 45 anëtarët e saj të paralajmëruar; DS-ja qëndroi anash. Pas hyrjes në qeveri, DS-ja e njohu këtë organ, mirëpo e dërgoi vetëm një delegat në seancën e vetme të organizuar gjer më tani.¹⁹

Policimi. Në shkurt, UNMIK-u i tërhoqi nga veriu i Ibrit policët shqiptarë të ShPK-së. ShPK-ja serbe vijoi të për-

¹² Adresimi i PSSP-së Lamberto Zannier Këshillit të Sigurimit, 25 korrik 2008.

¹³ Briefing për shtyp nga PSSP-ja Lamberto Zannier, Prishtinë, 20 gusht 2008.

¹⁴ Kryetari i komunës dhe komunarët serbë nga komuna me 30 për qind shqiptarë, të mandatuar nga UNMIK-u dhe të zgjedhur në zgjedhjet e Kosovës në nëntor 2007, nuk kanë dhënë dorëheqje dhe vazhdojnë në rrinë në ndërtesën e komunës. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në profilin e saj për komuna të prillit 2008 tregon një popullatë të përbërë nga 9,100 serbë, 4,500 shqiptarë dhe 37 romë.

¹⁵ Mungesa e kontrollit të komunës paralele serbe për këtë regjistër shikohet nga shumica e banorëve si barrierë e madhe në efektshmërinë e saj. Intervista me telefon të Grupit të Krizave, zyrtar i DSS-së dhe gazetar serb, Shtërpce, gusht 2008. E njëjta vlen për të gjitha enklavat.

¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar që punon në komunë, 13 gusht 2008, dhe zyrtar e gazetar serb, Shtërpce, 2 shtator 2008.

¹⁷ Lideri i një nisme lokale dhe qytetare serbe që kishte fituar zgjedhjet e majit në Novobërdë, u ankua që asambleja e tij komunale ishte mbledhur vetëm një herë, dhe që ende nuk ishin formuar asnjë departament të pushtetit komunal; komuna ekziston “vetëm në letër” dhe injorohet si nga Beogradi, ashtu dhe nga Prishtina dhe ZCN-ja. Ai nuk ishte në dijeni të vizitës së organizuar nga ZCN-ja për Grupin Udhëheqës Ndërkombëtar në komunë më 12 shtator. Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, 16 shtator 2008. Në Graçanicë të gjitha departamentet janë krijuar dhe mbushur me staf, e megjithatë mund të ketë pak korrespondencë me Beogradin, pasi që “99 për qind të problemeve që njerëzit kanë këtu kërkojnë punë me UNMIK-un, Prishtinën ose organizata tjera”, gjë që nuk mund të ndodhë për momentin, për shkak të mos-njohjes së dyanshme. Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, gazetar serb, Laplasellë, 17 shtator 2008. Në Kamenicë shumica e departamenteve të komunës paralele nuk janë plotësuar me staf, anipse edhe po të ishin të plotësuar “askush nuk do të vërente dallimin”. Edhe pse komuna paralele e Gjilanit është e hapur për biznes në fshatin e Kuscës, në pjesën dërrmuese puna e saj ka të bëjë me lëshim të proklamatave, për shembull duke u bërë thirrje serbëve lokalë të punësuar nga UNMIK-u apo Prishtina që të largohen nga puna, pas së cilës mund të gjenden vende pune me pagesë nga shteti i Serbisë. Ka pasur përgjigje skeptike. Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, mjek serb dhe ish-zyrtar i DSS-së, Kamenicë, 17 shtator 2008.

¹⁸ Shih Raportin e Grupit të Krizave Nr. 165, *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje të Kosovës*, 13 shtator 2005.

¹⁹ Shih “Srpska skupština Kim protiv Euleksa” [“Asambleja serbe e Kosovës dhe Metohisë kundër EULEX-it”], B92, 13 shtator 2008. Pjesëmarrja në seancën e 13 shtatorit ishte më e dobët se mbledhja e inaugurimit në qershor. Erdhën njëzet e gjashtë delegatë, kësaj radhe më pak nga enklavat. Delegati i DS-së nuk foli, ndërsa mocioni kundër EULEX-it kaloi unanimisht. Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, gazetar serb, Mitrovicë e veriut, 22 shtator 2008.

dorë uniformën, mirëpo ndërprejnë çfarëdo kontakti me kolegët shqiptarë dhe zinxhirin komandues të ShPK-së, si dhe filluan t'i raportojnë vetëm Komandantit të Policisë Rajonale të UNMIK-ut në Mitrovicë. ShPK-ja serbe në veri është e kontrolluar kryesisht nga Dragoljub Delibashiq, shefi rajonal i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP), i bazuar në veri të Mitrovicës, i cili i udhëzoi ata që të refuzonin pagat nga buxheti i Kosovës dhe në vend të kësaj të mirrinin pagat që ai i kontrollon nëpërmjet komunave lokale serbe.²⁰ Delibashiqi po ashtu gëzon autoritet mbi praninë civile të MUP-it, të përbërë nga një duzinë oficerësh, e cila ka mbledhur vetëbesim të mjaftueshëm që të organizojë postblloqe rrugore,²¹ si dhe të kontrollojë një grup ushtarakësh rezervistë që ishte themeluar në mes të vitit 2006, e cila gjithashtu është e paguar nëpërmjet komunave.²² Pushteti i tij tani është duke rënë, pasi që afërsia e tij me Jakshiqin po e bën atë më të largët për qeverinë e re të Serbisë,²³ ndërsa ShPK-ja serbe në veri përsëri ka filluar të marrë pagat e tyre nga Prishtina.²⁴

Me praninë dhe patrullimin e KFOR-it, dhe me mbështetjen e dy njësisve policore kundër trazirave të OKB-së, janë 185 policë të UNMIK-ut që punojnë në veri nën komandën e komandantit skocez, të bazuar në jug të Mitrovicës. Ata janë të kujdesshëm dhe punojnë krah për krah me 290 serbë të ShPK-së, të cilët janë lavdëruar për mbajtjen e profesionalizmit të tyre. Menaxherët e mesëm të EULEX-it janë duke punuar në heshtje me homologët e tyre të OKB-së në komandën rajonale të UNMIK-ut në jug të Mitrovicës.²⁵

Doganat. Më 19 shkurt 2008, një grup i organizuar dhe i armatosur serb shkatërroi dy pikat kufitare dhe doganore (Portat 1 and 31), të cilat ndajnë territorin në veri në Ibrit nga Serbia. Që nga atëherë, ShPK-ja serbe, Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i kanë vendosur një prani të sforcuar, por ende nuk kanë rifilluar as kontrollimet e pasaportave e as operacionet doganore. Civilët serbë monitorojnë funksionimin e rrugëve që çojnë atje, ngjashëm me rojtaret e urës,²⁶ dhe përcjellin

automjetet e OKB-së me fytyra të panjohura, e sidomos nëse në to dyshohet të gjenden zyrtarë të doganave apo të EULEX-it.²⁷

48 zyrtarët serbë të shërbimit të UNMIK-ut në veri të Ibrit, stopuan punën e tyre më 19 shkurt, ndërsa formalisht dhanë dorëheqje më 22 maj. Doganat e UNMIK-ut u përpoqën të zëvendësonin vakumin me patrullime të kohëpaskohëshme, por atë vetëm në jug të Ibrit. EULEX-i është i paraparë që të marrë përsipër përgjegjësinë në veri, mirëpo ka dyshime rreth asaj se si do ta arrijë këtë në një ambient armiqësor ku as UNMIK-u nuk ka funksionuar. Serbia favorizon në heshtje rivendosjen graduale të doganave, mirëpo nën UNMIK-un, jo EULEX-in,²⁸ gjersa kryetarët serbë të komunave janë kundër kësaj ideje.²⁹ Serbët vendorë do të mund të bllokoinin me lehtësi rrugën 40-kilometërshe përgjatë luginës, e cila çon nga Mitrovica deri lart në Portën 1, kurse vlerësimi i KFOR-it dhe UNMIK-ut është se rivendosja e doganave në të dy portat pa një marrëveshje, do të rezultonte në një përlëshje të nxehtë sikurse ajo në Mitrovicën e veriut më 17 mars.³⁰ Kjo do ta detyronte qeverinë e re të Serbisë që të mbështesë kundërshtarët e saj politik radikalë në veri të Kosovës. Në gusht Policia e UNMIK-ut ka rivendosur video kamera në njërin nga portat, mirëpo pas protestave të disa qindra serbëve në Zubin Potok, OKB-ja i siguroi kryetarët vendorë komunalë që informatat e marrura aty nuk do të ndaheshin me shërbimin e doganave.³¹

Shërbimet serbe dhe të UNMIK-ut të doganave më parë kishin pasur një bashkëpunim të mirë të ndarjes së informatave, kurse tani kjo e para ende dërgon të dhëna javore, mirëpo Doganat e UNMIK-ut nuk posedojnë më të dhëna për të ndarë.³² Kontrabandimi është duke

mbronin urën kryesore të Mitrovicës nga hyrjet prej shqiptarëve në jug. Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje të Kosovës*.

²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 14 gusht 2008.

²⁸ Sekretari i Shtetit në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi, Oliver Ivanoviq, i intervistuar nga Bukurie Bajraliu, "Ivanoviq: Qeveria e Kosovës nuk do të ketë autoritet në veri", *Koha Ditore*, 24 gusht 2008; dhe të dhënat e një zyrtari ndërkombëtar nga bisedimet e fundit me Ministrin Bogdanoviq, Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 14 gusht 2008.

²⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 14 gusht 2008. Shih "Protesta Srba zbog video-nadzora" ["Protestë serbe për survejimin me video"], B92, 25 gusht 2008.

³⁰ Intervistë të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë të UNMIK-ut dhe KFOR-it, Prishtinë, 28 maj 2008.

³¹ Korrespondencë e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, Prishtinë, 2 shtator 2008.

³² Një zyrtar i lartë i UNMIK-ut u shpreh: "Nuk jam i lumtur për faktin që Doganat e UNMIK-ut marrin më shumë infor-

²⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i policisë së UNMIK-ut, Mitrovicë, 8 maj 2008.

²¹ Shih "Pjesëtarët e MUP-it të Serbisë legjitimojnë nëpër rrugët e veriut", *Koha Ditore*, 6 qershor 2008.

²² Shih Raportin e Grupit të Krizave Nr. 174, *Një ushtri për Kosovës?*, 28 korrik 2006.

²³ Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, gazetar serb, Mitrovicë e veriut, 17 shtator 2008.

²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i ShPK-së, Prishtinë, 12 shtator 2008.

²⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, policia e UNMIK-ut, Mitrovicë, 8 maj 2008.

²⁶ Ruajtësit e urës ishin forcë paramilitare lokale dhe e paguar serbe, me detyrën që nga fundi i vitit 1999 deri më 2002 të

lulëzuar, për shkak të vakumit në pjesën e Kosovës, duke ulur kështu të ardhurat në të dy shërbimet. Shumë maune ende i raportojnë vullnetarisht depove të doganave në jug të Mitrovicës, ndërsa të ardhurat nuk janë larg atyre të vitit të kaluar, mirëpo mashtrimet janë në rritje, ndërsa mallërat nuk paguajnë TVSh sepse hyrja në Kosovë konsiderohet të jetë njëjtë si të ishin në Serbi.³³ Çmimet e derivateve, të cilat shiten e blihen sipas kësaj skeme, kanë rënë deri në Serbinë qendrore,³⁴ kurse shumë shqiptarë tashti udhëtojnë për në veri të Kosovës për të blerë benzinë.³⁵ Pas rivendosjes së kontrolleve të doganave në veri të Kosovës, mendohet që të dy shërbimet do të vendosin po ashtu masa të reja teknike, për të reduktuar shansat për mashtrim dhe kontrabandë.³⁶ Por ndërkohë, bizneset legjitime po ankohen se kontrabandistët janë duke u bërë atyre konkurrencë të padrejtë.

Gjyqësia. Gjyqet nuk kanë funksionuar në veri të Ibrit që nga 18-21 shkurti, ndërsa bllokada në kompleksin e gjyqit në veri të Mitrovicës ka suspenduar njëkohësisht edhe shumë raste dhe apele në komunat me shumicë shqiptare në jug të Mitrovicës, Vushtrri dhe

mata nga homologët e tyre serbë sesa nga Policia e UNMIK-ut!" Korrespondencë e Grupit të Krizave, 2 shtator 2008.

³³Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të UNMIK-ut, Prishtinë dhe Mitrovicë, 7-8 maj dhe 14 gusht 2008.

³⁴Edhe pse që nga maji çmimet zyrtare serbe të derivateve janë rritur në 110 dinarë (1.38€) për një litër, derivatet kontrabandë nga Kosova e veriut ka mundur të gjenden në qytetet serbe si Novi Pazari, Kraljevë apo Çaçaku për 20 centë më lirë. Srbo Trifunovic, Enes Halilovic, "Svercovano gorivo sa Kosova stize u Srbiju" ["Derivatet kontrabandë nga Kosova mbërrijnë në Serbi"], *Blic*, 27 maj 2008. Në maj benzina ishte në shitje në shishe në qytetin kufitar Serbi-Kosovë të Rashkës për vetëm 68 dinarë (0.85€). Vëzhgim i Grupit të Krizave.

³⁵Pumpat jozyrtare të benzinës janë paraqitur muajt e fundit nëpër tërë Kosovën e veriut. Çmimet e benzinës për një litër variojnë në mes 65 dhe 80 dinarë. Shih Zija Miftari dhe Musa Mustafa, "Nafta bashkon shqiptarët e serbët në veri", *Koha Ditore*, 26 maj 2008, Gazmend Sylja dhe Zija Miftari, "Lufta për naftën e veriut", *Koha Ditore* 19 korrik 2008 dhe Srbo Trifunovic, po aty. Lënja pas dore e kontrollit të kufirit me Kosovën po ashtu ka nxitur importin e benzinës së parafinuar. Pronarët e pumpave ilegale të benzinës anekënd veriut thanë se nuk po shisnin benzinë kontrabandë me çmim të ulët, por se po shisnin benzinë më të lirë dhe të parafinuar. Intervista të Grupit të Krizave, maj 2008.

³⁶Këtu mund të përfshihet rihapja e dy portave sipas sistemit të zhvilluar në vitin 2005. Për momentin, eksportuesit serbë në Kosovë janë të liruar nga taksat, në bazë të një certifikate të lëshuar nga administrata e doganave dhe taksave e Serbisë në anën e saj të kufirit. Sipas atij sistemi, i cili krijoi probleme parash për shumë biznese, taksat paguheshin nga eksportuesit në Serbi dhe pastaj kompenzoheshin në bazë të një certifikate në arritje, të lëshuar nga Doganat e UNMIK-ut. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 14 gusht 2008.

Skënderaj.³⁷ Gjykatat komunale paralele që zbatojnë ligjin serb akoma ekzistojnë në komunat veriore, ashtu siç kanë ekzistuar edhe para 17 shkurtit; e njëjta është edhe me një gjykatë për krime serioze në Kraljevë, Serbi. Megjithatë, asnjë nga këto nuk konsiderohet të zbatojë me seriozitet sundimin e ligjit,³⁸ ndërsa ShPK-ja lokale serbe nuk mirret me to.

Kjo zonë është strehë si për të arratisurit serbe ashtu edhe ata kosovarë.³⁹ Gjykatat rajonale dhe komunale në veri të Mitrovicës u detyruan të mbylleshin pasi që një grup serbësh të armatosur ia ndaluan stafit kryesisht shqiptar që të vinin në punë më 21 shkurt.⁴⁰ Stafit gjyqësor i para vitit 1999 dhe qytetarë të tjerë të organizuar filluan të barrikadoheshin atë ditë, dhe pastaj okupuan ndërtesën e gjykatës rajonale më 14 mars. UNMIK-u dhe KFOR-i e ripërvetësuan atë pas operacionit të 17 marsit kur, pas përlëshjeve të KNS-së dhe MUP-it, një polic ukrainas u vra dhe shumë syresh u plagosën nga të dyja anët. KFOR-i ende e ruan ndërtesën e zbrazët, ndërsa nganjëherë ka edhe demonstrata serbe. Zyrtarët e gjykatës rajonale mbajnë disa dëgjime procedurale në gjyqin e Vushtrrisë, në jug të Ibrit, dhe kështu kanë filluar të zvogëlojnë lëndët e 33 rasteve ku përfshihen 45 të paraburgosur, por kanë marrur përsipër edhe raste të reja që nga 21 shkurti.⁴¹ Policia në veri të Ibrit kanë mbetur pa sis-

³⁷Raporti mujor, Sektori për system ligjor i Misionit të OSBE-së, mars 2008.

³⁸Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, gazetar serb, Mitrovicë e veriut, 28 gusht 2008.

³⁹Intervista të Grupit të Krizave, policia e UNMIK-ut, Mitrovicë, 8 maj 2008 dhe Goran Bogdanovic (ministër i Serbisë për Kosovë dhe Metohi), Mitrovicë e veriut, 30 maj 2008. Krimineli dhe i arratisuri shqiptar i Kosovës Enver Sekiraqa u pa në Mitrovicën e veriut në prill 2008. Në mars 2008 kryesuesi i Asociacionit Serb të Futbollit, i arratisur dhe i kërkuar në Serbi por i fshehur në Mal të Zi, propozoi mbajtjen e mbledhjes së përgjithshme vjetore në Mitrovicën e veriut.

⁴⁰Qeveria e Serbisë qarkulloi një brifing në Këshillin e Sigurimit, ku pohohej se stafi shqiptar i gjykatës kishte braktisur ndërtesën pas 17 shkurtit. Shih "Komente mbi vlerësimin teknik të progresit mbi implementimin e standardeve për Kosovën, i përgatitur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë", Republika e Serbisë, Ministria për Kosovë dhe Metohi, prill 2008. Në fakt, policia e UNMIK-ut e ndërpreu autobusin që e kapërcente urën e Mitrovicës në mëngjesin e 21 shkurtit, sepse një grup i madh meshkujsh serbë kishin përgatitur një pritë për të në rrugën Krajl Petar [Mbreti Petër], e cila nga ura çon në drejtim të veriut deri te kompleksi i gjykatës. Intervistë e Grupit të Krizave, Policia e UNMIK-ut, Mitrovicë, 8 maj 2008.

⁴¹Dhjetë gjykatës dhe prokurorë shqiptarë që punonin në Vushtrri (nga 45 anëtarë të stafit) kanë refuzuar rastet e reja, duke pohuar se nuk kanë kushte adekuate për punë. Gjykatësi kryesor nuk dëshiron të ndërtojë hapësira alternative nga ato që janë në Mitrovicën e veriut. Katër gjykatës nga gjykata

tem të drejtësisë ku do t'i dorëzonin të dyshuarit, kështu që në përgjithësi i lëshojnë ata.⁴²

PSSP-ja i ri Zannier ka deklaruar se rivendosja e sendimit të ligjit në veri është prioritet, dhe ka sugjeruar se duhet të vendoset ligji i UNMIK-ut i zbatuar nga stafi gjyqësor ndërkombëtar.⁴³ Serbët e Kosovës dëshirojnë që gjykatat të punojnë me staf serb nën UNMIK-un, ndërsa që gjykata komunale kryesisht shqiptare në jug të Mitrovicës të zhvendoset në poshtë Ibrit, dhe në përgjithësi nuk janë të kënaqur me mbylljen e gjykatës që nga shkurti.⁴⁴ Ideja e Zannierit është parë nga disa si mënyrë për vendosjen e gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it, anipse planifikohet rihapja në fillim të tetorit, duke përdorur gjykatën e UNMIK-ut.⁴⁵ Përveç problemit të pranimit serb, EULEX-i është po ashtu i brengosur për pasojat e profilit dhe imazhit të misionit të tij, nëse tërhiqet në lojën e krijimit të një aranzhimi special për veriu.⁴⁶ Zyrtarët serbë të burgjeve ende e kontrollojnë një burg në veri të Mitrovicës, me të burgosur serbë, si pjesë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të udhëhequr nga UNMIK-u.⁴⁷

Hekurudha. Më 4 mars 2008 Hekurudha e Serbisë pohoi të jetë pronare e linjës veriore 40-kilometërshe veri-jug, duke përfshirë këtu edhe tri stacione. Dre-

për krime te vogla e komunës në Mitrovicës, dëgjojnë raste në Vushtrri dy herë në javë. Intervistë e Grupit të Krizave, gjykatësi Kapllan Baruti, Vushtrri, 17 shtator 2008.

⁴²Në tri raste në muajt e fundit, duke shfrytëzuar komandantin e policisë së UNMIK-ut si ndërmjetësues, serbët e ShPK-së në veri të Ibrit kanë kërkuar asistencë juridike nga zyrtarët e gjykatës së Mitrovicës, që rezultoi në dy arreste shtëpiake. Po aty.
⁴³Izedin Krasniqi, "Zannier kërkon gjykatë të UNMIK-ut në veri", *Koha Ditore*, 17 korrik 2008.

⁴⁴Intervistë e Grupit të Krizave, lider politik vendor, Mitrovicë, 30 maj 2008.

⁴⁵"Fillimisht ndërkombëtarët", *Express*, 16 shtator 2008; dhe Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i Departamentit të Drejtësisë në UNMIK, 16 shtator 2008. Në konferencën e rregullt për shtyp të UNMIK-ut më 17 shtator, zëdhënësi Aleksander Ivanko, tha se gjykata do të ishte gati dy javë pas fillimit të pastrimit dhe furnizimit me pajisje të saj më 19 shtator (më vonë e shtyrë më 22 shtator). Shefi i gjykatës rajonale Kapllan Baruti tha se vendimi ishte kapitulum i agjendës serbe, se një gjykatë krejtësisht ndërkombëtare do të operonte tepër ngadalë, dhe se gjykatësit ndërkombëtarë do të duhej të vendoseshin aty që të përkrahnin gjykatësit dhe prokurorët kombëtarë, duke marrur përsipër vetëm raste te ndjeshme dhe ndër-etnike. Intervistë e Grupit të Krizave, Vushtrri, 17 shtator 2008; dhe Serbeze Haxhijaj, "Stafi vendor e kundërshton UNMIK-un", *Lajm*, 18 shtator 2008.

⁴⁶Informatë e dhënë Grupit të Krizave, zyrtarë, Nju Jork, gusht, 2008.

⁴⁷Oficerët dhe të burgosurit shqiptarë u transferuan në objekte tjera para 17 shkurtit.

jtori i saj, këshilltari i Koshtunicës, Ristivojeviq, u bëri thirrje stafit vendor serb të Hekurudhës së UNMIK-ut, që masovisht të zhvendosnin lojalitetin e tyre, pas së cilës Serbia filloi të aktivizojë trena për në veriu e Kosovës. Policia e UNMIK-ut ktheu këta trena të Serbisë në kufirin verior për disa ditë me radhë, pastaj hoqi dorë. Që atëherë Serbia ka zhvilluar shërbime dy herë në ditë, nga qyteti në qendër të Serbisë, Kralevë, deri në Zveçan. Derisa serbët e Kosovës nga veriu mund të udhëtojnë për në Serbi, vëllezërit e motrat e tyre etnikë nga jugu nuk mund të shkojnë më për në Mitrovicë, ashtu si kanë mundur më parë, para se të ndërrohej kontrolli i linjës. UNMIK-u dhe KFOR-i do të mund të paaftësonin linjën në kufirin verior, mirëpo llogarisin se kjo do të kishte të njëjtat pasoja në siguri sikurse përpjekja për të rivendosur doganat në Portat 1 dhe 31.⁴⁸

Planifikuesit e BE-së dhe OKB-së nuk kishin llogaritur krejtësisht në një konsolidim të tillë të ndarjeve ndër-etnike pas pavarësisë, të shkaktuara nga Serbia dhe serbët e Kosovës. Të përballur me Beogradin dhe refuzimin e serbëve të veriut të Kosovës për të bashkëpunuar me BE-së, si dhe me kontrollin e tyre mbi institucione në pjesët me shumicë serbe, akterët ndërkombëtarë nuk janë orvatur të imponojnë autoritetin e tyre që nga operacioni UNMIK/KFOR të 17 marsit në gjykatën në veri të Mitrovicës. Të paaftë për të operuar në veri, zbarkimi civil ndërkombëtar ka ngecur në tërë Kosovën. Pa marrë parasysh vështirësitë e tjera që kanë të bëjnë me logjistikë dhe mandat, ekziston frika që të mos krijohet një de facto ndarje, me BE-në në pjesët shqiptare të Kosovës, ndërsa OKB-në në ato serbe të Kosovës.

2. Zbarkimi civil ndërkombëtar

Sipas planit të Ahtisaarit, në fund të tranzicionit, "mandati i UNMIK-ut do të skadojë dhe i gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv që i përkiste UNMIK-ut, do të transferohet en bloc tek autoritetet qeverisëse të Kosovës".⁴⁹ Pranive ndërkombëtare do të duhet t'u kalojë një autoritet i kufizuar: ZCN-së, BE-së dhe NATO-s. Gjatë periudhës së tranzicionit, UNMIK-u parashikohej që të vazhdonte së ushtruar mandatin e tij 1244, në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN/PSBE). Por në mungesë të mbështetjes nga Këshilli i Sigurimit për planit e Ahti-

⁴⁸Intervistë e Grupit të Krizave, KFOR, Prishinë, 28 maj 2008.

⁴⁹Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, Parimet e Përgjithshme, Neni 15.1 (g), në www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html.

saarit dhe për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, OKB-ja nuk filloi me tranzicionin.⁵⁰

Për katër muaj rresht, ndërmjet pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës më 15 qershor, OKB-ja ngriu, pa pasur asnjë transferim të autoritetit. Më 20 qershor Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon prezantoi propozimin e tij për rikonfigurim në Këshillin e Sigurimit. Sidoqoftë, nuk duket e mundur që OKB-ja të jetë në gjendje të negociojë me qeverinë dhe me PCN-së se çfarë përgjegjësi do të mbajë kjo e para,⁵¹ ndërsa OKB-ja dhe BE-ja e kanë shtyrë deri më vonë në këtë vit detyrën e ndjeshme të arritjes së marrëveshjes për kushtet e vendosjes së kësaj të fundit në çadrën e OKB-së.

Disa kompetenca tashmë i kanë shpëtuar nga dora UNMIK-ut. BE-ja ka tërhequr financimin e Shtyllës IV të UNMIK-ut, e cila ishte përgjegjëse për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), si dhe për ndërmarrjet publike dhe sociale. Kontrolli i pronave publike dhe sociale po zhvendoset në mënyrë jo të qartë tek Agjencia Kosovare për Privatizim (AKP), të cilën Prishtina ishte e paraparë ta krijë, bashkë me PCN-së, menjëherë pas miratimit të kushtetutës më 15 qershor,⁵² por ajo e bëri këtë dy muaj më vonë, duke e komplikuar kështu marrjen përsipër të stafit dhe mjeteve të AKM-së.⁵³ Furnizuesi e herëpashërshëm i rrymës, KEK-u, ndërmarrja profitabile dhe e

pasur e telekomunikacionit PTK,⁵⁴ si dhe aeroporti i dërrmuar nga skandalet, janë tani praktikisht në kontroll të Kosovës, por qeveria ka dështuar së formalizuar këtë pronësi.⁵⁵ Ministria e re e brendshme mori përsipër regjistrin civil nga UNMIK-u, dhe më 30 qershor filloi të lëshojë pasaportat e parë të Kosovës,⁵⁶ ndërsa UNMIK-u e ka ndërprerë dhënien e dokumentave të udhëtimit.

Megjithatë, sfida më e madhe është rikonfigurimi i shtyllës madhore që mbetet me UNMIK-un: policia dhe drejtësia. Kalimi i këtyre përgjegjëseve të qeveria e Kosovës dhe EULEX-i, si dhe zbarkimi i EULEX-in nëpër tërë Kosovën, nuk ndodhën ashtu si u planifikuan më 15 qershor. Tashti kjo është e planifikuar që të fillojë kah nëntori apo dhjetori, të paktën në jug të Ibrit. Deri në mes të qershorit vetëm 300 nga 2,000 anëtarët e personelit që ishin të paraparë, i ishin bashkëgjitur EULEX-it në Kosovë,⁵⁷ shefi i misionit (një ish-komandant i KFOR-it dhe general francez), Yves de Kermabon, priti deri në fillim të korrikut që të mirrte përsipër përfundimisht detyrat e tij në Prishtinë. Marrëveshja teknike, e përfunduar ndërmjet OKB-së dhe BE-së me 18 gusht, të paktën lejoi që 1,000 anëtarë të stafit të EULEX-it, të vijnë në Kosovë nga 100 veta në javë.

Ndryshe nga EULEX-i, ZCN-ja vendosi pjesën dërrmuese të stafit të saj në Kosovë gjatë 120 ditëve të para, por nuk arriti ndikimin që priste. Plani i Ahtisaarit parashikonte që PCN/PSBE të ishte zyrtari primar ndërkombëtar në Kosovë, i cili do të koordinonte të gjitha pranitë ndërkombëtare, të udhëhiqte një ZCN

⁵⁰ Deri në mars 2008 shefat e UNMIK-ut morën pjesë bashkë me zyrtarët e ZCN-së dhe të qeverisë së Kosovës në mbledhjet e Grupit Strategjik mbi Tranzicionin i cili, si parashikohet nga plani i Ahtisaarit, duhet të formulojë detajet dhe modalitetet e transferit të autoritetit. Kah maji UNMIK-u dërgonte një vëzhgues të vetëm. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 20 maj 2008. Ky grup kishte hequr dorë nga tetë projekt rregullore që i kishte përgatitur si kontribut të saj për 41 ligjet e asociuara me planin e Ahtisaarit. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 30 prill 2008.

⁵¹ Ose mbi regjimin ligjor që qeverisë rezolutën për të gjitha përgjegjësitë e mbetura të UNMIK-ut, ashtu si thuhet në planin e Ahtisaarit.

⁵² Sekretari i Përgjithshëm kritikoi BE-në për përfundimin e fondit për Shtyllën IV (rindërtimi ekonomik) më 30 qershor 2008, duke thënë se nuk kishte pasur konsultime me selinë e OKB-së, ndërsa UNMIK-u kishte mbetur pa aftësinë teknike apo alokimin buxhetor për të zëvendësuar ekspertët e financuar nga Komisioni Evropian. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 qershor 2008, faqe 2. PCN-ja zgjodhi tre anëtarë ndërkombëtarë për bordin e AKP-së, duke aplikuar dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës të Ahtisaarit, por priti dy muaj derisa qeveria emëroi homologët e vet nga Kosova.

⁵³ Gjatë gjysmës së parë të shtatorit gazeta që ka raporte të mira me qeverinë *Express* pohoi se zyrtarët e UNMIK-ut AKM-së kishin djegur apo djegur arkivat e AKM-së. Shih "Monstrumët", *Express*, 8 shtator 2008 dhe artikuj të ngjashëm.

⁵⁴ Kursimet e akumuluar të PTK-së prej 250 milion euro luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e likuiditetit të bankave të Kosovës.

⁵⁵ AKM-ja mbetet hisedari fomal, ndërsa UNMIK-u mban të gjitha dokumentet. Prishtina do të mund të lëshonte dokumente aksionesh në emrin e vet, por nuk e ka bërë një gjë të tillë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i UNMIK-ut, 14 gusht 2008.

⁵⁶ "First Passports Issued in Kosovo" ["Pasaportat e parë të lëshuar në Kosovë"], *Southeast European Times*, 31 korrik 2008. Mirëpo qeveria është vonuar në dërgimin e detajeve të pasaportave të rinj në vendet e tjera deri dy javë para lëshimit të pasaportave të parë, gjë që ka shkaktuar vonesë në pranimin e tyre.

⁵⁷ Këtu përfshihen 80 për qind e kontigjentit të drejtësisë, i tërë menaxhmenti i mesëm i policisë dhe të gjitha pjesët shtesë të doganave. Pjesa më e madhe e policisë kundër protestave, 550 anëtarëshe e EULEX-it janë në Kosovë, por ende të vendosur si dy njësite të UNMIK-ut (rumun dhe polak) dhe dy të KFOR-it (francez dhe italian). Këto do të transferohen vetëm kur EULEX-i të bëhet operacional. Diku afër 200 zyrtarë të tjerë të Policisë së UNMIK-ut dhe të drejtësisë (gjysma amerikanë) po ashtu do të transferohen në EULEX. Mbetet që të vijnë një pjesë tjetër 1,000 anëtarësh policësh të BE-së, monitorues dhe specialistë.

të fortë me 100 anëtarë, të drejtonte një mision të fortë të sundimit të ligjit EULEX 2,000-anëtarësh, të gëzonte përkrahjen e misionit 850-anëtarësh të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)⁵⁸ dhe të mbikëqyrte përbushjen e obligimeve të Ahtisaarit nga institucionet e Kosovës.

PCN/PSBE, Pieter Feith, i ndihmoi Kosovës që me kohë të përbushë programin e saj legjislativ të Ahtisaarit, por nuk arriti një epërsi në krahasim me kolegët e tij ndërkombëtarë. ZCN-ja e tij është “një fjalë paksa e keqe në Bruksel”, e vështruar si “pakëz ilegale”.⁵⁹ Për OKB-në, tha një zyrtar i lartë në Nju Jork, plani i Ahtisaarit të cilin ai është i paraparë që ta implementojë, nuk ka “hiç më shumë status ligjor sesa një raport i Grupit të Krizave”.⁶⁰

Insistimi i Serbisë se Feithit i mungon legjitimiteti, ia bën atij të vështirë punën e një ndërmjetësuesi të sinqertë. Mandati i tij për implementimin e planit të Ahtisaarit për një Kosovë multi-etnike, me garancione të fuqishme për pakicën serbe, e ka bërë atë të duket më shumë si një aleat i Prishtinës sesa një refer i pranuar universalisht. ZCN-ja u detyrua të evakuohej nga zyra e saj në veri të Mitrovicës më 24 shkurt 2008, ndërsa kundërshtimi nga Beogradi ia ka kufizuar kontaktet me pjesët me shumicë serbe. ZCN dhe EULEX janë nëpër pjesë shqiptare të Kosovës, por jo në ato serbe. Feithi ka filluar implementimin e mandatit të tij me shqiptarët e Kosovës – për shembull duke u ofruar udhëzime mbi legjislativonin e ri. Mirëpo, përderisa edhe ZCN edhe EULEX pohojnë të kenë kontakte me enklavat serbe dhe me veriun, sidomos me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe individë më afër DS-së, aktivitetet e tyre mbesin diskrete për pjesët me shumicë serbe.

Plani i Ahtisaarit stipulonte që burimi i legjitimitetit të ZCN-së do të burojë nga Grupi Udhëheqës Ndërkombëtar (GUN), i përbërë nga “hisedarë kyç ndërmjetarë”, të cilët do të emëronin përfaqësuesin special të BE-së si PCN, do t’i ofronin atij udhëzime, do të takoheshin nën kryesinë e tij, dhe pas dy vjetësh do të adaptoheshin ose do t’i shpërbënin detyrat e tij, në përputhje me progresin e Kosovës drejt implementimit të marrëveshjes së Ahtisaarit.⁶¹ Emërimi i PCN-së do të duhej të ishte mbështetur nga Këshilli i Sig-

urimit,⁶² por kjo nuk ka ndodhur. GUN-i parashihej të përbëhej nga Grupi i Kontaktit gjashtë-anëtarësh (“Pesëshja” perëndimore – Sh.B.A., M.B., Franca, Gjermania dhe Italia plus Rusia), Sekretariati i Këshillit të BE-së, Komisioni Evropian dhe NATO. Sot ai ka 24 vende anëtare, përfshirë nëntëmbëdhjetë nga 27 shtetet anëtare të BE-së,⁶³ por pa Rusinë, ndërsa trupat e BE-së dhe NATO-ja marrin pjesë vetëm si vëzhguesë. Grupi u mblodh më 28 shkurt, e emëroi Feithin, dhe që atëherë është takuar pesë herë.⁶⁴ Mbetet ende të shihet pesha e saj e vërtetë politike. Është mbledhur në nivelin e drejtorëve për Ballkanin Perëndimor të ministrive të jashtme, ndërsa vendimet mirren me koncenus.⁶⁵ Suksesi i saj kryesor ka qenë financimi i ngritjes së shpejtë të stafit të misionit të ZCN-së.⁶⁶

Mirëpo, ZCN-ja është vetëm njëra ndër disa nga misionet ndërkombëtare. EULEX-i në përgjithësi perceptohet si një trup i barabartë, e jo vartës, me një vizibilitet në Bruksel dhe në shtetet anëtare që është më i madh sesa ai i ZCN/PSBE-së. EULEX-i e pranon se merr udhëzime politike nga Feith, por është i qartë se urdherat për të vijnë nga Brukseli.⁶⁷ Propozimi i Ban Ki-moonit për ta futur atë nën “çadrën e OKB-së”, duke i raportuar të paktën sa për qy e faqe Nju Jorkut nën Rezolutën 1244,⁶⁸ ka kontribuar në ndarjen e mëtejshme të saj nga ZCN/PSBE-ja. Gjatë një nisme në gusht për të përfshirë serbët, shefi i misionit të EULEX-it de Kermabon theksoi karakterin “teknik” e jopolitik të misionit të tij.⁶⁹ Misioni i OSBE-së gjithashtu është distancuar nga ZCN-ja, për të parandaluar veton ruse apo serbe.⁷⁰ Për pasojë,

⁶² Po aty, Parimet e Përgjithshme dhe Aneksi IX.

⁶³ SHBA-të, Turqia, Zvicra, Norvegjia dhe Kroacia nuk janë anëtare të BE-së. Shih dokumentin “Meeting of the International Steering Group (ISG) for Kosovo” [“Takimi i Grupit Udhëheqës Ndërkombëtar (GUN) për Kosovën”], 22 maj 2008, Prishtinë. Suedia, në veçanti, ka shprehur shqetësim se rritja e anëtarëve do të zvogëlojë aftësinë e GUN-it për të marrë vendime, duke e kthyer atë në zbatues të vendimeve të Pesëshes. Intervista të Grupit të Krizave, diplomatë, Prishtinë, maj 2008.

⁶⁴ Së pari në Vjenë dhe që nga maji në Prishtinë.

⁶⁵ Ashtu që vendimet mund të bllokohen nga një apo dy shtete anëtare që mund të mos pajtohen. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 31 korrik 2008.

⁶⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i ZCN-së, Prishtinë, 29 maj 2008.

⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 26 gusht 2008.

⁶⁸ Në një aranzhim të ngjashëm me atë që është bërë për shtyllën OSBE të UNMIK-ut.

⁶⁹ Në vizita në Graçanicë dhe Gorazhdec dhe një intervistë me Radion Evropa e Lirë.

⁷⁰ Që nga fillimi i vitit 2008 qëndrimet e Beogradit dhe Moskës brenda organizatës 55-anëtarëshe të bazuar në konsensus, e kanë vendosur misionin e OSBE-së në Kosovë në një pozitë

⁵⁸ Misioni i OSBE-së ka shërbyer si shtylla e UNMIK-ut për “demokratizim dhe ndërtim të institucioneve” dhe gjatë dy viteve të fundit ka zhvilluar një prani të madhe monitoruese në nivelin komunal.

⁵⁹ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Prishtinë, 29 maj dhe 2 shtator 2008.

⁶⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i OKB-së, Nju Jork, 24 mars 2008.

⁶¹ Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, Aneksi IX Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

ZCN-ja ka hequr dorë nga planet e saj për të shfrytëzuar OSBE-në si syrin dhe veshin e saj në nivelin komunal. Në vend të kësaj, në prill GUN-i aprovoi krijimin e një pranije të saj në terren prej 70-80 vetësh.⁷¹

Plani i Ahtisaarit kërkon nga KFOR-i që të vazhdojë me mandatin e vet ekzistues gjatë tranzicionit 120 ditësh, që të sigurohet një “ambient i sigurtë” dhe të mbrohen kufijtë e Kosovës nën Rezolutën 1244. Forca 32-kombëshe ka 14,750 trupa, është e vendosur në pesë Forca Multinacionale (FM), të bazuara nëpër rajone. FM-ja e komanduar nga francezët, që e mbulon Mitrovicën dhe territorin në veri të Ibrit, përforcohet vazhdimisht nga një batalion shtesë i NATO-s, i cili është i vendosur në bazën “Nothing Hill” afër Leposaviqit, i rihapur më 2006 si garrizoni i vetëm i KFOR-it në veri të Ibrit. Që nga dita 121, forca e udhëhequr nga NATO-ja ishte e paraparë që të riemërohej Prania Ushtarake Ndërkombëtare (PUN), për t’i ndihmuar PCN-së dhe institucioneve të Kosovës që të implementojnë planin e Ahtisaarit, derisa kjo e fundit të jetë e aftë që të marrë përsipër detyrat e sigurisë. PUN-i po ashtu do të mirrte përsipër autoritetin ekzekutiv të UNMIK-ut mbi Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe do të mbikëqyrte shpërbërjen e tyre, si dhe krijimin dhe trajnimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.⁷²

KFOR-i ka vijuar të ofrojë siguri nën mandatin e saj sipas 1244, me vendosmëri dhe sukses të ndryshëm, por ka hezituar që të asociohet me planin e Ahtisaari.⁷³ Edhe pse Sh.B.A.-të janë motori i vendim-marrjes në NATO, anëtarët që nuk kanë njohur Kosovën, si Spanja, kanë marrur rolin e stopuesit, ashtu si Turqia. Kjo ka parandaluar shqyrtimin e planit të operacioneve të NATO-s për Kosovën, si dhe formalizimin e katër marrëveshjeve teknike mbi bashkëpunimin e KFOR-it me EULEX-in, për shkak të vështirësive të tij saj me

të rishikimit të mandatit në baza mujore. Shefi i misionit, Tim Guldiman i Zvicrës, u orvat të negociojë kompromise për mandatin drejtpërdrejtë me Moskën dhe Beogradin, me tendim që ta ripozicionojë OSBE-në si aktor me status neutral, i cili megjithatë ka mundësi të përkrahë konsolidimin e institucioneve demokratike dhe decentralizimin. Manovrat e tij zgjuan irritimin e Pesëshes dhe qeverisë së Kosovës, ndërsa mediat shqiptare e Kosovës lansuan një fushatë të shkurtër të damkosjes së tij në fillim të vitit 2008. Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë dhe diplomatë ndërkombëtarë, Prishtinë, shkurtmars 2008.

⁷¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të ZCN-së, Prishtinë, 29 maj 2008.

⁷² Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, Parimet e Përgjithshme, Neni 14 dhe Aneksi XI.

⁷³ Samiti i NATO-s në Bukuresht, 2-4 prill 2008, nuk prodhoi vendim. Shih po ashtu Mark John, “NATO chiefs to grapple eith në Kosovo snags” [“Shefat e NATO-s përballen me nyjet e Kosovës së re”], Reuters, 12 qershor 2008.

BE-në.⁷⁴ Në mbledhjen e 12 qershorit 2008 të ministrave të mbrojtjes NATO më në fund u pajtua që të shtyjë para “detyrat e reja... në ndërtimin e institucioneve të domosdoshme demokratike të sigurisë”,⁷⁵ në mënyrë që t’ia mundësojë divizionit trajnues 80 anëtarësh (Asistenca Ushtarake Civile, AUC) që të zbarkojë duke filluar nga mesi i shtatorit.⁷⁶ Deri më tani 40 përqind e divizionit ka zbarkuar dhe fondi prej 13 milionë eurosh për TMK-në është premtuar në masë të madhe,⁷⁷ por 40 milionë euro që duhen për asistencë drejt krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ende nuk janë materializuar.⁷⁸ Përndryshe, as KFOR-i e as emri i tij me detyrat e saj sipas 1244 nuk kanë ndryshuar. Dy njësite të xhandarmërisë së KFOR-it (franceze dhe italiane), me rreth 300 trupa, mendohet të transferohen në EULEX, por vetëm kur kjo e fundit të jetë plotësisht operacionale.

Si PSSP-ja i ri i OKB-së, Zannier filloi me definimin e rolit të tij si “lehtësues... në dispozicion të autoriteteve”, e jo si zyrtari më i lartë ndërkombëtar apo administruesi i Kosovës.⁷⁹ Më 25 korrik ai i tha Këshillit të Sigurimit se “fuqia [e tij] për të imponuar zgjidhje praktikisht është zhdukur në pjesën më të madhe të territorit”, dhe se megjithëse “formalisht i veshur me autoritetin ekzekutiv”, ai nuk kishte “mjete” që ta përforconte atë autoritet.⁸⁰ Largimi i pararendësit të tij, Joakim Ryker, më 20 qershor shënoi fundin e pushtetit imponues të UNMIK-ut. Në përgjigje ndaj sfidave, si për shembull marrjes së pushtetit nga autoriteti komunal paralel serb të ndërtesës kryesore administrative të komunës së

⁷⁴ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të NATO-s, Bruksel dhe Prishtinë, 2007-2008. Për detaje mbi burimin e problemit, shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave, Nr 184, *Evropa dhe Turqia: rruga përpara*, 17 gusht 2007, faqet. 5-6.

⁷⁵ Shih “Defence ministers meet at NATO headquarters” [“Ministrat e mbrojtjes takohen në selinë e NATO-s”], www.nato.int/docu/update/2008/06-june/e0612a.html.

⁷⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, KFOR, 28 maj 2008. Sipas shefit të ushtrisë së Serbisë, kjo “përfaqëson një hap jashtë” mandatit 1244 dhe do të ndryshojë relacionet e ushtrisë së tij me KFOR-in prej të qenit “partnerë” në thjeshtë “teknike”. Ai nuk parashihte ndërprerjen e punës së komisioneve dhe patrullave të përbashkëta, dhe pohoi se ishte më mirë që NATO-ja të mbikëqyrte forcën e re të sigurisë së Kosovës sesa Kosova ta krijonte atë vetë. “Ponos: NATO’s wrong decision” [“Ponos: vendimi i gabuar i NATO-s”], *VIP Daily News Report*, 16 qershor 2008.

⁷⁷ Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Një ushtri për Kosovën?*, për informata shtesë mbi TMK-në.

⁷⁸ NATO-ja planifikon konferencën informative të donatorëve në Bruksel më 8 tetor 2008. Intervista me telefon të Grupit të Krizave, Bruksel dhe Prishtinë, 23 shtator 2008.

⁷⁹ Konferencë për shtyp, Prishtinë, 20 qershor 2008.

⁸⁰ Shih shënimet nga mbledhja e Këshillit të Sigurimit, S/PV.5944, 25 korrik 2008.

Shtërpes më 2 korrik, pengesave serbe, që nga 7 korriku, i vendosjes së gypave të ujit në fshatin kryesisht shqiptar të Suhadollit (në veri të Ibrit dhe në perëndim të Mitrovicës), si dhe bërjen rrafsh me tokë të një gërmadhe të kishës serbe nga komuna me shumicë shqiptare e Gjakovës me qëllim të krijimit të një parku, UNMIK-ka ka ofruar, në rastin më të mirë, që të lehtësojë dialogun me të gjitha palët dhe të “krijojë një ambient të zgjidhjeve të problemeve, e jo ambient konfrontues”.⁸¹

Kalimi i autoritetit qeverisës nga OKB-ja te shteti kosovar, dhe në një masë më të vogël te pranitë e tjera ndërkombëtare, ishte menduar të ishte arritja kyçe e tranzicionit. Pasi tranzicioni dështoi, sot në Kosovë nuk ekziston asnjë autoritet i vetëm real. Qeveria e Kosovës dhe pranitë ndërkombëtare kryesisht ende bashkëpunojnë, mirëpo gjersa qeveria kërkon që tranzicioni të prodhojë një homolog të vetëm ndërkombëtar, në Prishtinë bashkëekzistojnë katër shefa të misioneve ndërkombëtare me peshë të njëjtë: PSSP Lamberto Zannier, PCN/PSBE Pieter Feith, shefi i EULEX-it Yves de Kermabon dhe komandanti i KFOR-it Giuseppe Emilio Gay. Kompromisi nën të cilin qeveria e Kosovës ka vazhduar që të njohë autoritetin e përkohshëm të UNMIK-ut në polici, drejtësi dhe dogana, është joformal dhe tashmë i tendosur.⁸² Pasi që Zannieri filloi bisedimet e drejtpërdrejta me Beogradin në gjashtë fusha të bashkëpunimit, qëndrimi i qeverisë ndaj tij dhe UNMIK-ut u ashpërsua deri në një masë.⁸³

Përkrahja nga Pesëshja, rritja e unitetit në BE dhe zbarkimi i shpejtë i EULEX-it mund t'i ndihmojë qeverisë dhe PCN-së që të qëndrojnë në rrugën e planit të Ahtisaarit. Por mungesa e vendosmërisë ndërkombëtare, nëse përsëritet gjatë këtij 120

ditëshit të dytë, do të mund të fragmentonte autoritetin ndërkombëtar, të kontribuonte në ndarjen e kontrollit territorial përgjatë vijave etnike, dhe të krijonte kushte për dhunë.

B. A PO ZBEHET VULLNETI POLITIK NË KRYEQYTETET EVROPIANE?

Fillimisht BE-ja tregoi vendosmëri dhe unitet të shkëlqyeshëm kur, përkundër hezitimit të disa shteteve anëtare për të njohur Kosovën, ajo u zotërua që t'i ndihmojë shtetit të ri⁸⁴ dhe autorizoi EULEX-in dhe PSBE-në.⁸⁵ Në dhjetor 2007 ajo deklaroi në mënyrë eksplicite se do “të luajë një rol udhëheqës në forcimin e stabilitetit në rajon dhe në implementimin e marrëveshjes që definojnë statusin e Kosovës... [dhe] të ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt stabilitetit të qëndrueshëm”.⁸⁶ Mirëpo, u bë e qartë se shtetet anëtare kishin nënvlerësuar sfidat që kishin përpara.

Gjatë periudhës kyçe të tranzicionit nga mesi i shkurtit deri në mes të qershorit 2008, BE-ja dështoi në formulimin e ndonjë deklarate me rëndësi mbi Kosovën dhe zbarkimin e BE-së, dhe priti që OKB-ja të marrë rolin udhëheqës. Është indikativ fakti se kur më 11 maj Serbia organizoi zgjedhje komunale në pjesët me shumicë serbe në Kosovë, duke sfiduar kështu UNMIK-un, BE-ja nuk shfaqti asnjë kritikë.⁸⁷ Ajo përkrahu planet për zbarkimin e ZCN/PSBE-së dhe EULEX-it, por bëri shumë pak drejt promovimit të

⁸¹ Zëdhënësi i UNMIK-ut Russell Geekie, konferenca javore për shtyp, Prishtinë, 9 korrik 2008.

⁸² Një zyrtar i lartë i UNMIK-ut e pranoi se UNMIK-u dhe qeveria përdorin baza të ndryshme ligjore, respektivisht Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 dhe kushtetutën e Kosovës. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 korrik 2008. Po ashtu shih transkriptet e brifingut të shtypit nga Ushtruesi i Detyrës së Zëvendësimit të Parë të PSSP-së Nikolas Heison, Prishtinë, 15 gusht 2008 në www.unmikonline.org.

⁸³ U tha që kryeministri Thaçi ishte hidhëruar që Zannier-i në fund të korrikut kishte bërë publike propozimet për aranzhime për polici speciale, dogana dhe gjykata për serbët e Kosovës, pa i koordinuar aktivitetet apo pa arritur në një marrëveshje me qeverinë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, shtator 2008. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi i tha BBC-së: “Jemi të tronditur nga entuziazmi i Z. Zannier për dialog me Serbinë... edhe Z. Zannier duhet të respektojë kushtetutën e Republikës së Kosovës”, shih transkriptin në *Zëri*, 5 gusht 2008; dhe “Thaçi: jo negociata”, *Koha Ditore*, 6 gusht 2008.

⁸⁴ Duke deklaruar në konkluzionet e 18 shkurtit 2008 të Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme (KÇPMJ) se Këshilli “merr shënim” për shpalljen e pavarësisë dhe parimet e saj, “pyet Komisionin që të shfrytëzojë instrumentet e komunitetit për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe politik” dhe konsideron se “Kosova është një rast sui generis që nuk sjellë në pikëpyetje [parimet e Kartës së OKB-së, Aktin Final të Helsinkit, sovranitetin, integritetin territorial dhe të gjitha rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së].”

⁸⁵ Veprimet e Përbashkëta të Këshillit, 2008/124/CFSP dhe Veprimet e Përbashkëta të Këshillit 2008/123/CFSP, 4 shkurt 2008.

⁸⁶ Pastaj aty thuhet se “BE-ja po ashtu do të jetë e gatshme që të ndihmojë me zhvillimin ekonomik dhe politik me anë të një perspektive të qartë evropiane, në përpunje me perspektivat evropiane të rajonit”. Konkluzionet e Presidencës, pika 70, Bruksel, 14 dhjetor 2007.

⁸⁷ Konkluzionet e Këshillit më 26-27 maj 2008 “shprehën kënaqësinë me mënyrën paqësore dhe të rregullt të organizimit të zgjedhjeve”. Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, Javier Solana, e mirëpriti rezultatin, duke thënë që Serbia ishte “tani në një pozitë të mirë që të ecë shumë shpejt përpara”. Presidenca sllovene e mirëpriti “fitoren e qartë” të forcave pro-evropiane, duke shpresuar se kjo do t'i ndihmojë Serbisë në “avansimin e mëtejshëm në rrugën e saj drejt BE-së, përfshirë këtu statusin e kandidatit”.

tyre kur ato filluan të ballafaqoheshin me pengesa në mars, përfshirë këtu edhe suspendimin e transferit të mjeteve dhe përgjegjësive të OKB-së, si dhe rezistencën e serbëve ndaj zbarkimit të tyre në pjesët me shumicë serbe. Shefi i punëve të jashtme Javier Solana nuk ka lëshuar as një deklaratë të vetme në përkrahje të punës së PCN/PSBE-së. Vetëm në qershor BE-ja më në fund ritheksoi përkushtimin e saj që të luajë një rol udhëheqës, kur mirëpriti planin e Sekretarit të Përgjithshëm për rikonfigurimin e pranisë civile ndërkombëtare.⁸⁸

Disa nga shtetet e Pesësbes kishin besuar se pas pavarësisë Moska nuk do të kishte opsion tjetër përpos njohjes së fait accompli-së. Por ata u kapën në befasi nga kritikata e ashpra ruse kundër zbarkimit të BE-së, si dhe nga deklarata eksplicite drejtuar Ban Kimoon-it se çfarëdo rikonfigurimi i OKB-së kërkonte miratimin e Këshillit të Sigurimit.⁸⁹ BE-ja kishte pritur të zbarkohej në një ambient të qetë, në mbrojtje nga KFOR-i. Pak njerëz kishin planifikuar sulmet e armatosura në veri të Kosovës kundër posteve kufitare dhe doganore më 19 shkurt, dhunën në rrugë kundër interesave të Brukselit në Beograd më 21 shkurt, apo sulmet ndaj policisë e trupave ndërkombëtare jashtë gjykatës së Mitrovicës më 17 mars.

Brukseli është i penguar nga disa shtete atëtare, të cilat ngurrojnë që të ecin përpara me implementimin e planit të Ahtisaarit, sepse ato nuk e kanë njohur Kosovën dhe preferojnë që të veprojnë nën autoritetin e OKB-së. Fillimisht shtetet anëtare ishin pajtuar se baza ligjore e misioneve ishte siguruar nën Rezolutën 1244.⁹⁰ Por që nga pavarësia, disa prej tyre janë në pritje të një ftese më eksplicite nga Sekretari i Përgjithshëm. Madridi është bërë de facto lider i shteteve anëtare të BE-së që nuk njohin pavarësinë, që zotohet të marrë pjesë në EULEX, por që kërkon të jetë “neutral ndaj statusit”, e jo ta përkrahë Kosovën në fuqizimin e kapaciteteve qeverisëse.

Një zyrtar i BE-së ka përshkruar se si qeveria spanjolle kishte dorëzuar një ankesë formale për arsye të një reference mbi “legjislacionin” e Kosovës në një dokument të ZCN/PSBE-së nga Prishtina.⁹¹ Spanja dhe një grup shtetesh të tjera të BE-së janë posaçërisht të pakënaqura që Feith është po ashtu duke shërbyer si

PCN dhe e njohin atë vetëm si PSBE, duke e dëmtuar kështu pozitën e tij. Madridi thotë se nuk do të pranojë kompromis për të ruajtur unitetin e BE-së, pasi që interesat e veta kombëtare ishin injoruar nga shtetet e tjera anëtare të BE-së, që kishin për qëllim ta përkrahnin Kosovën shpejt drejt pavarësisë.⁹² Argumentet e saj kanë rezonim të gjerë, në mesin e aleatëve politik në Amerikë Latine dhe Afrikë të Veriut.⁹³

Në vend se t'i bëjë presion Beogradit për Kosovën, BE-ja i ofroi përkrahje forcave pro-evropiane të cilat eventualisht i fituan zgjedhjet e përgjithshme në maj, duke e bërë prioritet nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA),⁹⁴ me shpresën se kjo do të rezultojë në një qeveri më bashkëpunëtore.⁹⁵ Mirëpo EULEX-i dhe ZCN/PSBE-ja ende nuk kanë partnerë zyrtarë për diskutime në Serbi, edhe pse ka pasur diskutime joformale,⁹⁶ dhe qeveria që u formua në korrik thotë se do të punojë vetëm në një zbarkim të BE-së që ka “përkrahje adekuate nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së”, e jo një që është unilaterale.⁹⁷

⁹² Madridi pohon se ka kërkuar të futet në Grupin e Kontaktit për më shumë se dhjetë vjet, do të kishte dashur që negociatat Serbi-Kosovë të kishin ecur më gjatë, kishte menduar se nuk ishte informuar mjaftueshëm mbi zhvillimet, dhe do të kishte qenë falendëruese nëse pavarësia e Kosovës ishte shpallur pas zgjedhjeve atje në mars. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë së jashtme, Madrid, maj 2008. Thuhet se Spanja ishte paraqitur vullnetarisht se do t'iu kishte bashkangjitur valës së parë të shteteve për të njohur pavarësinë, nëse ajo ishte shpallur pas 9 marsit. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë së jashtme, Paris, mars 2008.

⁹³ Që nga fundi i shkurtit u raportua se Spanja filloi të qarkullojë një letër tri-faqëshe në mesin e disa shteteve, ku ndërthehen argumentet ligjore e politike kundër pavarësisë së Kosovës. Shih Augustin Palokaj, “Spanja ndikon shumë në mosnjohjen e Kosovës”, *Koha Ditore*, 3 shtator 2008. Më 12 shtator gazeta publikoi një faksimil të letrës, të titulluar “Qëndrimi spanjoll mbi Kosovën” dhe e nënshkruar nga Bernardino Leon Gross, Sekretar i Shtetit për Punë të Jashtme.

⁹⁴ BE-ja dhe Serbia kanë nënshkruar MSA-në më 29 prill 2008. Për më shumë për lidhjet me zgjedhjet e 11 majit shih “Serbia and the SAA: A Bitter Pill to Swallow” [“Serbia dhe MSA: ilaç i hidhur për të kapërdirë”], Pontis Foundation, 7 maj 2008, në www.nadaciapontis.sk/tmp/assetcache/link/000019051/080507_SerbiaEU_TheSigningOfTheSAA.pdf.

⁹⁵ Këshilli Evropian i ofroi inkurajime shtesë politikanëve pro-evropianë të Serbisë në qershor, duke shprehur shpresën se Serbia do të përshpejtonte progresin e saj drejt statusit të kandidatit për BE. Konkluzionet e Këshillit të BE-së, 19-20 qershor 2008 dhe 22 korrik 2008, Bruksel.

⁹⁶ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të ZCN-së dhe EULEX-it, Bruksel dhe Prishtinë, maj dhe qershor 2008.

⁹⁷ Ministri i jashtëm Jeremiq në “New govt. to cooperate on UNMIK reconfiguration” [“Qeveria e re të bashkëpunojë me rikonfigurimin e UNMIK-ut”], B92, 6 qershor 2008.

⁸⁸ Konkluzionet e KÇPMJ-së për Ballkanin Perëndimor, Bruksel, 20 qershor 2008.

⁸⁹ Deklaratë e ministrisë së punëve të jashtme ruse (858-12-06-2008), 12 qershor 2008.

⁹⁰ Ashtu si thuhet në Veprimet e Përbashkëta mbi Misionin për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX Kosova, Bruksel, 2008/124/CFSP, 4 shkurt 2008.

⁹¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Prishtinë, maj 2008.

Prej marsit deri në qershor BE-ja iu përvish procesit të negociimit të rikonfigurimit me OKB-në, mirëpo priste sinjalin politik nga Ban-i për të vazhduar tutje. Aji i nënvizoi dy vija të kuqe: elementet e BE-së duhet t'i raportojnë drejtpërdrejtë Brukselit, dhe duhet të ketë "një mision për një Kosovë".⁹⁸ Katër shtetet anëtare të BE-së – Franca, Gjermania, Mbretëritë e Bashkuara dhe Italia – si dhe Sh.B.A.-të (Pesëshja), ia prezantuan idetë e tyre Bani-it me shkrim në maj, duke theksuar se transferimi i plotë i përgjegjësiave administrative të UNMIK-ut te qeveria e Kosovës do të ishte "një dëshmi e suksesit të OKB-së në themelimin e institucioneve funksionale, demokratike të vetë-qeverisjes". Prania e mbetur e OKB-së, çfarëdo që të jetë ajo, duhet të jetë e një profili të ulët dhe me staf minimal, dhe të zvogëlohet edhe më tej me kalimin e kohës. Nëse nuk kërkohet prej saj, ajo nuk duhet të qeverisë apo administrojë Kosovën, të menaxhojë ekonominë e saj, të kundërshtojë apo dyfishojë punën e ZCN-së, apo të negociojë aranzhime të reja institucionale. Në vend të kësaj, ajo duhet të monitorojë dhe të raportojë zhvillimet të Këshilli i Sigurimit, të administrojë gjysmë milioni dokumentash të përkohshëm udhëtimi, të lëshuara nga ajo, dhe të jetë e gatshme, nëse kërkohet prej saj, që të lehtësojë pjesëmarrjen e Kosovës në forumet ndërkombëtare dhe dialogun Prishtinë-Beograd në "çështje praktike të shqetësimit të përbashkët".⁹⁹

Letra e Pesëshes tregon në detaje se çka dëshiron nga EULEX-i: përkrahje dhe lehtësim nga OKB-ja për zbarkimin e tij; pavarësi buxhetore dhe operacionale; dhe një "çadër politike të OKB-së" e cila nuk do të përzihet në zinxhirin komandues të BE-së. Stafi në terren i OKB-së duhet të udhëzohen që të bashkëpunojnë gjatë këtij zbarkimi brenda një afati kohor të caktuar, që do të organizohen në bashkëpunim me rolin e mbetur operacional të OKB-së.¹⁰⁰ "Çadra" e OKB-së do t'i ndihmonte përkohësisht zbarkimit të EULEX-it në pjesë të Kosovës, sidomos në veri, ku "ekstremistët kanë kërcënuar me mos-bashkëpunim dhe dhunë" kundër stafit të BE-së.¹⁰¹

Që në pranverë, BE-ja ka mundur të marrë një qëndrim më të fuqishëm dhe të fillojë zbarkimin e EULEX-it, pa bashkëpunimin e plotë të OKB-së.

⁹⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Bruksel, prill-maj 2008. Misioni i OSBE-së dhe KFOR-i, të cilat kanë operuar si institucione të Rezolutës 1244 që nga viti 1999, nuk janë nën kontroll të Sekretariatit. KFOR-i operon nën zinxhirin komandues të NATO-s, me raportim minimal në Nju Jork.

⁹⁹ Dokument i Pesëshes, maj 2008, që i është dhënë Grupit të Krizave.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

Legjitimiteti politik i operacioneve të tij do të ishte bazuar në mandatin që ia ka dhënë vetes ("Veprimet e Përbashkëta" të tij), dhe në ftesën që përfshihet në deklaratën e pavarësisë së Kosovës,¹⁰² si dhe, ndoshta, në Rezolutën 1244 (e cituar tri herë në deklaratën e Kosovës). Kjo do të kërkonte vullnet politik dhe unitet, argumentime të forta ligjore dhe një përkushtim të konsiderueshëm financiar që të sigurohen të holla, në rast se mjetet e OKB-së nuk dorëzohet te ta. Sipas llogaritjeve të BE-së, sigurimi i mjeteve të reja dhe objekteve për qera do të kushtonte 68 milionë euro shtesë më 2008¹⁰³ dhe, për shkak të procedurave të brendshme të prokurimit, do të duhej i tërë viti i tanishëm për t'i siguruar ato para.¹⁰⁴ Zyrtarët e BE-së i fajësuan të tjerët, e veçanërisht BE-në, për problemet e misionit të tyre, kështu që shfrytëzuan kinse mungesën e objekteve alternative të përshtatshme në Prishtinë si arsye për pasivitetin e EULEX-it.¹⁰⁵ Në Kosovë është dërrmuar kredibiliteti i BE-së.¹⁰⁶

Konferenca e donatorëve për Kosovë, e mbajtur në Bruksel më 11 korrik, me ç'rast u zotuan 1.2 miliardë euro, ishte një gjest i mirëseardhur i unitetit dhe vendosmërisë së BE-së në muajt e fundit.¹⁰⁷ Të gjitha shtetet anëtare treguan përkrahje me pjesëmarrjen e tyre dhe "duke mos kundërshtuar shumën e madhe që u zotua për Kosovën nga buxheti i BE-së",¹⁰⁸ d.m.th. 508 milionë euro, përfshirë 358 milionë euro në fonde para anëtarësimit, dhe 150 milionë euro në ndihmë makroekonomike. Plani për zhvillim i Kosovës, ashtu si shpalolet në Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme (KShA) të qeverisë për vitet 2009-2011, duhet të shfrytësohet për ndërtimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor, përmirësimin e klimës së biznesit dhe të sistemeve të ar-

¹⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të EULEX-it, Bruksel, maj 2008.

¹⁰³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të shteteve anëtare dhe të BE-së, Bruksel, maj 2008.

¹⁰⁴ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, prill-qershor 2008.

¹⁰⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Bruksel dhe Prishtinë, prill-korrik 2008. Një zyrtar i UNMIK-ut tha se ishte "jomorale" që ta thotë atë, pasi që edhe zinxhiri i supermarketeve vendore Albi kishte më shumë objekte e vetura sesa që i duheshin EULEX-it. Një zyrtar tjetër i UNMIK-ut shfaqti habinë se pse EULEX-i nuk u paraqit në një aukcion të 100 veturave të UNMIK-ut. Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, 26 qershor dhe 2 korrik 2006.

¹⁰⁶ Një anketë e majit 2008 regjistroi vetëm 13 përqind kënaqësi me EULEX-in, më e ulëta në mesin e të gjitha institucioneve. Shih UNDP Early Warning Report Kosovo, Report #20/21 Special Edition January-June 2008, online në www.ks.undp.org/.

¹⁰⁷ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i Komisionit Evropian, Bruksel, 11 korrik 2008.

¹⁰⁸ Po aty.

simit dhe energjisë. Donatorët kanë theksuar se zotimet e tyre ishin me kusht që KShA do të implementohej.¹⁰⁹

C. PENGESAT NË NJU JORK

Sekretariati i OKB-së në Nju Jork ka ngecur në punën e tij për arsye të përçarjeve në Këshillin e Sigurimit. Ban Ki-moon i ofroi planit të Ahtisaarit “përkrahje të plotë” kur ia transmetoi atë Këshillit në mars 2007.¹¹⁰ Por, duke u ballafaquar me opozitë të konsiderueshme, u bë më i kujdesshëm. Më 18 shkurt 2008 ai deklaroi: “Qëllimi im është të veproj në mënyrë efektive, realiste dhe konkrete. Duke vepruar kështu, dhe në udhëzime me Këshillin e Sigurimit, ndoshta do të më duhet t’i përshtatem zhvillimeve dhe ndryshimeve në terren”.¹¹¹ Deri më 12 qershor ai nuk lëvizi më tutje.

Gjatë 120 ditëve të para të pavarësisë së Kosovës, zyrtarët e OKB-së e konsideronin planin e Ahtisaarit si pikë reference, duke u përpjekur që të implementojnë “85-90 përqind” të tij, me zvogëlimin eventual të UNMIK-ut në disa qindra anëtarë,¹¹² por duke suspenduar çfarëdo dorëzimi të mjeteve në BE. Fillimisht ishin planifikuar katër valë të zbarkimeve dhe dorëzimeve të mjeteve, me më të madhen, 1,000 anëtarë të EULEX-it, në maj 2008. UNMIK-u ndihmoi heshturazi në trajnimin e të rinjve, përfshirë këtu 130 anëtarë të stafit gjyqësor, dhe ia dorëzoi menaxhmentit të mesëm të EULEX-it qasjen në polici dhe dosje. Por Nju Jorku refuzoi që të zbatojë dorëzimin e mjeteve, objekteve dhe veturave në maj. Rusia madje kritikoi edhe ndihmën modeste të UNMIK-ut, duke i akuzuar zyrtarët e OKB-së se kishin

“kaluar kompetencat” dhe se kishin “fshehur qëllimisht informata nga Këshilli i Sigurimit”.¹¹³

Në Sekretariat u diskutua pak rreth konceptit të “rikonfigurimit pasiv”: mbi parimin e “jodyfishimit të funksioneve”,¹¹⁴ UNMIK-u do të tërhiqej dhe “do të zvogëlohej ngadalë”,¹¹⁵ gjersa akterët e tjerë t’i merrnin përsipër detyrat që i kryente ai. Por përfundimisht u morr vendimi se “rikonfigurimi aktiv”, me një plan gjithëpërfshirës, ishte më i preferueshëm. E megjithatë, përveç kompetencave kryesore mbi sundimin e ligjit, UNMIK-u në të vërtetë është duke përdorur një qasje të rikonfigurimit pasiv, duke lëshuar kompetenca e duke u tërhequr kurdo që qeveria e Kosovës t’i marrë ato dhe të fillojë ushtrimin e tyre.

Prishtina dhe përkrahësit e saj në Këshillin e Sigurimit – sidomos anëtarët e Pesëseshes – duan që sa më shpejtë të mbyllet UNMIK-u dhe t’i lëshojë hapësirë qeverisë, ZCN-së dhe EULEX-it, derisa Rusia është gati krejt e vetme, madje edhe në mesin e shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë, që thërret se UNMIK-u duhet të ruajë pushtetin dhe funksionet e veta, dhe që çfarëdo dorëzimi mjetesh të marrë së pari bekimin e Këshillit të Sigurimit.¹¹⁶

Moska ka përvetësuar një qasje legaliste, e cila është dëmtuar nga aksionet e saj ushtarake në gusht 2008 në Gjeorgji, dhe nga njohja unilaterale e Abkhazisë dhe Osetisë Jugore.¹¹⁷ Ajo thotë se do të përdorë veton në çdo propozim që do të zëvendësonte Rezolutën 1244, e cila jepte mandatin për administratën e përkohshme të OKB-së. Në qershor 2007, Pesësja hoqi dorë nga përpjekjet për të siguruar një rezolutë që do të mbështeste planin e Ahtisaarit, kurse tani argumenton,

¹⁰⁹ Shih www.seerecon.org/kdc/ për dokumentacionin nga konferenca e donatorëve.

¹¹⁰ “Secretary-General, receiving report on Kosovo’s future status, supports proposal” [“Me pranimin e raportit mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm mbështet propozimin”], UN Department of public Information, SG/SM/10923, 26 mars 2007, në www.un.org/News/Press/docs/2007/sgsm10923.doc.htm.

¹¹¹ “Secretary-General in Security Council Statement says United Nations Aim in Kosovo Stable Political, Security Situation, Protection of Population, Minorities” [“Në deklaratën drejtuar Këshillit të Sigurimit Sekretari i Përgjithshëm thotë se Kombet e Bashkuara mëtojnë në Kosovë një situatë stabile politike e të sigurisë, mbrojtje të popullatës, pakicave”], SG/SM/11426SC/9253, në www.un.org/News/Press/docs/2008/sgsm11426.doc.htm.

¹¹² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i OKB-së, Nju Jork, 14 prill 2008.

¹¹³ Deklaratë nga Vitali Çurkin, Përfaqësues i Përhershëm i Federatës Ruse, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Rezolutën e Çështjes së Kosovës, Nju Jork, 20 qershor 2008.

¹¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i UNMIK-ut, Prishtinë, 6 maj 2008.

¹¹⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të OKB-së, Prishtinë, 30 prill dhe 6 maj 2008. Nga prilli UNMIK-u akomodoi dhe ofroi një trajnim fillestar për 130 gjykatës, prokurorë dhe staf të tjerë të EULEX-it. Nën “rikonfigurimin pasiv”, po që se EULEX-i kishte marrur nismën për t’u vendosur nëpër gjykata në tërë Kosovën, me siguri OKB-ja do të kishte vendosur se nuk ka nevojë për gjykatësit dhe prokurorët e vet ndërkombëtar dhe do t’i kishte tërhequr ata.

¹¹⁶ Vietnam i ka përkrahur qëndrimin radikal të Ruisë në seancat e 20 qershorit dhe 25 korrikut të Këshillit të Sigurimit të OKB-së; Kina ka qenë më e dykuptimtë në qëndrimin e saj.

¹¹⁷ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave Nr. 195, *Rusia kundër Gjeorgjisë: prishja*, 22 gusht 2008.

me arsyetime të bollshme, se 1244 është mjaft e gjerë që të legjitimojë pavarësinë dhe misionet e BE-së.¹¹⁸

Gjatë 120 ditëve të para Rusia ka dhënë indikacione se do të mund t'i pranonte ZCN-në dhe EULEX-in si shtylla "neutrale ndaj statusit" nën UNMIK-un, ndërsa 1244-shi të qëndrojë në operacion, të mos mirret parasysh plani i Ahtisaarit dhe të emërohet një PSSP i ri që do të shërbente njëkohësisht si PCN.¹¹⁹ Mirëpo, këtu misionet e BE-së dhe deklarata e pavarësisë karakterizohen si akte të njëanshme që përjashtohen nga 1244.¹²⁰ Ajo thotë se marrja përsipër e OKB-së nga BE-ja në këto rrethana dëmton autoritetin e Këshillit të Sigurimit, dhe do ta bënte sjelljen e BE-së të krahasueshme me atë në Eritre, e cila kohëve të fundit e dëboi UNMEE-në.¹²¹ Zyrtarët e saj kanë folur për përdorimin e vetos mbi termin e dytë të Sekretarit të Përgjithshëm, nëse ai e implementon rikonfigurimin pa autorizim të Këshillit të Sigurimit,¹²² e nëse e bën këtë gjë, kjo të paktën do të komplikonte punën e misioneve të tjera të OKB-së.

Hapësira për manovrim e Ban Ki-moon-it po ashtu është ndikuar nga fuqia relative e secilës palë mbi anëtarët jo të përhershëm të Këshillit. Rotacioni i janarit 2008 i pesë nga pesëmbëdhjetë anëtarëve të Këshillit zvogëloi shumicën e dhjetë anëtarëve që ishin pro planit të Ahtisaarit më 2007. Vetëm 47 nga 193 shtetet anëtare të OKB-së e kanë njohur Kosovën deri më tani, por ky balanc u zhvendos në favor të Kosovës brenda Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kur në seancën e Këshillit të 18 prillit shumica e dënuan

¹¹⁸ Shih argumentet për një rivlerësim të tillë të Rezolutës së KSOKB-së 1244 në Raportin për Evropë të Grupit të Krizave Nr. 188, *Numërimi i fundit në Kosovë: udhëzim për tranzicion*, 6 dhjetor 2007, faqet. 14-16. Në fund të vitit 2007 MB-të ia dorëzuan Pesështes dhe partnerëve të BE-së opinionin e tyre ligjor, ku argumentohej se referenca në 1244 për sovranitetin e Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Kosovë ishte, si pjesë e preambulës, legalisht jo efektive.

¹¹⁹ Ky person do të duhej të ishte më "neutral" se PCN-ja i tashëm, Pieter Feith. Aprovimi i Këshillit të Sigurimit për këtë aranzhim do të mund të formalizohej me një deklaratë presidenciale. Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i lartë rus, Nju Jork, 15 maj 2008.

¹²⁰ Rusia ka deklaruar se do të votojë në favor të rikonfigurimit vetëm nëse Beogradi pajtohet me këtë. Deklaratë nga Vitali Çurkin, Përfaqësues i Përhershëm, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Rezolutën e Çështjes së Kosovës, Nju Jork, 20 qershor 2008.

¹²¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë rus, Nju Jork, 15 maj 2008. Për prapavijë informatash për UNMEE, shih Raportin për Afrikë të Grupit të Krizave Nr. 141, *Përtej paqes së brishtë në mes Etiopisë dhe Eritresë: shmangia nga lufta e re*, 17 qershor 2008.

¹²² Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat rus, Bruksel, qershor 2008.

dhunën e mbështetur nga Beogradi kundër UNMIK-ut, dhe u duk se e pranuan faktin se do të tolerohej adaptimi i OKB-së.¹²³ Më 20 qershor së paku dhjetë anëtarë të Këshillit ishin në favor të planit të Sekretarit të Përgjithshëm për t'i dhënë BE-së një "rol të theksuar operacional" në një prani të rikonfiguruar të OKB-ë.¹²⁴ Përkrahja u konsolidua në seancën e 25 korrikut.¹²⁵

Ministri i atëhershëm i Serbisë për Kosovën, Sllobodan Samarxhiq (DSS), propozoi më 15 mars që UNMIK-u të bashkëqeverisë pjesët me shumicë serbe të Kosovës në gjashtë fusha funksionale: polici, gjyqësi, dogana, transport, kontrollim të kufirit Serbi-Kosovë, dhe trashëgimi fetare, historike e kulturore serbe.¹²⁶ Duke pasur këtë si pikën startuese dhe në përpjekje të fitimit të bashkëpunimit serb, në fillim Sekretariati e udhëzoi zyrën e saj në Beograd që të shqyrtojë një koncept të marrëveshjes, pastaj në maj dërgoi Jean-Marie Guehenno, Nën-Sekretarin e Përgjithshëm të atëhershëm për Operacione Paqeruajtëse, në Serbi dhe Kosovë, për të eksploruar hapësirën për kompromis.

Më 17 shtator Serbia prezantoi një mocion në Asamblenë e Përgjithshme, me të cilën kërkohej mendimi këshillëdhënës i Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë (GjND) mbi legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.¹²⁷ Zyrtarët i kanë injoruar thirrjet nga ministri

¹²³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i OKB-së i pranishëm në seancën e përmbylljes, 2 korrik 2008.

¹²⁴ Në seancën e 20 qershorit 2008, vetëm Vietnam i përkrahu Rusinë. Kina nuk u shpreh. Dy vende të tjera që nuk e kanë bërë njohjen, Panamaja dhe Indonezia, i dhanë mbështetje propozimit. Afrika e Jugut nuk foli. Shënimet nga mbledhja në www.un.org/Depts/dhl/resguide/scact2008.htm.

¹²⁵ Shënimet nga mbledhja në www.un.org/Depts/dhl/resguide/scact2008.htm.

¹²⁶ Propozimi mbi "Implementimin e Përbashkët të RKSOKB-së 1244 pas shpalljes ilegale të pavarësisë nga IPVQ-së". Ky propozim do të kishte përjashtuar qeverinë e Kosovës (ish-Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes) dhe BE-në nga bashkëpunimi Serbi-OKB, pasi që të dyjat ishin fajtorë për "akte ilegale", do të kishte njohur zyren e Ministrisë së Serbisë për Kosovë në Mitrovicën e veriut, në përgjithësi do të kishte njohur "autoritetet legjitime të serbëve të Kosovës", dhe do të kishte ruajtur praninë dhe autoritetin e UNMIK-ut nën Rezolutën 1244. Që nga 1 maji UNMIK-u dhe Serbia do të kishin krijuar organe të përbashkëta për bashkëpunim, për të mbikëqyrur gjashtë fushat e politikave.

¹²⁷ Projekt mocioni shtron një pyetje të thjeshtë para GjND-së: "A është shpallja unilaterale e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?" Zëvendëskryeministri Bozhidar Djeliq i shpjegon qëllimet e Serbisë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në "For the Good of Europe Give Serbia A Chance" ["Për të mirën e Evropës jepjani një shans

i jashtëm i Francës, Bernard Kushner,¹²⁸ dhe ambasadori britanik në Beograd, Stivën Uordsuorth,¹²⁹ që të qëndrojnë larg GjND-së, nëse duan të mos dëmtojnë mundësitë për anëtarësim në BE me 21 anëtarët e saj të cilët tashmë e kanë njohur Kosovën.¹³⁰ Beogradi është duke llogaritur se do të ketë përkrahje në Nju Jork nga shumë vende të cilat nuk e kanë njohur atë. Në Konferencën e Ministrave të Lëvizjes së të Painkuadruarve në Teheran, Ministri i Jashtëm Vuk Jeremiç tha “Shpresoj se anëtarët do të shohin vazhdimësinë e plotë të qëndrimit të Serbisë në çështjen e Kosovës me parimet e Lëvizjes, dhe se ju do të përkrahni kauzën tonë sikur të ishim akoma një nga ju”.¹³¹ India u zotua për përkrahje.¹³² Mocioni i kaloi pengesat e para më 18 dhe 19 shtator, kur Komiteti i Përgjithshëm i OKB-së e kaloi atë për përfshirje në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme.

Që nga njohja e Abkhazisë dhe Osetisë Jugore nga Moska, si shtete të pavarura nga Gjeorgjia më 26 gusht, Beogradi nuk mund të jetë më i sigurt për përkrahje të fuqishme në kërkim të gjykimit ligjor, sidomos pasi që Gjeorgjia ka hapur nja rast kundër aksioneve ruse gjatë konfliktit të kohëve të fundit.¹³³ Megjithatë, ekzistojnë shansa të mira që kërkesa

Serbisë”, *Financial Times*, 3 gusht 2008. Në një intervistë Presidenti Tadiç tha, “të gjithë e dinë se çka duam ne: që vendet e botës të dëgjojnë qëndrimin e institucionit më të lartë ndërkombëtar të drejtësisë, dhe që qëndrimi i atij [institucioni] të reflektohet në vendimet e tyre”. Presidenti Tadiç në “Samo pomirenjem branimo naciju” [“Vetëm me pajtim mund të mbrojmë kombin”], *Vecernje Novosti*, 6 korrik 2008.

¹²⁸ Shih “EU ‘Can’t Accept’ Serbia’s World Court Move” [“BE-ja ‘nuk mund të pranojë’ nismën e Serbisë për në Gjykatën Botërore”], *Balkan Insight*, 28 gusht 2008; dhe “Serbia warned not to play against EU camp” [“Serbia u paralajmërua që të mos luajë kundër kampit të BE-së”], *Euractiv*, 20 gusht 2008.

¹²⁹ “Vordsvort protiv inicijative Srbije” [“Uordsuorth kundër nismës së Serbisë”], B92, 3 gusht 2008.

¹³⁰ Ministri i jashtëm Jeremiç në “Hardtalk” të BBC World, 1 gusht 2008; dhe “Sta Srbija trazi” [“Çka lyp Serbia”], *Standard Magazine*.

¹³¹ “Jeremiç seeks support of Non-Aligned” [“Jeremiçi kërkon përkrahjen e të painkuadruarve”], B92, 31 korrik 2008.

¹³² Ambasadori i Indisë në Beograd, Ajay Sëarup, tha, “India qëndron pas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe nuk njih ndarjen e Kosovës... India do t’i qëndrojë besnike parimeve të saj në të ardhmen dhe në seancën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në fund të këtij viti.” “India to Back UNGA bid” [“India do të përkrahë kërkesën në UNGA”], B92, 31 korrik 2008. Serbia gjithashtu pohoi të ketë përkrahjen e Singaporit: “Jeremiç: Podrska Singapura” [“Jeremiçi: përkrahja e Singaporit”], B92, 12 gusht 2008, dhe vazhdoi me lobim në mbledhjen e ministrave të jashtëm të Ligës Arabe, Kairo, në javën e dytë të shtatorit.

¹³³ Gjeorgjia mund të kërkojë votë të ngjashme në Asamblenë e Përgjithshme mbi njohjen nga ana e Rusisë të Osetisë Jugore dhe Abkhazisë. Ajo po ashtu do të kërkojë nga shtetet që të jetë shumë të kujdesshme në çështjen e vetëvendosjes.

për kërkim të mendimit të GjND-së do të kalojë. Disa kanë speculuar se kjo lëvizje nga qeveria e re serbe që t’ia dorëzojë çështjen GjND-së, së cilës do t’i duhen disa vite për të formuluar mendimin e vet, do t’i ofrojë asaj hapësirë për të marrë frymë, si dhe do të ngadalësojë hapin e njohjeve të Kosovës gjatë kësaj kohe.

D. PROPOZIMI I BAN KI-MOON-IT PËR RIKONFIGURIM

Pesë ditë pasi që Këshilli i Sigurimit kishte diskutuar planin e rikonfigurimit të Sekretarit të Përgjithshëm më 20 qershor, udhëzimet për implementimin e tij i ishin transmetuar UNMIK-ut në Prishtinë. Kjo në efekt shënoi fillimin e një periudhe të dytë 120-ditore tranzitore, edhe pse për dy muaj me radhë pati ngatërresa mbi fillimin e datës operacionale.¹³⁴ Plani ishte kompromis, duke marrë parasysh preferencat konfliktuoze të Pesëshes në njërin anë, dhe të Rusisë dhe Serbisë në anën tjetër. Autoritetet e Kosovës qenë të fundit që u konsultuan, mirëpo anipse plani thoshte se OKB-ja nuk do të dorëzonte mandatin e saj për së paku edhe katër muaj të tjerë, ndërsa i dha Beogradit pak ndikim në formësimin e rikonfigurimit, ata prapë e mirëpritën si një hap përpara.¹³⁵

Në raportin e tij, Sekretari i Përgjithshëm shpjegoi se “kushtet në terren kërkojnë adaptim praktik ndaj strukturës dhe profilit të UNMIK-ut”¹³⁶ pasi që ekziston “një nevojë e ngutshme për zgjidhje... për të zvogëluar tensionin dhe për të ruajtur stabilitetin në Kosovë dhe rajonin më gjerë”.¹³⁷ Bani-i e mirëpriti ofertën e BE-së për prani të reja civile si “zhvillim kyç” që do të “shërbejë si shtesë” në punën e OKB-së, dhe do t’i ndihmojë “trashëgimisë pozitive” të saj në Kosovë. Kështu që, lajmëroi ai, “planifikoj të rikonfiguroj praninë civile ndërkombëtare në Kosovë... për t’ia mundësuar Bashkimit Evropian forcimin e rolit të saj operacional në fushën e sundimit të ligjit”.¹³⁸ Parashihet që BE-ja gradualisht të marrë përgjegjësi në

¹³⁴ Duket se marrëveshja e transferimit të mjeteve e 18 gushtit në mes të OKB-së dhe BE-së, solli deri në përfundim këtë ngatërrim.

¹³⁵ Shih Bukurie Bajraliu, “Sejdiu: Kërkova që Rikonfigurimi të kryhet sa më shpejt”, *Koha Ditore*, 23 qershor 2008.

¹³⁶ Kushtet e cituara përfshijnë “Shpalljen e Pavarësisë” të Kosovës, reagimin e serbëve të Kosovës dhe të serbëve, konfrontimet violente në shkurt-mars, hyrjen në fuqi të kushtetutës së Kosovës, gatishmërinë e BE-së për të luajtur një rol të theksuar dhe përfundimin e financimit të Komisionit Evropian për Shtyllën IV të UNMIK-ut. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 qershor.

¹³⁷ Po aty.

¹³⁸ Po aty.

policimin ndërkombëtar, drejtësi dhe dogana nëpër tërë Kosovën, derisa roli operacional i OKB-së të tkurret në atë të një raportuesi, ndërmjetësuesi dhe lehtësuesi të dialogut. Parashikohet që EULEX-i të veprojë nën "autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara" dhe Rezolutën 1244. Bani-i më tutje specifikonte se EULEX-i do të punojë "nën një 'çadër të OKB-së' që kryesohet nga Përfaqësuesi im Special".¹³⁹

Se si do të funksionojë kjo nuk është e qartë. Për shembull, a do të jetë PSSP-ja apo kryesuesi i EULEX-it në krye të policisë? Në fillim të korrikut shefi i EULEX-it de Kermabon e bëri të qartë pikëpamjen e tij se mandati kryesor i tij ishte dhënë nga Veprimet e Përbashkëta të BE-së, dhe se ai i përgjigjet Brukselit.¹⁴⁰ Zyrtarë të tjerë të BE-së e shohin çadrën e OKB-së, deri në atë masë që ajo ekziston, thjesht si mekanizëm për të mundësuar zbatimin e EULEX-it, pas të cilit zbatim ai do të veprojë pa referenca ndaj Nju Jorkut.¹⁴¹ Rusia insiston se logjika e raportit të Sekretarit të Përgjithshëm është që UNMIK-u të qëndrojë në krye, ndërsa rikonfigurimi nuk mund të ecë para nëse EULEX-i nuk e kupton këtë dhe abuzon me hapësirën që i është dhënë nga OKB-ja në Kosovë. Gjatë gushtit zyrtarët e BE-së ishin më të qetë, mirëpo deklaratat e mëhershme të shefit të EULEX-it e kanë bërë më të vështirë për Sekretariatit e OKB-së që të mbrojnë rikonfigurimin karshi kundërshtimeve të Ruisisë.¹⁴² Në ndërkohë, ZCN-ja nuk ka vend nën çadrën e OKB-së dhe nuk është e përmendur në raportin e Bani-it të 12 qershorit.

Bani-i shpjegoi komponentin e dytë të planit në një letër drejtuar Presidentit Tadiq, një kopje e së cilës iu dërgua edhe Presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu. Duket se aty ai pajtohet me një implementim të pjesëshëm nga Beogradi të propozimit të 15 marsit nga Samarxhiqi për formalizimin e ndarjes së pjesëve me shumicë serbe në Kosovë nga administrimi i Prishtinës, dhe për bashkëqeverisjen e tyre nga UNMIK-u dhe Beogradi, si kompenzim për pranimin e formulës së rikonfigurimit të influencuar nga Pesëshja. Bani-i i ofroi Tadiqit një dialog me Zannierin, PSSP-në e tij të ri, mbi rregullimin e aranzhimeve të qeverisjes në gjashtë fushat e përmendura nga Samarxhiqi.

Kjo në efekt e legjitimon agjendën e Samarxhiqit për ndarje etnike dhe e fut në fjalorin e OKB-së konceptin

"pjesë me shumicë serbe" me kalkulimin se për pranimin e serbëve me rikonfigurimin do t'ia vlejë një dëmton i "trashëgimisë pozitive" të OKB-së të ndërtimit të institucioneve multietnike. Megjithatë, substanca e asaj që Bani-i ofroi si marrëveshje në gjashtë fushat ishte shumë më e paktë sesa që kishte parashikuar Samarxhiqi; PSSP-ja po ashtu do të "konsultohet me hisedarë të tjerë relevantë" (d.m.th. Prishtinën dhe BE-në, kështu që "aranzhimet e përkohshme" që dalin nga kjo do të "aplikohen për një kohëzgjatje të kufizuar dhe pa paragjykim ndaj statusit të Kosovës").¹⁴³

Sekretari i Përgjithshëm propozoi që sa i përket gjashtë fushave, Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) që vepron në pjesë "relevante" me shumicë serbe, duhet t'i raportojë policisë ndërkombëtare "nën autoritetin gjithëpërfshirës të Përfaqësuesit tim Special". Gjyqet e reja do të krijohen në pjesët serbe, por do të funksionojnë "brenda një sistemi ligjor të Kosovës nën ligjin e zbatueshëm, brenda kornizës së Rezolutës 1244". Riorganizimi i negociuar i doganave do të risjellë zyrtarët ndërkombëtarë në portat e veriut dhe, në fund të fundit, do t'ia mundësojë Kosovës që "të vazhdojë që funksionojë si një zonë e vetme doganore". Serbisë iu ofrua pjesëmarrja në komisionin koordinues teknik për transport dhe infrastrukturë, të udhëhequr nga PSSP-ja. NATO-ja do të vazhdojë të garantojë për kufijtë e Kosovës. Mbrojtja ndërkombëtare u ofrua për Kishën Ortodokse Serbe, e cila do të kishte juridiksion ekskluziv në pronat e saj në Kosovë.¹⁴⁴

Kështu, propozimi i Bani-it kryesisht kishte për qëllim që të ruajë Kosovën si një entitet funksional, politik dhe administrativ, por me disa devijime dhe mburoja shitesë për serbët. Disa dispozita, siç është ajo mbi trashëgiminë fetare, mund të shikohen si gjëra që tashmë janë në planin e Ahtisaarit. Ca të tjera rrezikojnë ta dëmtojnë atë. T'ia lejosh ShPK-së serbe që të operojë brenda OKB-së e jo brenda zinxhirit komandues të qeverisë së Kosovës, do të jetë sfiduese ndaj zinxhirit komandues të unifikuar nëpër tërë Kosovën, nën ministrinë e brendshme, si parashikohet nga Ahtisaari¹⁴⁵ dhe legjislatura e Kosovës.

Raporti i Bani-it nuk jepë kornizë kohore për rikonfigurim, edhe pse fillimisht dhe joformalisht u kuptua se është 120 ditë, kurse në Prishtinë mendohet se fundi i nëntorit apo dhjetori 2008 është afati për dorëzim të EULEX. Aty po ashtu nuk bëhet e qartë se a mund të vazhdohet me këtë raport pak a shumë

¹³⁹ Po aty.

¹⁴⁰ Deklarata në mediat e Kosovës, 7 korrik 2008; dhe intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, qershor 2008.

¹⁴¹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 30 korrik 2008.

¹⁴² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë, Nju Jork, gusht 2008.

¹⁴³ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 qershor 2008.

¹⁴⁴ Po aty.

¹⁴⁵ Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, Aneksi VIII, Neni 2.

automatikusht, apo varet nga dialogu i PSSP-së me Beogradin mbi aranzhimet e përkohshme në të gjashtë fushat. Në javët paraprake, zyrtarët ia kishin transmetuar opsionin e parë Prishtinës, ndërsa të dytin Beogradit. Edhe pse Ban-i deklaroi se PSSP-ja i tij vetëm se do të “konsultohet me hisedarët e tjerë”, në përgjigjen e tij të 16 qershorit Presidenti Sejdiu theksoi se OKB-ja duhet të kryejë detyra vetëm për një “kohëzgjatje të kufizuar”, dhe ia rezervoi Prishtinës të drejtën e vetos: “Ju falënderojmë për përkushtimin tuaj që të konsultoheni për së afërmi me ne, sepse aranzhimet e tilla nuk mund të jenë të mundshme pa pjesëmarrjen dhe aprovimin e Qeverisë së Kosovës”.¹⁴⁶ Qeveria e re e Serbisë thotë se është e gatshme të bisedojë, por beson se është ajo që rezervon veton, duke thënë se rikonfigurimi “nuk mund të bëhet në mënyrë të njëanshme”¹⁴⁷ dhe “nuk mund të jetë valid pa pajtimin e Beogradit”.¹⁴⁸

Plani i rikonfigurimit ia lejon OKB-së të qëndrojë në Kosovë më gjatë sesa që planifikohet nga Ahtisaari, si dhe të prolongojë ndikimin e saj në të paktën gjashtë fusha. Zannier-i planifikon që UNMIK-u të reduktohet për 70 për qind pas kësaj periudhe të dytë 120 ditëshe,¹⁴⁹ por struktura specifike që mbetet ende nuk është sqaruar dhe kjo varet pjesërisht nga suksesi i zbarkimit të EULEX-it.¹⁵⁰ Letrat e Ban-it nuk kërkonin përkrahjen e palëve për t’u siguruar se BE-ja do të zbarkohet dhe do të operojë në tërë Kosovën. Se deri në ç’skallë zbarkimi dhe hapësira e operimit të EULEX-it do të kufizohet nga marrëveshjet OKB-Beograd, mbetet një pyetje e hapur. Edhe pse shefi i EULEX-it de Kermabon dëshiron bashkëpunim teknik me Beogradin,¹⁵¹ Kryeministri i Serbisë Mirko Cvetković dëshiron që Beogradi të ndihmojë në krijimin dhe formësimin e EULEX-it.¹⁵² Derisa OKB-ja dëshiron që të dorëzojë përgjegjësitë mbi policinë, drejtësinë dhe doganat te misioni i BE-së, EULEX-i

nuk është duke marrë pjesë në bisedimet UNMIK-Beograd.¹⁵³

Pesëshja në përgjithësi ishte e kënaqur me idetë e Bani-it, mirëpo donte më shumë siguri mbi rolin reduktues të OKB-së.¹⁵⁴ Rusia reagoi negativisht. Ambasadori Çurkin e informoi Sekretarin e Përgjithshëm se Moska pret që ai “nuk do të ndërmarrë veprime të pavarura, pa... leje nga Këshilli i Sigurimit, mbi rikonfigurimin e UNMIK-ut”, dhe se “diskutimi i tashëm është vetëm faza fillestare e zhvillimit, në mesin e vendimeve të mundshme të Këshillit të Sigurimit në temën në fjalë”.¹⁵⁵ Pasi që Ban-i i dërgoi udhëzimet në UNMIK më 25 qershor, ministria e jashtme ruse e përcolli këtë me një deklaratë që e akuzon atë se kishte “tejkalluar pushtetin e autoritetit të tij me marrjen e një vendimi që është brenda autoritetit të Këshillit të Sigurimit”.¹⁵⁶ Më 8 korrik Çurkini kërkoi që të pushojë aktiviteti i rikonfigurimit, sepse po ia lejonte agjendës “tërësisht tjetër” të EULEX-it që të uzurponte mandatin 1244 të UNMIK-ut.¹⁵⁷

Presidenti Tadiq iu përgjigj Bani-it se rikonfigurimi është prerogativa e Këshillit të Sigurimit, por se Serbia ishte e gatshme të diskutojë mbi gjashtë fushat prioritare me OKB-në.¹⁵⁸ Në prag të formimit të qeverisë së re në Beograd, ai shprehu lehtësim me faktin se plani i Bani-it e linte UNMIK-un në Kosovë, vëreu se një shumicë e qartë e Këshillit e përkrahte planin, dhe tha se në rrethanat e reja Serbia duhet të arrijë marrëveshje me komunitetin ndërkombëtar.¹⁵⁹ Derisa që nga ajo kohë qeveria e re e Serbisë është ngurtësuar në qëndrimin se EULEX-i është i papranueshëm nëse Beogradi nuk ka rol në formësimin e tij, dhe nëse nuk është në pajtim me Këshillin e Sigurimit, ajo megjithatë mund të jetë e kënaqur me një deklaratë presidenciale, në vend të një rezolute të re të Këshillit të Sigurimit.¹⁶⁰ Ajo gjithashtu thotë se “ne

¹⁴⁶ Letër nga Presidenti Sejdiu drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-moon, 16 qershor 2008.

¹⁴⁷ Jeremiqi në “New govt. to cooperate on UNMIK reconfiguration” [“Qeveria e re të bashkëpunojë me rikonfigurimin e UNMIK-ut”].

¹⁴⁸ Tadiqi, *Vecernje Novosti*.

¹⁴⁹ Deklaratë e zëdhënësit të UNMIK-ut Aleksander Ivanko, 11 gusht 2008. Kjo është më shumë një fazë, e jo mbarimi i reduktimit. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i UNMIK-ut, Prishtinë, 31 korrik 2008.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ “EULEX ready for technical cooperation” [“EULEX-i i gatshëm për bashkëpunim teknik”], B92, 26 gusht 2008.

¹⁵² Shih intervistën e tij, “Kosovo izazvalo domino efekat” [“Kosova ka provokuar efekt domino”], *Politika*, 28 gusht 2008.

¹⁵³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 26 gusht 2008.

¹⁵⁴ Ambasadori amerikan Khalilzad e vërejtë këtë si dhe mungesën e një reference specifike për nevojën për diskutime, në mënyrë që të shërbejë si informacion në marrëveshje me qeverinë e Kosovës, në deklaratën e tij për media pas seancës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 20 qershor 2008.

¹⁵⁵ Fjalim në Këshillin e Sigurimit, Nju Jork, 25 korrik 2008.

¹⁵⁶ Deklaratë për shtyp e ministrisë së jashtme ruse, 27 qershor 2008.

¹⁵⁷ Vërejtjet e ambasadorit Çurkin në media, Nju Jork, 8 korrik 2008.

¹⁵⁸ Tadiqi, përgjigje Ban Ki-moon-it, 12 qershor 2008, e rishtypur në *Zeri*, 16 qershor 2008.

¹⁵⁹ Tadiqi, *Vecernje Novosti*.

¹⁶⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë të BE-së, Bruksel, shtator 2008.

vazhdojmë të theksojmë se duam të jemi të përfshirë”.¹⁶¹

Mirëpo në fund të fundit, propozimi i Sekretarit të Përgjithshëm është vetëm një pikë fillestare për një tranzicion të cilit i mungon qartësia, dhe është larg një plani të formësuar. Zannier-i e pranoi para shtypit: “Nuk ka agjendë të qartë, dhe do të shohim se ku jemi në fund të këtij procesi të rikonfigurimit”.¹⁶² EULEX-i e pranon se zbarkimi i tij mund të ketë nevojë për së paku dy faza, ndoshta me muaj në midis, që mënyrë që të jetë plotësisht operacional.¹⁶³ Zvogëlimi i mëtutjeshëm i UNMIK-ut dhe zbarkimi i sukseshëm i EULEX-it janë të ndërvarura. Diskutimet mbi gjashtë fushat e aranzhimeve praktike me Beogradin filluan më 23 korrik, dhe u vijuan me ca mbledhje të thjeshta më 30 korrik, 25 gusht dhe 12 shtator.

Ndërkohë, në Nju Jork rusët janë duke e vëzhguar për së afërmi planin e rikonfigurimit. Sipas një zyrtari të brendshëm në OKB, të paktën deri para krizës së gushtit në Gjeorgji, diplomatët rusë vizitonin divizionin për paqeruajtje të Sekretariatit disa herë në javë, për të monitoruar dhe bërë presion implicit.¹⁶⁴ Moska i bëri presion divizionit pas aranzhimit të 18 gushtit me BE-në, mirëpo nuk ka mjete për ta bllokuar atë. Transferimi i të gjitha mjeteve të UNMIK-ut te BE-ja do të duhej të shkojë nëpërmjet komisioneve të Asamblesë së Përgjithshme, kur rusët do të kërkonin përkrahje për stopimin e këtij procesi, nëse dëshirojnë, mirëpo aranzhimi i 18 gushtit flet vetëm për shitjen e mjeteve të misionit që nuk mund të transferohen për përdorim në misionet e tjera të OKB-së, dhe konsiderohet si dokument i brendshëm. Pasi që Serbia tani po jepë ca sinjale për interes në këtë rikonfigurim, dhe me absorbimin e një energjie të madhe diplomatike të Rusisë nga Gjeorgjia, ka shansa se Moska do të bëjë përpjekje më të vogla drejt bllokimit të rikonfigurimit.¹⁶⁵

III. SITUATA NË TERREN

A. HAPAT E PARË SHTET-FORMUES TË PRISHTINËS

Gjatë 120 ditëve të para, koalicioni qeverisës PDK/LDK nën udhëheqjen e Hashim Thaçit, u tregua i diciplinar dhe përmirësoi imazhin e Kosovës jashtë. Ajo iu shmang retorikës nacionaliste apo përgjigjes së vrazhdë ndaj provokimeve të Beogradit ose serbëve të Kosovës, dhe iu përmbajt zotimeve për multi-etnicitet, si dhe miratoi 41 ligje të reja, në mënyrë që plani i Ahtisaarit ishte gati krejt i kompletuar me ardhjen në fuqi të kushtetutës më 15 qershor 2008. Deri në një masë të madhe, ky progres ishte i mundshëm sepse qeveria dëgjoi udhëzimet e Sh.B.A.-ve dhe ZCN-së. Sensi i saj për simbolizëm ishte i përshtatshëm për detyrat e 120 ditëve të para, mirëpo aftësia e saj për të qeverisur nuk është barazpeshuar, pikëpamja e saj është e kufizuar, ndërsa kapaciteti i saj për të arritur kompromise politike, gjë kjo e domosdoshme për të akomoduar serbët dhe për të shmangur ndarjen, pra këto kompromise janë të pasigurta.

1. Ligjëbërja

Shumica e 90 përqind të shumicës së shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë kushtetutën, e cila kërkon balancimin në mes të të drejtave të individëve dhe komuniteteve,¹⁶⁶ si “tepër moderne” dhe e kredhur në multietnicitet.¹⁶⁷ Për hir të shtetësisë ajo i zgjeron dhe i adapton operacionet e shumicës së institucioneve të përkohshme¹⁶⁸ dhe krijon disa të reja. Komuniteteve pakicë u jepen mbrojtje shpesh, si për shembull një mekanizëm për të parandaluar mposhtjen e tyre në vota në Kuvend në çështje të “interesave vitale”. Çështje të tjera, siç është krijimi i komunave të reja serbe, si dhe e drejta e të gjitha pjesëve me shumicë

¹⁶¹ Intervistë me Kryeministrin Cvetkoviç, *Politika*, 28 gusht 2008.

¹⁶² Briefing për shtyp nga PSSP-ja Lamberto Zannier, Prishtinë, 25 qershor 2008.

¹⁶³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 30 korrik dhe 26 gusht 2008.

¹⁶⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, stafi i OKB-së, Nju Jork, korrik 2008.

¹⁶⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, stafi i OKB-së, Nju Jork, shtator 2008.

¹⁶⁶ Neni 3 i Kushtetutës, që mund të shkarkohet nga www.gazeta.zyrtare.com.

¹⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Ministri i Jashtëm Skënder Hyseni, 29 maj 2008. Edhe pse zakonet tradicionale të Kosovës si dhe kërcënimi i dhunës e mbajnë homoseksualitetin të fshehur, kushtetuta lejon partneritete qytetare të gjinisë së njëjtë. Drafti origjinal i Neni 3 thotë: “Republika e Kosovës është shoqëri shumëtnike”. U ndryshua në “Republika e Kosovës është shoqëri shumëtnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera”. Përkundër kritikave, qeveria insiston se do të promovojë dhe do ta mbrojë këtë koncept. Intervistë e Grupit të Krizave, Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, Prishtinë, 28 maj 2008.

¹⁶⁸ Siç thuhet në Kornizën Kushtetuese 2001 të UNMIK-ut, shih www.unmikonline.org/constframework.htm.

serbe për të marrur ndihma teknike nga Beogradi, janë pjesë e pakos së ligjeve pasuese, por jo në kushtetutë.

Kushtetuta deklaroi se sovraniteti i Kosovës “rrijë nga”, dhe “i takon” popullit, por edhe se marrëveshjet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare vjen përmbi ligjin vendor, ndërsa ca kompetenca të caktuara mund t’i delegohen organizatave ndërkombëtare. Flitet për themelimin e një gjyqi që do të jetë autoriteti final për interpretimin kushtetues. Dy kapitujt e fundit të kushtetutës, të cilët përshkruajnë marrëveshjet e përkohshme, ia delegojnë autoritetin PCN-së,¹⁶⁹ vendimet e të cilit nuk mund të sfidohen nga ndonjë institucion i Kosovës. Planit të Ahtisaarit i jepet përparësi në krahasim me kushtetutën, në rast se ndodhin mospërputhje në mes të dyjave.¹⁷⁰

41 ligjet shtet-formuese u miratuan në disa pako në seanca të jashtëzakonshme, pa debatet e zakonshme parlamentare.¹⁷¹ Shumica syresh vinin nga plani i Ahtisaarit, dhe të gjitha kishin kaluar nëpër filterin e ZCN-së. Aty përfshihen ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, si dhe legjislacioni tjetër me orientim nga pakicat, për të lejuar decentralizimin dhe krijimin e zonave të veçanta të mbrojtjes. Janë përfshirë ligjet me të cilat themelohen institucionet e reja, siç është forca e sigurisë, agjencia e inteligjencës dhe shërbimi diplomatik, dhe me të cilat modifikohen ato ekzistuese, siç është ai për policinë, bankën qendrore, hekurudhat dhe fondin e trustit pensional, si dhe legjislacioni që rregullon çështje si simbolet shtetërore, nënshtrësisë, aviacionin civil dhe telekomunikacionin. Vetëm ligji për pushimet zyrtare shkaktoi kundërshtime të konsiderueshme dhe numër të afërt votash. Në formën e tij origjinale, ai ligj përjashtoi tri data që janë të dashura për shqiptarët e Kosovës, që festojnë ditën e flamurit shqiptar (28 nëntori 1912), hyrjen e NATO-s në Kosovë (12 qershori 1999) dhe martirët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (rrethimi i Jasharëve, 6 marsi 1998).¹⁷²

¹⁶⁹ Fundi i mandatit do të vendoset nga PCN-ja dhe GUN-i.

¹⁷⁰ Shih Kapitullin XIII të Dispozitave Finale, Neni 143, Para. 2: “Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës me datë 26 mars 2007, kanë përparësi mbi të gjitha dispozitat tjera ligjore në Kosovë”, në www.gazeta.zyrtare.com.

¹⁷¹ Disa përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave nuk e mirëpritën kufizimin e procedurat dhe debatin e zakonshëm demokratik. Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, maj-qershor 2008.

¹⁷² Ky draft u kundërshtua nga opozita si dhe nga shumë deputetë të qeverisë. U riformulua që të përfshinte edhe dhjetë “ditë të përkujtimit”, pa statusin e pushimeve zyrtare (një

Dy ligje që përmenden në planin e Ahtisaarit akoma nuk janë diskutuar. Një që ka të bëjë me dëshmërbëblimin e pronës nuk është i popullarizuar me shqiptarët e Kosovës, të cilët besojnë se në mënyrë joproporcionale do t’i shpërblente serbët dhe Kishën Ortodokse Serbe.¹⁷³ Ligji mbi gjykatën kushtetuese është po ashtu i vonuar, të paktën pjesërisht, sepse deri në fund të periudhës mbikëqyrëse PCN-ja do të emërojë tre gjyqtarë ndërkombëtarë nga nëntë sosh, dhe do të ketë mundësi të anulojë vendimin e gjykatës. Më 29 korrik Arsim Bajrami, ministri i shërbimeve publike, emëroi një grup punues të qeverisë, “të përbërë nga ekspertë ligjorë, duke përfshirë përfaqësues të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera dhe misionëve diplomatike në Prishtinë”, i cili do të përgatisë draftin e ligjit për gjyqin kushtetues.¹⁷⁴

2. Qeverisja

Kryeministri Thaçi dhe rrethi i tij i vogël i brendshëm janë të vendosur që të ushtrojnë kontroll nga lartë poshtë, ndryshe nga qeveritë e përparshme të koalicionit, në të cilat figura e kryeministrit udhëhiqte me impotencë mbi ministrat që vendosnin vetë agjendat e tyre.¹⁷⁵ Në përgjithësi, administrata ka rrezatuar një

dallim ky që nuk vërehet nga shumica e shqiptarëve të Kosovës), ku përfshihen tri ditë për shqiptarë, të riemëruara respektivisht si dita e shqiptarëve, dita e paqes, dhe dita për përkujtimin dhe respektimin e veteranëve. Ditët e tjera përkujtimore janë një për turqit (23 prill), për romët (8 prill), ashkalinjtë (15 prill), boshnjakët (28 shtator), goranët (6 maj), dhe dy ditë të cilat do të vendosen në bashkëpunim me presidentin e Kosovës. Po të ishin përfshirë serbët në debat, ata me siguri do të kishin nominuar Ditën e Shën Vitutit (Vidovdanin, 28 qershor), e cila që nga viti 1988 ka qenë e asociuar me heqjen e autonomisë së Kosovës nga Slllobodan Millosheviqi dhe me shtypjen e shqiptarëve, që është një zgjidhje kundër së cilës shqiptarët e Kosovës me siguri do ta kishin përdorur veton. Shih Agron Halitaj, “Kosova shtet multifestiv”, *Koha Ditore*, 24 maj 2008; dhe Artan Bajrami, “Për hajr Vidovdani”, *Express*, 27 maj 2008. Egjiptasit e Kosovës, një nga tri grupet etnike “roma”, mbetën pa ditë përkujtimore. Shih “Ligji për pushimet zyrtare në Republikën e Kosovës”, në www.gazetazyrtare.com.

¹⁷³ Sidomos nëse ka të bëjë me pronën që është humbur pas Luftës së Dytë Botërore.

¹⁷⁴ “Kosovo to Create Constitutional Court” [“Kosova të krijojë Gjykatë Kushtetuese”], *Balkan Insight*, Prishtinë, 29 korrik 2008.

¹⁷⁵ Tre nga katër kryeministrat e përparshëm ishin në këtë pozitë: Bajram Rexhepi, Bajram Kosumi dhe Agim Çeku. Vetëm Ramush Haradinaj, gjatë mandatit të tij të shkurtër nga dhjetori 2004 deri në mars 2005, u duk se kontrollonte dhe koordinonte drejtimin e qeverisë. Në qershor 2008 Kryeministri Thaçi e largoi nga posti zëvendësministrin e Tregtisë Naser Osmanin, anëtar i partisë së koalicionit të tij,

sens më të madh të objektivave sesa paraardhësja e saj, dhe vazhdon të jetë e popullarizuar,¹⁷⁶ por centralizimi i vendim-marrjeve brenda një rrethi shumë të ngushtë që sillet rreth kryeministrit është duke shkaktuar vonesa dhe komunikime të dobëta ndër-qeveritare. Qeveria ka trumbetuar se transparenca është virtyt, mirëpo vendim-marrja e saj mbetet e errët.¹⁷⁷ Thaçi dhe shefi i tij i stafit mbështetet me të madhe në udhëzimet nga ambasada e Sh.B.A.-ve. Zyra e Kryeministrit ka tendencë që t'i vështrojë shërbyesit civilë si të korruptuar dhe si simpatizantë të kundërshtarëve politikë.¹⁷⁸ Ai pak progres që është arritur në këto tri vitet e fundit drejt konsolidimit të shërbimit civil është duke u zhbërë.¹⁷⁹ Partiakët e PDK-së janë duke zëvendësuar teknokratët dhe të emëruarit politikë të qeverisë së kaluar, në krye të institucioneve dhe kompanive publike.

Kryeministrit iu desh ca kohë derisa emëroi ministrat dhe zyrtarët kyç. Ministri i mbrojtjes u emërua tek më 3 gusht, tri poste të zëvendësministrave janë të paplotësuara, dhe ende nuk është emëruar shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, sepse qeveria ka hasur në vështirësi në identifikimin e një personi që është i besueshëm nga Thaçi dhe i pranueshëm nga Pesëshja dhe NATO-ja. Emërimet në bordet e ndërmarrjeve publike janë zvarritur, ndërsa nuk ka shkuar puna mbarë as me trashëgimtarin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, që ishte e UNMIK-ut. Thaçi dhe Sejdiu i zvarritën dhjetë emërimet e para ambasadoriale për më shumë se dy muaj, duke arritur pajtim në përzgjedhje më 28 gusht.¹⁸⁰

Qeveria nuk i është drejtuar shoqërisë civile për ndihmë në formulimin e politikave, apo figurave me përvojë të pavarura apo të opozitës, që ata të llobojnë për

LDK, pas një grindjeje publike të Osmanit me Ministrin për Transport dhe Telekomunikacion Limaj, nga PDK-ja e Thaçit. Me këtë u vendos një ton i ri; kryeministrit e përparshëm kurrë nuk kanë pasur fuqinë që të largojnë nga postet ministrat, sidomos jo ata të partisë së tyre. Pas sfidimit fillestar të vendimit, LDK-ja u pajtua me të.

¹⁷⁶ Në një anketë të majit 2008 popullariteti i kryeministrit dhe i presidentit ishte mbi 70 për qind, dhe i qeverisë ishte 47 për qind. Shih UNDP Early Earning Report.

¹⁷⁷ Disa ministra nuk ndihen rehat me faktin se Thaçi i ka bërë mbledhjet e qeverisë të hapura për mediat, pasi që kjo pengon diskutimin e lirë si, ndërsa shanset për të shkëmbyer mendime të lira me kryeministrin janë të pakta. Intervistë e Grupit të Krizave, anëtar i lartë i qeverisë, Prishtinë, 14 maj 2008.

¹⁷⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë, Prishtinë, 20 maj 2008, dhe zyrtar i një vendi të Pesëshes, Prishtinë, 20 qershor 2008.

¹⁷⁹ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, qershor 2008.

¹⁸⁰ Që të dhjetët janë meshkuj.

më shumë njohje ndërkombëtare.¹⁸¹ Qeveria pret që Pesëshja, e sidomos Sh.B.A.-të, ta kryejnë këtë detyrë. Figurat e opozitës OJQ-ja "Forumi 2015" kanë lobuar në mënyrë të pavarur nga qeveria. Në gusht Forumi solli aktivistë qytetarë dhe intelektualë nga vendet arabe në një konferencë në Prishtinë, të cilën nismë Thaçi nuk e përqafoi plotësisht.¹⁸² Ministria e jashtme, formalisht e themeluar pas 15 qershorit, nën Skënder Hysenin e LDK-së (partneri i vogël në koalicion) u krijua para dy muajve me vetëm dhjetë anëtarë stafi. Ajo ka bërë pak lobim dhe ishte e ngadalshme madje edhe në zhvillimin e uebfaqes.¹⁸³ Thaçi po ashtu gjykoi se Ekipi i Unitetit, pro-pavarësisë dhe gjithëpartiak, nuk ishte më i domosdoshëm dhe kështu ka pushuar së mbledhuri.¹⁸⁴

Ekonomia elementare e Kosovës është duke u rritur afro 6 përqind në vit,¹⁸⁵ ndërsa ministrinë e popullarizuara të

¹⁸¹ Një grup u formua në korrik 2008 me përkrahje nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, i financuar nga financeri dhe anëtar i Bordit të Grupit të Krizave Xhorxh Soros, për të lobuar pavarësisht nga qeveria.

¹⁸² Ai refuzoi që të paraqitet në konferencë, por mori pjesë në darkën e organizuar për nder të mysafirëve atë mbrëmje, gjatë së cilës i mbajti ligjëratat një këshilltari të kryeministrit të Libanit për planet e Kosovës për të përforcuar raportet me Izraelin. Intervistë e Grupit të Krizave, dëshmitar, 2 shtator 2008. Ditën në vijim Thaçi deklaroi se rruga e Kosovës për më shumë njohje shtrihej "nëpër Uashington dhe Bruksel, e jo nëpër adresa të dyshimta", lajmet televizive të mbremjes së RTK-së, 26 gusht 2008.

¹⁸³ Një temë kjo me kritika në artikullin e Henry Perritt, "It's Time to Get to Work on Kosovo's Image" ["Është koha që të fillohet të punohet në imazhin e Kosovës"], *Neë Kosova Report*, 1 korrik 2008: "Gjëja e parë që bën një raportues i huaj është që të gjejë burime në internet. Kur ai gjen faqe të zbrazëta në uebfaqen e Qeverisë së Kosovës, ai me siguri se nuk do të shkruajë pozitivisht për progresin e Kosovës". Një gazetë e Kosovës po ashtu nënvizoi praninë e varfër të ministrisë së uebfaqe, në Gazmend Syla, "Ministria "Coming Soon", *Koha Ditore*, 4 shtator 2008.

¹⁸⁴ Një organ i krijuar në tetor 2005 i përbërë nga presidenti i atëhershëm, kryeministri, presidenti i kuvendit dhe dy liderë parlamentar opozitar, të cilët definuan qëndrimet e Kosovës në bisedimet për statusin e ardhshëm të vitit 2006 dhe fillimit të vitit 2007, të menaxhuara nga Ahtisaari.

¹⁸⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i FMN-së, Prishtinë, 29 maj 2008. Shih po ashtu "Aide-Memoire, IMF Staff Visit to Kosovo, April 21-29 2008" ["Aide-Memoire, stafi i FMN-së vizitohet Kosovën, 21-29 prill 2008"], në www.unmik.org/docs/2008/reports/IMF-Aide_Memoire_Final-April-2008.pdf; dhe "Kosovo-Assessment Letter to the European Commission" ["Letra vlerësuese për Kosovën drejtuar Komisionit Evropian"], 11 korrik 2008, në www.seerecon.org/kdc/. FMN-ja shënoi shenja pozitive dhe mori përsipër procesin e aplikacionit për anëtarësim të Kosovës të datuar 10 korrik 2008, duke thënë "Në kontekstin e këtij aplikacioni, është vendosur se Kosova është ndarë nga Serbia si shtet i ri dhe i

qeverisë, të udhëhequra nga PDK-ja, ajo e arsimit dhe ajo e transportit, janë hedhur energjikisht drejt ndërtimit të shkollave dhe rrugëve.¹⁸⁶ Shqyrtimi i buxhetit të qeverisë në verën e vitit 2008 u dha atyre 16 milionë euro dhe 28 milionë euro shtesë respektivisht. Ministrinë për energji dhe shëndetësi nuk kanë pasur sukses aq të mirë. Çkyqjet e rrymës janë keqësuar edhe më shumë me prishjen e gjeneratorëve të “Kosovës B”, të ndërtuar në 1980-ta. Qeveria e ka mbajtur distancën e vet nga sektori dhe ka vonuar blerjen e pajisjeve që janë esenciale për hapjen e nje kanali të ri në minierën e thëngjillit, para se rezervat të harxhohen kah viti 2010, me dijeninë se aranzhimet e qeverisë së përparshme, përfshirë ato për elektranën e re të rrymës, janë në favor të rivalit të PDK-së, AAK-së së ish-Kryeministrit Ramush Haradinaj.¹⁸⁷ Shëndetësia ka mbetur e paorganizuar, me buxhetin e errët dhe të madh farmaceutik të ministrisë, të shikuar si shpërblim në mes grupeve garuese në qeveri.

Në ca nga pushtat kyçe fiskale dhe ekonomike, qeveria në fillim la ashtu si ishin institucionet e krijuara nga UNMIK-u, siç është fondin për privatizim dhe pensionim të AKM-së. Ka ndërprerë harxhimet e panevojshme,¹⁸⁸ ndërsa agjencia kosovare anti-korrupsion ka vlerësuar se gjatë pjesës së parë të vitit 2008 vetëm 6 milionë euro ishin keqpërdorur, në krahasim me 30 milionë euro në pjesën e parë të vitit 2007 nën qever-

pavarur”. “Statement on Membership of the Republic of Kosovo in the IMF” [“Deklaratë për anëtarësim të Republikës së Kosovës në FMN”], raport për shtyp nr. 08/179, 15 korrik 2008, në www.imf.org/external/np/sec/pr/2008/pr08179.htm. Suksesi i aplikacionit varet nga shumica e thjeshtë dhe 55 për qind vota. Duke pasur parasysh se anëtarët e BE-së, SHBA-të dhe vendet e tjera të industrializuara e kanë shumicën e të drejtave për votim, dhe se shumica e këtyre vendeve e kanë njohur Kosovën, anëtarësimi pritet në vitin 2009. Anëtarësimi në FMN është parakusht për anëtarësim në Bankën Botërore.¹⁸⁶ Ministri i arsimit më i bindshëm në Kosovë që nga viti 1999, Enver Hoxhaj, ka vendosur një standard të lartë për provimin e fundit në shkolla, dhe u ka refuzuar akreditimin universiteteve private derisa, apo përveçse nëse, arrijnë standarde të posaçme (anipse ka ravigjzuar këto standarde me ngadalësi dhe nuk ka aplikuar të njëjtin tretman për Universitetin problematik të Prishtinës), ka vendosur kompjuterë nëpër shkolla, ka rritur numrin falas të librave shkollor dhe ka rritur pagat e mësuesve.

¹⁸⁷ Më 8 shtator 2008 në një memorandum të publikuar në *Koha Ditore*, ZCN-ja shfaqte shqetësime për “mungesën e nismave të politikave në sektorin e energjisë... dhe në planet për KEK-un”. Memorandumi i parë nga Grupi i Krizave, Prishtinë, shtator 2008.

¹⁸⁸ Për vetura, derivate, ushqim dhe telefonata. Shih Sami Kastri, “Qeveria Thaçi thotë se ka shpenzuar gati €2 milionë më pak se ajo Çeku”, *Koha Ditore*, 29 korrik 2008.

inë e mëparshme.¹⁸⁹ Por ajo emëroi partiakë të pakualifikuar të PDK-së për të udhëhequr PTK-në¹⁹⁰ si dhe administratën e taksave,¹⁹¹ shty shqyrtimin e buxhetit të mesvitit me 32 milionë euro të shpenzimeve shtesë dhe me një rialokim konfuz të 62 milionë eurove, me konsultim minimal me parterët ndërkombëtarë tri javë pas konferencën së donatorëve në Bruksel, dhe ashtu si qeveritë e përparshme, nuk është duke zvogëluar ndikimin e kontrabanduesve të mëdhenj.¹⁹² Mediat që përkrahën qeverinë filluan të kritikojnë menaxhmentin e emëruar nga UNMIK-u për fondin prej 300 milionë euro të pensioneve,¹⁹³ përderisa qeveria shpalli planet për shpenzimin e 250 milionë euro të PTK-së, për ç’gjë ZCN-ja shprehu shqetësime.¹⁹⁴ Kontrolli partiak i PTK-së i kompanive publike dhe procedurave të prokurimit nuk është lajm i mirë, ndërsa privatisht ZCN-ja dhe Komisioni Evropian janë duke shfaqur shqetësime për këtë gjë.¹⁹⁵

¹⁸⁹ Shih raportin e Lavdim Hamidit për shefin e agjencisë, Hasan Pretenin, në konferencën për shtyp në gjysmën e parë të vitit, “Për gjashtë muaj, korrupsioni dëmton 6 milionë buxhetin e Kosovës”, *Zëri*, 18 korrik 2008.

¹⁹⁰ Shih Arbana Xharra, “ICO-ja kërkon sqarime rreth emërimit të drejtorit të PTK-së”, *Koha Ditore*, 31 korrik 2008. Presioni i komunitetit ndërkombëtar u duk se pati frytë, kur drejtori i sapoemëruar i PTK-së Adnan Merovci dha dorëheqje më 5 shtator 2008. Ish-truprojë e Presidentit Rugova, i cili më vonë iu bashkangjit PDK-së, vitet e fundit Merovci ka qenë i detyruar të japë dorëheqje së paku nga një post menaxherial në PTK, dhe pastaj nga udhëheqësia e komisionit për zgjedhje të Kosovës, pas pohimeve për abuzim. Ai u përkrah fuqishëm për pozitën e shefit të PTK-së nga ministri për transport dhe telekomunikacion, Fatmir Limaj.

¹⁹¹ Sipas Propozimit Gjithëpërfshirës të Ahtisaarit, ZCN-ja ka fuqinë që të mbikëqyrë këtë emërim, mirëpo qeveria e mori këtë vendim gjatë periudhës tranzitore 120 ditëshe, para marrjes së përgjegjësisë nga ZCN-ja. UNMIK-u e pranoi të emëruar, liderin e degës komunale të PDK-së në Podujevë Naim Fetahu, në një bazë të përkohshme tri-mujore. Në shtator ZCN-ja kërkoi nga qeveria që të rishpallë konkursin. Shih Lavdim Hamidi “Pieter Feith kërkon që drejtori i ATK-së të zgjidhet me konkurs”, *Zëri*, 17 shtator 2008.

¹⁹² Intervista të Grupit të Krizave, shërbimi i doganave, Prishtinë, prill-maj 2008.

¹⁹³ Viktor Buzhala, “Vazhdon trusja”, *Express*, 30 gusht 2008.

¹⁹⁴ Shih Arbana Xharra, “Paratë e PTK-së do të shfrytëzohen në rrugë, shëndetësi e arsim”, *Koha Ditore*, 16 shtator 2008. Shqetësimet e tij janë të detajuara në Memorandumin e 8 shtatorit të ZCN-së.

¹⁹⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, gusht-shtator 2008; memorandum i ZCN-së, ku thuhet “mungesa e një udhëzimi të qartë dhe koherent”; dhe komunikata nga mbledhja e pestë e GUN-it, 12 shtator 2008, në www.ico-kos.org/, ku citohet “menaxhimi i ndërmarrjeve publike... si [një fushë] që meriton vëmendje që posaçme nga qeveria”.

Qeveria e pranon se sektorët e sigurisë dhe sundimit të ligjit ende u takojnë OKB-së dhe BE-së, dhe thotë se do të respektojë çfarëdo formule me të cilën pajtohen ata.¹⁹⁶ Ajo ende nuk ka marrur kontrollin formal mbi ShPK-në, ndërsa Policia e UNMIK-ut mbetet në vend, edhe pse kjo është në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin për policinë, dhe nuk është e kënaqur me hezitimin e kësaj të fundit për konfrontimin e strukturave paralele serbe. Ajo ka folur për thirrje në kushtetutë, në mënyrë që së shpejti të emrojë shefin e vet të policisë.¹⁹⁷ Më 8 korrik u formua këshilli koordinues i përbashkët për ligj dhe rend, i përbërë nga qeveria, EULEX-i dhe UNMIK-u, nën kryesinë e Zëvendëskryeminitrit Hajredin Kuçit.¹⁹⁸ Thaçi i dha këtij këshilli një shtysë duke ardhur në ditën e mbledhjes së pestë të GUN-it, dhe duke lajmëruar krijimin e një trupi koordinues të përbashkët qeveri-EULEX.¹⁹⁹

Më 3 korrik ShPK-ja mori përsipër nga Policia e UNMIK-ut komandën e njësitit e departamentit për operacione policore, atë për kontroll rajonal të turmave ("Ndihmë Operacionale"), si dhe njësitin për mbrojtje, deminim dhe komando të ShPK-së.²⁰⁰ Policia e UNMIK-ut ruan një lloj pranë në ShPK,²⁰¹ ndërsa shërbimi kombëtar mbetet formalisht akoma nën lidërshpin çdo herë e më të ngathtë të Policisë së UNMIK-ut,²⁰² por megjithatë tani ekzistojnë kontakte të rregullta ShPK-EULEX. Ankesat e mëparshme të ShPK-së se UNMIK-u po ruan informata të rëndësishme për atë se çka po ndodh në veri, janë duke u pakësuar në favor të qasjes pragmatike se ndërkombëtarët janë të nevojshëm atje si ndërmjetësues.²⁰³ ShPK-ja ka deklaruar se ajo do të ekzekutojë udhëzimet e qeverisë,²⁰⁴ por për momentin

qeveria ka pefeuar që të rrisë ndikimin joformal mbi ShPK-në, dhe të vazhdojë të respektojë autoritetin e Policisë së UNMIK-ut. Edhe pse i mungon pushteti formal, ministria e brendshme krijoi një forcë vepruese për të hulumtuar atë që përfaqësuesit e qeverisë e quajtën tentim atentati në kryeministrin.²⁰⁵ Ngjashëm me këtë, më 28 korrik qeveria suspendoi drejtorin e shërbimeve të doganave, Naim Huruglicën; ai u kthye në pozitën e tij në mes të shtatorit, pas lobimit ndërkombëtar.

Qeveria ka marrë përsipër disa përgjegjësi më të gjera në vend, për shembull kontrollin e regjistrimit civil, ka prezantuar vulat e veta kufitare dhe ka filluar t'u lëshojë licenca operatorëve të fluturimit, ndërsa më 30 korrik ka nisur të japë edhe pasaporta.

3. Ruajtja e stabilitetit

Thaçi nuk ka ruajtur unitetin e klasës politike të shqiptarëve të Kosovës, ashtu si kishte qenë nga fundi i vitit 2005 deri më 2008.²⁰⁶ Skena politike çdo herë e më shumë po dominohet nga rivaliteti i tij me një komandant tjetër të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish-Kryeministrin Ramush Haradinaj.²⁰⁷ As njëri as tjetri kamp nuk janë duke ofruar politika të bindshme, të orientuara nga zhvillimi. Haradinaj po mundohet që të bashkojë të tri partitë parlamentare

¹⁹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, Prishtinë, 28 maj 2008.

¹⁹⁷ Shih Jeton Musliu, "Në radhë policia", *Express*, 1 shtator 2008.

¹⁹⁸ "Qeveria, EULEX-i dhe UNMIK-u formuan Këshillin për sundimin e ligjit", *Koha Ditore*, 9 korrik 2008.

¹⁹⁹ Shih Visar Fetaj "Qeveria dhe EULEX bashkëpunojnë për forcimin e sundimit të ligjit", *Zeri*, 13 shtator 2008.

²⁰⁰ Zija Miftari, "Njësitë elite për ndërhyrje të parë kalon në përgjigjesi të Policisë së Kosovës", *Koha Ditore*, 4 korrik 2008; dhe intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i SHPK-së, 12 shtator 2008.

²⁰¹ Komandantin rajonal i Mitrovicës, si dhe disa prioritetet në policinë e kufirit dhe departamentin e krimit.

²⁰² Një aradhe e komisionerëve të Policisë së UNMIK-ut e lëshuan detyrën gjatë gjysmës së parë të vitit 2008. Një oficer ka udhëhequr me Policinë e UNMIK-ut që disa javë.

²⁰³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i SHPK-së, Prishtinë, 12 shtator 2008.

²⁰⁴ Zëdhënësi i SHPK-së Veton Elshani, konferenca javore për shtyp e UNMIK-ut, Prishtinë, 9 korrik 2008.

²⁰⁵ Një hajn njëzetvjeçar u plagos në dorë nga rojtari i Thaçi dhe më vonë iu dorëzua policisë nga babai i vet. Gjyqi urdhëroi disa muaj paraburgim para seancës gjyqësore me akuzë të tentim vrasjes, edhe pse burimet e policisë tregojnë se nuk ka dëshmi se ai kishte qenë i armatosur, ndërsa asnjë nga anëtarët e familjes apo rojtarët e Thaçi nuk kanë pranuar të japin dëshmi. Ai u lëshua me kusht që të paraqitet në seancë më 13 gusht. Komandantët e ShPK-së u ndien të lehtësuar kur një polici ndërkombëtar të UNMIK-ut iu dha detyra që t'i bashkangjitet task forcës. Intervista të Grupit të Krizave, qershor dhe shtator 2008.

²⁰⁶ Dy vite e gjysmë që nga vizita e parë e Marti Ahtisaarit në Kosovë si i dërguar special i OKB-së për statusin e saj të ardhshëm, e deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, e bashkuan spektrin politik të shqiptarëve të Kosovës në një përpjekje të përbashkët, gjë që ndikoi në tejkalimin e përçarjeve të cilat më parë kishin degjeneruar deri në vrasje më 1998 dhe më 2003. Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave Nr. 163, *Kosova pas Haradinajt*, 26 maj 2005, për më shumë.

²⁰⁷ Rivaliteti i tyre tani pasqyrohet në rivalitetin e ashpër dhe nganjëherë të dhunshëm në mes të partive shqiptare në Maqedoni. PDK-ja e Thaçi dhe AAK-ja e Haradinajt janë rreshtuar me nga njërin prej partive maqedonase në konflikt. BDI-ja e Ali Ahmetit ka gjetur gjuhë të përbashkët me PDK-në, ndërsa PDSH-ja e Menduh Thaçi me AAK-në.

opozitare të shqiptarëve të Kosovës,²⁰⁸ kurse Taçi orvatet ta marginalizojë AAK-në e Haradinajt dhe të afrohet me dy të tjerat.²⁰⁹ Receta e tij për paqe sociale duket të jetë dominimi afatgjatë politik dhe institucional nga PDK-ja dhe struktura e saj aleate e inteligjencës, SHIK-u.²¹⁰ Që kur qeveria e udhëhequr nga PDK-ja filloi mandatin, shfaqjet rreth Kosovës të paramilitarëve etnikë shqiptarë me maska janë ndalur.

Tensionet u ekspozuan edhe më në një incident më 6 qershor në shtëpinë e Taçit, kur një anëtar i trupës së tij e plagosi një hajn në dorë, ndërsa kryeministri u duk se në mënyrë implicite akuzonte AAK-në për tentim atentati mbi të.²¹¹ Taçi falendëroi “opozitën demokratike të LDD-së dhe AKR-së, por la anash partinë e Haradinajt, duke i thënë BBC-së “Kosova e di se kush janë sulmuesit e natës”.²¹² Që prej se është kthyer nga Tribunali i Hagës, ku ai u shpall i pafajshëm për krime të luftës në prill 2008, Haradinaj ka kritikuar rreptë qeverinë për lobimin e dobët për njohje, për mungesën e strategjisë për të integruar serbët e veriut në veçanti, për tolerimin e pranisë së UNMIK-ut pas 15 qershorit, dhe për korrupsionin.²¹³ Ai

²⁰⁸ Ai i ftoi dy liderët e tjerë për darkë më 31 gusht; erdhi vetëm një prej tyre. Shih Besnik Ramadanaj, “Bisedime pa konkluzione”, *Express*, 1 shtator 2008.

²⁰⁹ Shih Faik Hoti “Tenderi 15-milionësh i Behgjet Pacollit vë në dyshim krijimin e bllokut opozitar”, *Zeri*, 15 shtator 2008.

²¹⁰ E themeluar më 1998 me ndihmën e shërbimit të inteligjencës SHIK nga Shqipëria, K-SHIK-u ka shërbyer si krahu i inteligjencës së UÇK-së. Pas qershorit 1999 ajo u vendos në Prishtinë, duke u bërë krahu i qeverisë së përkohshme të Taçit. Ai vazhdoi të operojë edhe pas shpërbërjes së administratës së përkohshme të Taçit në janar 2000. Në një adresim të incizuar dhe të transmetuar në lajmet e mbrëmjes së RTK-së më 14 qershor 2008, shefi i saj Kadri Veseli deklaroi se misioni i K-SHIK-ut ishte arritur dhe se ai do të shpërbëhej për t’ia lëshuar vendin Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. K-SHIK-u insiston se është strukturë legale, ashtu si thonë edhe zyrtarët e PDK-së. Të tjerët nuk shohin bazë të tillë, duke thënë se nuk është llogaridhënëse. Shih Zija Miftari, “SHIK legal vetëm për PDK-në”, *Koha Ditore*, 17 qershor 2008.

²¹¹ Përleshjet e tyre rrezikojnë të hapin një “spirale të paranojës... ku frika ndaj dhunës politike do të krijojë më shumë frikë, dhe kështu edhe më shumë dhunë potenciale; ku mungesa e besimit në institucionet e ligjit dhe rendit do të krijojë mosbesim që çon në paralizë të këtyre institucioneve”. Veton Surroi, “Tri fatet e Fazli Sejdiut”, *Koha Ditore*, 12 qershor 2008.

²¹² Në një raport për shtyp të 8 qershorit 2008 që iu kushtua incidentit, qeveria deklaroi për përkushtimin e saj për “të vazhduar betejën kundër të keqes, për të mirën e vendit dhe të të gjithë qytetarëve”.

²¹³ Dy partitë më të mëdha parlamentare opozitare të krijuara më 2007, LDD dhe AKR, nuk kanë pasur kritika të tilla. Shumëkush konsiderojnë se Haradinaj nuk është i përshtatshëm për të bërë akuza kundër korrupsionit. Qeveria 2004-2007 të cilën ai e kishte udhëhequr në fillim dhe pastaj e kishte

po ashtu pohon se nëpërmjet K-SHIK-ut, zyrtarët e të cilit kanë marrur disa poste qeveritare, po formohet një “shtet i KGB-së”,²¹⁴ dhe kërkon mbajtjen e zgjedhjeve shumë më përpara përfundimit të termit tre-vjeçar të qeverisë, duke thënë se plani i Ahtisaarit stipulon se ato duhet të mbahen brenda nëntë muajsh pas pavarësisë.²¹⁵

Haradinaj dhe zyrtarët e AAK-së nuk ishin të pranishëm gjatë ceremonisë inauguruese të kushtetutës më 15 qershor; shefi i K-SHIK-ut Kadri Veseli mund të shihej aty. Të nervozuar me kritikën e Haradinajt, zyrtarët kanë sugjeruar se më mirë është që ai të jetë i kujdesshëm, se përdryshe mund të paditet vetë për korrupsion.²¹⁶ Taçi mirëpriti sugjerimet mbi emërimet diplomatike nga “pjesa demokratike e opozitës”,²¹⁷ dhe u bëri thirrje liderëve të LDD-së dhe AKR-së që t’i bashkangjiten qeverisë për në konferencën e donatorëve, duke e injoruar kështu AAK-në.²¹⁸ Taçi u tregua i ftohtë ndaj OJQ-së “Forumit 2015” dhe nismës së saj për lobim, pasi Haradinaj publikoi një letër që ia kishte dërguar qeverisë në prill, duke propozuar që qeveria do të duhej të kyçte disa nga njerëzit e Forumit në përpjekjet për njohje.²¹⁹ Që atëherë, mediat e afërta me qeverinë janë treguar armiqësore ndaj kësaj nisme.²²⁰

Ostracizmi i rreptë i Taçit ndaj AAK-së rrezikon që të ndikojë në kthimin e dhunës në politikën e shqiptarëve të Kosovës, duke i ngulfatur institucionet, duke i ngurtësuar edhe më praninë ndërkombëtare si garantues të paqes sociale, dhe kështu duke i larguar edhe më serbët e Kosovës dhe si rrjedhojë duke penguar

dominuar nga mbrapa skenës, kishte qenë e dobët në këtë aspekt. Ministria për tregti dhe industri e AAK-së dhe fondi i krijuar për të mbledhur para për mbrojtjen ligjore të Haradinajt në Hagë, kanë qenë posaçërisht kontraverze.

²¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Ramush Haradinaj dhe zyrtarë të AAK-së, Prishtinë, maj 2008.

²¹⁵ PCN-ja ka për prioritet që të vendosë se kur do të mbahen zgjedhjet, nëse për këtë nuk mund të vendosin vetë politikanët e Kosovës. Ka gjasa që ato të thirren në fund të vitit 2009. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë ndërkombëtar, Prishtinë, 2 shtator 2008.

²¹⁶ Një kërcënim tjetër është që ndërtesa e selisë që i është dhënë AAK-së nga K-SHIK-u në vitin 2000 mund të sekuestrohet. Intervistë e Grupit të Krizave, K-SHIK, Prishtinë, maj 2008.

²¹⁷ Intervistë, Artan Mustafa, “Nuk ngutemi me emrat”, *Express*, 7 korrik 2008.

²¹⁸ Sami Kastrati dhe Zekirja Shabani “AAK-ja, e vetmja që nuk merr ftesë për konferencën e Donatorëve”, *Koha Ditore*, 10 korrik 2008.

²¹⁹ Në një konferencë shtypi të 28 korrikut. Shih Jeton Llapashtica, “Ramush Haradinaj: Kështu nuk qeveriset vendi”, *Koha Ditore*, 29 korrik 2008.

²²⁰ Sidomos gazeta *Express*, në disa artikuj gjatë gushtit 2008.

aftësinë e Kosovës për të punuar drejt arritjes së pavarësisë së plotë.

4. Raporti me serbët

Prishtina mendon se nëse bashkëpunon, praninë civile ndërkombëtare gradualisht do t'i ndihmojnë asaj që të sigurojë sovranitetin në tërë territorin e Kosovës. Ajo thekson se serbët e Kosovës duhet të respektojnë "realitetin e ri", por mbivlerëson forcat që mund t'i ndihmojnë në këtë drejtim. Qeveria ka kërkuar vazhdimisht nga UNMIK-u dhe KFOR-i që në emër të saj të restaurojnë kontrollin në doganat e veriut, në hekurudhë dhe në gjykatën e Mitrovicës, ndërsa në fjalime ka insistuar që autoriteti i saj duhet të shtrihet nëpër tërë vendin. Ajo u inkurajua nga operacioni i UNMIK-ut dhe KFOR-it i 17 marsit në lidhje me gjykatën, dhe priste përforsime pas 15 qershorit, sidomos në restaurimin e doganave në Portat 1 dhe 31 apo në mbylljen e tyre për trafikun komercial.²²¹

Mirëpo, që nga 15 qershori Prishtina i ka ulur shpresat dhe besimi i saj në UNMIK është më i vogël. Pas raportit të OKB-së mbi dhunën e 17 marsit në Mitrovicë, në të cilin dukej se arsyetoheshin sulmuesit serbë, dhe pasi që u pa se Zannieri ishte i gatshëm të pajtohej me një nënstrukturë etnike serbe brenda ShPK-së, si dhe të fliste me liderët e komunave paralele serbe të cilat ishin cilësuar ilegale nga OKB-ja më parë, mediat e Prishtinës e kritikuan shefin e UNMIK-ut.²²² Më 10 korrik, kryetari i komunës së Mitrovicës Rexhepi i dha UNMIK-ut një afat kohor pesë-ditësh për t'iu përgjigjur serbëve vendas që i rezistonin vendosjes së gypit të ujit në fshatin e Suhadollit nga autoriteti i tij komunal.²²³ UNMIK-u dhe KFOR-i refuzuan që të konfrontoheshin me ta. Në vend të kësaj, UNMIK-u ofroi që të bëhet sponzori i gypit, pastaj intervenoi edhe KFOR-i, mirëpo problemi ende mbetet për t'u zgjidhur. UNMIK-u po ashtu nuk ka bërë asgjë për parandalimin e autoritetit paralel serb në Shtërpce në shtrirjen e pushtetit të tij në komunë.

Liderët e Prishtinës u thonë ndërkombëtarëve se ata do t'ia bashkangjesin Kosovës pjesët serbe me "atrak-

sion" dhe jo me forcë.²²⁴ Mirëpo deri më tani qeveria ka investuar energji apo kapital politik të paktë në këtë përpjekje, dhe bën deklarata provokative si: "Ata të cilët e kundërshtojnë ligjin dhe rendin, do të ballafaqohen me forcën e shtetit"²²⁵. Pas 15 qershorit oficerët shqiptarë të ShPK-së filluan t'i dënojnë serbët me tabelat serbe të veturave,²²⁶ por me ndjeshmëri kryen punën policore në ditën e Shën Vitusit serb më 28 qershor (përvjetori i Betejës së Kosovës 1389, e asociuar që nga viti 1989 me fjalimin e Millosheviqit ku theksohet pushteti serb në Kosovë).²²⁷

Qeveria nuk ka përjashtuar nga puna dhe nuk ka ndaluar pagat e qindra serbëve të enklavave, të cilët pas 17 shkurtit dhanë dorëheqje nga institucionet e UNMIK-ut dhe Kosovës,²²⁸ mirëpo nuk ka arritur të vendosë një raport me ta,²²⁹ ndërsa ka lejuar që të ushqehet mosbesimi i serbëve edhe më tej.²³⁰ Për disa javë, shumë serbë të Kosovës ishin të dëshpëruar me paaftësinë e Beogradit për të realizuar premtimet për paga alternative, por Prishtina e humbi shansin që t'u ofrojë atyre një formulë të llojit të statusit neutral, në

²²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, Prishtinë, 28 maj 2008.

²²⁵ Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, i cituar në Shpend Limoni, "Edhe përtej Ibrit?", *Express*, 2 qershor 2008.

²²⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Graçanicë, Mitrovicë e veriut, prill 2008.

²²⁷ Vëzhgim i Grupit të Krizave, Graçanicë, 28 qershor 2008.

²²⁸ Thaçi publikisht kritikoi Zëvendës Komisionerin e ShPK-së, Gjeneralin Sheremet Ahmeti, për vendimin e tij në fund të majit që të ndërpresë pagat e oficerëve serbë të ShPK-së nëse ata nuk kthehen në punë, si dhe urdhëroi që të vijojë suspendimi me pagesë. Shih Dafina Myrtja, "Flakaresha për Gjeneralin", *Express*, 31 maj 2008.

²²⁹ Shanse të tjera kanë shkuar huq. Qeveria dështoi që të transmetojë një përgjigje të prerë në emër të serbëve të enklavave drejtuar kryeministrit rus Jevgeni Primakov, si reagim ndaj sugjerimit të tij se: "Zgjidhja më e mirë tani do të ishte sikur serbët të shpërngulen nga pjesët jugore në ato veriore, të cilat janë më afër Serbisë, dhe pastaj t'i bashkangjiten Serbisë". "Yevgeny Primakov, former prime minister of Russia, supports partition of Kosovo" ["Jevgeni Primakov, ish-kryeministër i Rusisë, mbështet ndarjen e Kosovës"], Associated Press në *International Herald Tribune*, 26 mars 2008.

²³⁰ Në disa enklava serbët pohojnë se Prishtina është duke krijuar ndryshime në demografinë lokale nën pretendimin e shumetnicitetit, që çon deri te marginalizimi i serbëve madje edhe nëpër komuna të desinuara nga Ahtisaari si "shumicë serbe". Blerjet e tokave nga shqiptarët ndërmjet fshatrave Preoce dhe Lepinë kanë krijuar thashethëma në mesin e serbëve se një qytezë shqiptare e përbërë nga 3,000 shqiptarë do ta ndajë territorin e komunës së Graçanisës, së propozuar nga Ahtisaari. Serbët e Graçanicës po ashtu e shohin zëvendësimin e serbëve të suspenduar të ShPK-së me shqiptarë nga zemra e Drenicës së UÇK-së si qëllimisht provokative. Intervista të Grupit të Krizave, Graçanicë, Novobërdë, prill-maj 2008.

²²¹ Shih Bukurie Bajraliu, "Prishtina preferon mbylljen e pikave doganore", *Koha Ditore*, 1 qershor 2008; po ashtu intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë dhe deputet i PDK-së, Prishtinë, maj-qershor 2008.

²²² Shih Gazmend Sylja, "Zannieri zemëron kosovarët", *Koha Ditore*, 2 gusht 2008 dhe Mufail Limani "Zannieri jashtë Kosovës!", *Express*, 6 gusht 2008.

²²³ Fatmir Aliu dhe Izedin Krasniqi "Rexhepi i jep ultimatum UNMIK-ut", *Koha Ditore*, 10 korrik 2008.

mënyrë që ata të mbanin punët e tyre. Ajo ende ka nevojë që të rrisë partnerët e vet përtej Partisë së Pavarur Liberale (SLS), e cila është shumë e vogël.²³¹

Prishtina nuk i njeh autoritetet komunale paralele serbe, të formuara pas 11 majit, dhe insiston që do të kontrollojë implementimin e decentralizimit. Në mes të qershorit, më nismë të ZCN-së, ajo i vazhdoi për tre muaj mandatet e katër ish-kryetarëve serbë komunash, të zgjedhur më 2002, mirëpo kjo nuk ka pasur kurrfarë ndikimi në terren, ku autoritetet e UNMIK-ut efektivisht janë zëvendësuar nga komunat paralele serbe.²³² Qeveria refuzoi propozimin e ZCN-së që UNMIK-u të legalizojë komunën e re paralele serbe në veri të Mitrovicës,²³³ ndërsa qasja e saj e përgjithshme është e hendikepuar nga një kujdes i theksuar ndaj të gjithë serbëve që janë të përfshirë në komunat paralele.²³⁴

Decentralizimi, i parë gjerësisht si i përpunuar për interesat e serbëve të Kosovës, do të jetë vështirë të implementohet. Gjatë gjashtë muajve të parë të pavarësisë, kjo nuk ishte prioritet i qeverisë – Thaçi ia dha këtë detyrë një ministri nga partneri i vogël në koalicion, LDK-së – mirëpo duhet të theksohet se serbët mbase nuk do të kishin bashkëpunuar edhe po të kishte një qasje më aktive nga Prishtina. Qeveria ka krijuar një grup punues ndër-ministoror për decentralizim, të bashkë-kryesuar nga ZCN-ja, dhe për disa muaj radhazi ka pohuar se planifikon të fillojë një fushatë gjashtë-muajshe që t’ia shpjegojë politikën publikut – duke nënvizuar se si decentralizimi nuk do të jetë i mirë vetëm për serbët e Kosovës, por se ai po ashtu do të sjellë më shumë resurse dhe pushtet vendim-marrës nëpër të gjitha komunat. Pjesëmarrja e ministrave në këtë grup punues ka qenë e dobët, por më 11 shtator ai u bashkëkryesua nga Thaçi, i cili publikisht deklaroi përkrahjen e tij për ringjalljen e këtij procesi.²³⁵

²³¹ Dy ministrat e saj “i ngrinë” postet e tyre pas pavarësisë, por patën vetëbesim që të kthehen më 21 mars 2008.

²³² Vetëm ish-kryetari i komunës së Shtërpces, Stanko Jakovleviq, ka shfaqur interes në mandatin e Prishtinës, por ai nuk gëzon popullaritet në komunitet dhe nuk ka ndikim.

²³³ Duke argumentuar se aty nuk përfshihej bordi i përbashkët për qytet, si stipulohet në planin e Ahtisaarit. ZCN-ja e konsideroi se ishte më e rëndësishme që të fillohej, dhe se bordi do të mund të shtohet më vonë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 31 korrik 2008.

²³⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 16 shtator 2008.

²³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë, Prishtinë, 16 shtator 2008; po ashtu komunikata e mbledhjes së pestë të GUN-it, 12 shtator 2008, në www.ico-kos.org/.

Implementimi duket se do të jetë po ashtu një sfidë në shumicën e komunave me shumicë shqiptare, kur kapaciteti administrativ mund të mos jetë i mjaftueshëm. Në fund të fundit, edhe ministritë në Prishtinë mund të mos dorëzojnë lehtë buxhetet e tyre të centralizuara. Sa më ambicioze që të jetë politika, aq më e vështirë është që ajo të zbatohet. Në pamundësinë e implementimit të decentralizimit në veri të Ibrit, qeveria dhe ZCN-ja planifikojnë që të paktën të fillojnë nëpër enklava, duke emëruar ekipe përgatitore komunale me bashkëpunëtorë serbë të vullnetit të mirë. Prishtina shpreson se ata që janë të përfshirë në komunat paralele, gradualisht do t’i bashkangjiten procesit.²³⁶

Të paktën në publik, qeveria insiston se kushtetuta do të aplikohet në mënyrë uniforme nëpër tërë Kosovën. Në gusht Thaçi refuzoi çfarëdo mundësie për të negociuar aranzhime speciale me Beogradin për polici, gjykata apo dogana nëpër pjesët serbe të Kosovës, si dhe i hodhi poshtë si jovalide bisedimet e Zannierit me qeverinë serbe në këto tema.²³⁷ Duke dashur që të anashkalojë Prishtinën, Beogradi filloi të thërrasë për involvim në bisedime pikërisht pasi Thaçi e bëri të qartë këtë qëndrim të tij rigjid.²³⁸ Mirëpo qasja ekstreme e Thaçit ka filluar të zbutet. Falendëruar atij, më 3 shtator qeveria lajmëroi se zgjerimi i autoritetit të saj në veri të Ibrit nuk do të ndodhë shpejt, si dhe përjashtoi përdorimin e forcës për ta arritur këtë qëllim.²³⁹ Thaçi ka filluar t’u kushtojë më shumë vëmendje argumenteve të diplomatëve që cilët thonë se kompromiset e përkohshme në veri, siç janë përdo-

²³⁶ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të ZCN-së dhe qeverisë, Prishtinë, shtator 2008. Kjo qasje rrezikon krijimin e ndarjeve të reja në mesin e serbëve të Kosovës, dhe në vend se të tërheqë shumicën, ta tëhuajësojë atë. Një qasje alternative, për të rritur shanset e pranimit dhe pjesëmarrjes në mesin e serbëve të Kosovës, do të ishte sikur Prishtina dhe ZCN-ja të theksonin anën teknike, jo-statusore të decentralizimit, si dhe të gjejnë mënyra për të mbushur hëndekun në mes qasjes së vet konform planit të Ahtisaarit, dhe qasjes së tanishme të serbëve “çkadoqoftë përpos Ahtisaarit” mbi decentralizimin. Kjo mund të dërgojë deri te krijimi i një agjencie të pavarur për decentralizim, e cila do të mund të implementonte politikën e qeverisë, e prapëseprapë të adoptojë rolin e një ndërmjetësuesi me status neutral, në mënyrë që serbët të fillojnë të bashkëpunojnë pa u parë se janë duke u marrur drejtpërdrejtë me Prishtinën.

²³⁷ Shih intervistën në Sami Kastrati, “Thaçi: jo negociata”, *Koha Ditore*, 6 gusht 2008.

²³⁸ Shih intervistën e sekretarit të shtetit në ministrinë e Serbisë për Kosovën, Oliver Ivanoviq, në Besnik Ramadanaj, “Serbët ftojnë shqiptarët”, *Express*, 2 shtator 2008.

²³⁹ Deklaratë nga Zëvendëskryemini Hajredin Kuçi, lajmet televizive, 3 shtator 2008.

imi i ligjit të UNMIK-ut në gjykata, mund të jetë alternativë esenciale kundër ndarjes.

5. Enklavat e serbëve të Kosovës

Përderisa serbët e veriut kanë përdorur forcën apo kanë kërcënuar me forcë për të dëbuar apo për të riformësuar institucionet e Kosovës dhe për të bllokuar EULEX-in, serbët në enklavat në jug të lumit janë treguar më të kujdesshëm. Shumica e komunave të vetë-shpallura në bazë të zgjedhjeve të 11 majit presin për të holla nga Beogradi, mirëpo pa njohjen e tyre nga Prishtina apo nga komuniteti ndërkombëtar, pushteti i tyre është i kufizuar.²⁴⁰ Në Graçanicë dhe në enklavat lindore janë duke patrolluar policët shqiptarë, pas refuzimit të 300 serbëve që të vazhdojnë të punojnë në ShPK nën Prishtinë.²⁴¹ Në komunën jugore dhe malore të Shtërpces, ShPK-ja serbe ka vazhduar të respektojë zinxhirin komandues të ShPK-së dhe të punojë përkrah kolegëve shqiptarë, madje edhe pas vendosjes së autoritetit paralel komunal serb pas zgjedhjeve të 11 majit.

Shumica nëpër enklava gjithashtu kanë hequr dorë nga punët e tyre në UNMIK dhe qeveri të Kosovës, duke besuar në premtimin e ministrit për Kosovë të Serbisë, Samarxhiq, se do të paguheshin nga Beogradi. 90 serbët që u larguan nga puna në burgun e Lipjanit, e kuptuan që ministria për Kosovë e Serbisë nuk kishte para për t'i paguar ata, dhe që ministria e drejtësisë në Beograd, e kontrolluar nga DS-ja, nuk kishte plane për t'i punësuar. Me javë të tëra ata bënë protesta para zyres së ministrisë për Kosovë në Graçanicë. Stafi i Radio Graçanicës panë këtu një shans për të kërkuar paga nga shteti serb, dhe filluan grevën e urisë. Nën presion dhe me frikë se do të cilësoheshin tradhtarë, ministritë dhe kompanitë publike në Serbi i pranuan eventualisht serbët e Kosovës, edhe pse nuk kishin nevojë për ta. Deri në fund të majit 2008 ministria e drejtësisë mori në punë 59 zyrtarë të burgut të Lipjanit dhe 15 nga burgu i Gjilanit.²⁴² Vetëm një pakicë e serbëve të ShPK-së, punëtorë komunalë dhe juridikë që kishin lënë punët e tyre pas 17 shkurtit, janë kthyer në pozitë të tyre.

²⁴⁰ Shtërpce është e vetmja që i ka njohur kufijtë komunalë që kanë shumicë serbe; në vendet e tjera komunat janë shpallur të tilla brenda njëjësive ekzistuese me shumicë shqiptare.

²⁴¹ Një pjesë e vogël e tyre janë kthyer në vendet e punës. Serbët vendorë ankohen se pozitat e lira po zëvendësohen me shqiptarë të ShPK-së nga Drenica, Kosova qendrore, në vend të pjesëve më të zhvilluara apo më të përziara, dhe se ata janë agresivë. Është thënë se në maj ShPK-ja ka rrahur një tinejxher serb. E megjithatë, oficerët shqiptarë e bënë përcjelljen e turmës serbe pa asnjë incident gjatë ditës së Shën Vitusit në Graçanicë më 28 qershor 2008.

²⁴² "Kosovo Corrections Officers Fired" ["Oficerët e Shërbimit Korrektues të Kosovës u larguan nga puna"], B92, 30 maj 2008.

Enklavat nuk janë të sigurta se si t'i përgjigjen BE-së. Shumë prej tyre e shohin zbarkimin e EULEX-it si të pashmangshëm pas raportit të Ban-it për "rikonfigurim", por ende shpresojnë se UNMIK-u do të ndalojë këtë në Prishtinë.²⁴³ Gjatë 120 ditëve të para, dy politikanë serbë të Kosovës, të njohur por jo dhe aq të popullarizuar, të afërt me DS-në, Oliver Ivanoviq dhe Rada Trajkoviq, pohuan se kushtetuta e Kosovës është realitet për enklavat, ndërsa Beogradi nuk duhet të ndalojë bashkëpunimin e tyre me EULEX-in dhe dispozitat për decentralizim të planit të Ahtisaarit, anipse shumica e banorëve e barazojnë planin e përgjithshëm të Ahtisaarit me përvetësim të institucioneve dhe lokaliteteve të tyre nga shqiptarët.²⁴⁴ Në korrik Ivanoviqi iu bashkua qeversë së re të Serbisë si sekretar i shtetit në ministrinë për Kosovën, dhe tani thotë se nuk do të ketë bashkëpunim me EULEX-in apo planin e Ahtisaarit.²⁴⁵ Trajkoviqi, në anën tjetër, u takua me shefin e EULEX-it de Kermabon më 22 gusht, për të dhënë përkrahjen e saj për këtë mision.²⁴⁶

Deri në formimin e qeverisë së re të Serbisë në korrik, mbretëronte një konfuzion se kush e përfaqësonte Beogradin në enklava. Qendra e saj për koordinim për Kosovën (QKK) ishte përvetësuar nga ministria e re për Kosovë në prill 2007, dhe dominohej nga kadro të DSS-së, edhe pse një pjesë e stafit të DS-së u shquan në detyrë pas emërimeve të tyre në dhjetor 2007. Koordinatorët e rinj e ambicioz bënë emër në rajonin e Graçanicës dhe në pjesën lindore të Vitisë,²⁴⁷ edhe pse Saramxhiq nuk i kishte njohur ata gjatë kohës kur ishte ministër.²⁴⁸ Në korrik ministri i ri për Kosovë, Goran Bogdanoviq, largoi nga puna të gjithë koordinatorët e nivelit komunal të QKK-së, duke i urdhëruar ata që t'ia

²⁴³ Intervista të Grupit të Krizave, Rada Trajkoviq, Graçanicë, prill, maj, korrik 2008, dhe "Strah Srba sa Kosova zbog ustava" ["Frika e serbëve të Kosovës nga kushtetuta"], B92, 16 korrik 2008.

²⁴⁴ Intervista të Grupit të Krizave, Rada Trajkoviq, Graçanicë, prill, maj, korrik 2008; Oliver Ivanoviq i intervistuar nga televizioni B92, shih "Metafizika Koegzistenza" ["Metafizika e bashkëjetesës"].

²⁴⁵ Shih intervistën nga Bukurie Bajraliu, "Ivanoviq: Qeveria e Kosovës nuk do të ketë autoritet në veri", *Koha Ditore*, 24 gusht 2008.

²⁴⁶ "Kosovo Serb rep meets Kermabon" ["Përfaqësuesi serb i Kosovës takon Kermabon-in"], B92, 23 gusht 2008.

²⁴⁷ Respektivisht Goran Arsiq dhe Zoran Krcmareviciq.

²⁴⁸ Konfliktet të ngjashme kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve të 11 majit, kur zyrtarët e zgjedhur kërkuan që koordinatorët e QKK-së të bënin hapësirë për ta. Në një incident të çuditshëm, njerëzit e SRS-së u përleshën me koordinatorin e QKK-së në Graçanicë, i cili vjen nga aleati i DS-së, NS-ja, me ç'rast ata u orvatën t'ia merrnin zyren më 19 qershor. B. Mitrinovic, "Tuca funksionera SRS-a i Nove Srbije", ["Përleshja në mes zyrtarit të SRS-së dhe atij të Serbisë së Re (NS-së)"], *Politika*, 20 qershor 2008

dorëzonin detyrën autoriteteve të reja të zgjedhura.²⁴⁹ Në mes të shtatorit ai e zhvendosi zyren kryesore në terren të tij të ministrisë nga Mitrovica e veriut në Graçanicë, për të sinjalizuar shqetësimet e qeverisë së re për enklavat.

B. TAKTIKAT E QEVERISË SË RE TË SERBISË

Qeveria e re e koalicionit DS-SPS “pro-Evropës” e Presidentit Tadiq, e betuar më 7 korrik 2008, mund t’i kushtojë më pak energji Kosovës dhe të jetë më pak konfrontuese sesa paraardhësja e saj, mirëpo opozita DSS dhe SRS do të mundohet që ta drejtojë atë në një qëndrim ekstrem. Në deklaratat e para të saj, qeveria e përmendi mundësinë e akomodimit të EULEX-it dhe normalizimin e ardhshëm të raporteve me vendet që e kanë njohur Kosovën, duke theksuar njëkohësisht se do të vijon politikën e qeverisë së përparshme mbi Kosovën dhe duke i bërë thirrje opozitës nacionaliste që të përkrahin ruajtjen e “një politike të vetme shtetërore”. Kryeministri Cvetković ritheksoi se Serbia kurrë nuk do të njohë Kosovën, ndërsa qeveria prezantoi një rezolutë parlamentare “për vazhdimësinë absolute dhe të padyshimtë të politikës shtetërore kundrejt Kosovës”.²⁵⁰ Qeveria e tërhoqi mocionin më 8 shtator, pasi që opozita kishte për qëllim të votonte kundër saj, por në shtator rifilloi bisedat me DSS-në dhe Radikalët tashti të përçarë, në përpjekje të harmonizimit të tekstit.²⁵¹

Sidoqoftë, Tadiqi mund të ketë sinjalizuar një zhvendosje në rikonfigurimin EULEX dhe UNMIK, kur e njohu faktin se shumica e Këshillit të Sigurimit e përkrahën planin për rikonfigurim të Ban-it

dhe se prania ndërkombëtare nuk mund të ruajë formën e saj të përparshme edhe më tej. E megjithatë, liderët e DS-së në Serbi insistojnë se zbakimi i EULEX-it akoma varet nga pajtimi i Beogradit dhe Këshillit të Sigurimit, dhe nuk do të ketë kurrfarë lidhje me planin e Ahtisaarit,²⁵² ndërsa Kryeministri Cvetković kohëve të fundit e kushtëzoi zbakimin në Serbi me hyrjen në partneritet në vendimarrje në EULEX.²⁵³

Qeveria e re ka hedhur poshtë presionet nga ca shtete anëtare të BE-së që të heqë dorë nga kërkesa e saj drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që t’ia referojë shpalljen e pavarësisë së Kosovës GjND-së për mendimin e saj këshillëdhënës. Kjo politikë është shenjë e theksimit të DS-së në rezistimin e pavarësisë së Kosovës nëpërmjet diplomacisë. Duke e ndjekur energjikisht këtë politikë, si ka vepruar ministri i jashtëm Jeremiq në javët e fundit, DS-ja i jep vetes më shumë hapësirë politike në vend, në mënyrë që të drejtojë një politikë më të butë në Kosovë sesa DSS-ja.

Tadiqi dhe ministri i ri për Kosovën, serbi nga Kosova Goran Bogdanović, kanë thënë se problemet ditore dhe mirëqenia e serbëve të Kosovës do të jenë aq të rëndësishme sa edhe intergriteti i shtetit. “Deri më tani, parimi i shtetit nganjëherë është vendosur më lartë”.²⁵⁴ Tash e tutje ministria do të jetë “më shumë në terren sesa në Beograd”,²⁵⁵ motoja e saj “të jetohej në Kosovë, jo nga Kosova”.²⁵⁶ Megjithatë, DS-ja ka më pak mjete me të cilat të operojë politikën e saj të Kosovës dhe të kontrollojë serbët e Kosovës, sesa ishte rasti me DSS-në, ajo do të kishte vështirësi në implementimin e një agjende radikalisht të ndryshme për Kosovën, dhe për momentin ka akomoduar nacionalistët në terren.

Portofolio për Kosovë nuk është i lehtë për DS-në, të cilës i mungon një rrjet i fortë lokal. Rrjeti i viteve të ’90-ta i partnerit të saj në koalicion SPS-së, është zhdukur gati krejt, edhe pse disa serbë të Kosovës janë duke pastruar pluhurin nga librezat e tyre të partisë, me shpresë të pozitave për punë pas emërimit të anëtarit të SPS-së Zvonimir Steviq si shef i ri i QKK-

²⁴⁹ Shih “Ministar Bogdanovic na Kosovu” [“Ministri Bogdanović në Kosovë”], B92, 18 korrik 2008.

²⁵⁰ “Jeremic wants unity over Kosovo” [“Jeremiqi dëshiron unitet rreth Kosovës”], B92, 15 korrik 2008. DSS-ja e konsideroi këtë si “mashtim”, dhe insistoi se misioni i BE-së është mjet për pavarësinë e Kosovës i cili duhet të refuzohet, si dhe refuzoi që të mbështesë rezolutën, pasi që ajo nuk e dënonte EULEX-in. Konferencë për shtyp me Samarxhiqin, 14 korrik 2008.

²⁵¹ “Minister for Kosovo urges unity over resolution” [“Ministri për Kosovë kërkon unitet rreth rezolutës”], B92, 15 shtator 2008. DSS-ja kërkoi që rezoluta të ketë tri parime: 1) refuzim dhe zhvlerësim i rezolutës së Kosovës; 2) refuzim i EULEX-it; dhe 3) të ngritet padi kundër të gjitha vendeve që njohin pavarësinë e Kosovës. Grupi parlamentar i SRS-së nuk kanë shfaqur qëndrim, anipse grupi i ish-zëvendës liderit të saj Tomislav Nikoliq ka bërë thirrje për amendamente në mënyrë që të përfshihen konsiderata për personat e zhdukur apo të kidnapuar, si dhe një hetim mbi pohimin e ish-prokurores së Gjykatës së Hagës Karla del Ponte mbi tregtinë me organe.

²⁵² Tadiqi në intervistë në *Vecernje Novosti*, Dushica Radeka, “Samo pomirenjem branimo naciju” [“Vetëm me pajtim mund të mbrojmë kombin”], 6 korrik 2008; Jeremiq në “New govt. to cooperate on UNMIK reconfiguration” [“Qeveria e re të bashkëpunojë me rikonfigurimin e UNMIK-ut”].

²⁵³ Intervistë, *Politika*, 28 gusht 2008.

²⁵⁴ Tadiqi në intervistë me *Vecernje Novosti*, 6 korrik 2008.

²⁵⁵ Fjalët e ministri Bogdanović drejtuar agjencisë së lajmeve FoNet, 8 korrik 2008.

²⁵⁶ Fjalët e Bogdanovićit të raportuara nga Tanjugu, 8 korrik 2008.

së për qeverinë.²⁵⁷ DSS-ja akoma kontrollon pjesën më të madhe me serbë të Kosovës me anë të asambleve komunale të formuara pas 11 majit.²⁵⁸ Edhe pse SPS-ja fitoi në shumicën e vendeve, asaj i mungon një staf kompetent që të qeverisë në nivelin lokal, ndërsa DSS-ja dhe KNS-ja shpresojnë se ajo do të ketë nevojë për mbështetje në përvojën e tyre. Në disa vende SRS-ja ka preferuar që t'u bashkangjitet nis-mave qytetare lokale ose të qëndrojë "heshturazi" me DS-në, si në komunën veriore të Leposaviqit. Edhe pse asambletë komunale janë të dominuara nga kundërshtarë të qeverisë, zgjedhjet e 11 majit u dhu-ruan atyre pavarësi fiskale. Ministri Bogdanoviq ka për plan që të emërojë koordinatorë të nivelit rajonal apo "kantonal", të cilët duket se do të jenë përkrahës të qeverisë dhe të cilët do të mbikëqyrin strukturat e reja.

Derisa Samarxhiqi kishte ndaluar të gjitha kontaktet me misionet e BE-së dhe me Prishtinën, të moderuarit nga enklavat dëshirojnë që Beogradi t'u japë atyre më shumë liri që të marrin të mirat e buxheteve të BE-së dhe të Kosovës, por duke iu përmbajtur raportit të njëjtë me qeverinë serbe.²⁵⁹ Shumë serbë të Kosovës supozojnë se në fund DS-ja do të bëjë një marrëveshje që do të dërgojë drejt integritet në institucionet e Kosovës, gjë për të cilën ata kanë frikë.²⁶⁰ Por në enk-lava ekziston po ashtu një lehtësi se i ka ardhur fundi arrogancës së Samarxhiqit, kështu që tani më shumë

njerëz se më herët janë të gatshëm që të dëgjojnë se çka ka për të thënë Prishtina dhe misionet e BE-së.²⁶¹ Sekretari i shtetit i ministrisë për Kosovën Oliver Ivanoviq nënvizoi një qasje nga poshtë lartë, duke ia ofruar përkrahjen e qeverisë secilës asamble komunale serbe të Kosovës që dëshiron të bashkëpunojë me UNMIK-un në decentralizim, përderisa nuk përdoret plani i Ahtisaarit.²⁶² Pasi që Ivanoviq e di se UNMIK-u nuk është në pozitë që të bëjë një ofertë të tillë, qasja e tij është mjaft strategjike, gjë që e bën më të mundshëm bashkëpunimin me Prishtinën dhe ZCN-në në krijimin e komunave të reja me shumicë serbe.

Ekstremistët që janë kundërshtarë të qeverisë së re të Serbisë ende dominojnë në veriun e Kosovës, ndërsa KNS-ja do të orvatet që të parandalojë qeverinë në ushtrimin e detyrës së saj, përveçse nëse është sipas kushteve të saj. E megjithatë, tani lideri i KNS-së Jakshiq është më i dobët.²⁶³ Në maj ai deklaroi se serbët do të braktisin Kosovën nëse DS-ja vjen në fuqi.²⁶⁴ Gjatë fushatës zgjedhore ai shkëmbeu fjalë të mprehta me politikanët e DS-së dhe shfrytëzoi mbledhjet javore për t'i sulmuar ata. Politikanët nga radhët e DS-së filluan të flasin për mundësinë e fillimit të hulumtimeve financiare për të parë se si e kishte qeverisur ai veriun,²⁶⁵ dhe në fillim u distancuan nga Asambleja e tij Serbe e Kosovës.²⁶⁶ Por pas ardhjes në fuqi, DS-ja iu shmang konfrontimeve të menjëher-shme me KNS-në dhe bëri një tërheqje taktike: më 10 korrik ministri i ri i DS-së për Kosovë, Bogdanoviq, e

²⁵⁷ Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, ish zyrtar i DS-së, Kamenicë, 17 shtator 2008. Ai shfaqti shqetësimin se anëtarët e SPS-së do të mermin përsipër shumicën e pozitave. U raportua që SPD-ja kishte refuzuar propozimin për ndarje 50 përqind për DS-në, 25 përqind për SPS-në, 25 përqind për G17+.

²⁵⁸ Ministri Samarxhiqi i fuqizoi asambletë e zgjedhura në maj 2008, në dëm të koordinatorëve të QKK-së, në mënyrë që të ruante establishmentin e DSS-së në Kosovë kundër përforcimeve të mëtejshme nga qeveria e udhëhequr nga DS-ja. Ai lajmëroi se asambletë do të formonin borde ekzekutive dhe si "organet më të larta nëpër komuna", do të merrnin përsipër funksionet e QKK-së. *VIP Daily News Report*, 20 maj 2008 (nga raporti i Tanjugut më 19 maj).

²⁵⁹ Intervista të Grupit të Krizave, politikanë vendor, Graçanicë dhe Novobërdë, prill-maj 2008.

²⁶⁰ Derisa serbët më mendjehapur të Kosovës i konsideruan taktikat e DSS-së si kundër-produktive dhe rrugaçe, ata besojnë se DS-së i mungon infrastruktura e nevojshme në terren, dhe se kjo do të rezultojë në dobësi dhe pavendosmëri. Kështu që shumë prej tyre presin që politikat e DS-së do të çojnë drejt pranimit të kërkesave kryesore të Pesëshes dhe të EULEX-it, e madje edhe të integritet në institucionet e Kosovës. Intervista të Grupit të Krizave, biznesmen serb, Leposaviq, 25 qershor 2008; gazetar serb, Laplasellë, 2 korrik 2008. Mirëpo qeveria thotë se nuk do të ndryshojë politikën e Kosovës. "Serb Minister: No Shift on Kosovo" ["Ministri serb: nuk ka ndryshim mbi Kosovën"], FoNet, 6 qershor 2008.

²⁶¹ Një zyrtar nga Ministria e Pushtetit Lokal e qeverisë së Kosovës raportoi se një numër jo i vogël i serbëve vendorë erdhën në mbledhjet e organizuara për planet për decentralizim sipas Ahisaarit, të aranzhuaran për Ministrinë në enklavat lindore në shtator, nga një OJQ me bazë në Graçanicë. Mbledhjet shkuan në rregull, por nuk u mbajtën në enklavën më shumë ekstreme të Ranillugut. "Që nga fundi i korrikut dhe fillimi i gushtit po rritet numri i serbëve që po flasin me ne" dhe po kritikohen komunat paralele që nuk po "prodhojnë rezultate". Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 16 shtator 2008.

²⁶² Intervistë nga Bukurie Bajraliu, "Ivanoviq: Qeveria e Kosovës nuk do të ketë autoritet në veri", *Koha Ditore*, 24 gusht 2008.

²⁶³ Madje as DSS-ja nuk rezervoi një ulëse për Jakshiqin pas zgjedhjeve të majit. Nëpunësit e tij ende besnikë të SNC-së janë duke hulumtuar opsione tjera, për çdo rast; Milan Ivanoviq i është bashkuar Radikalëve, ndërsa Nebojsa Joviq ka biseduar në mënyrë diskrete me ZCN-në.

²⁶⁴ Intervistë, televizioni B92, *Poligraf*, 29 maj 2008.

²⁶⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i DS-së, Mitrovicë, 30 maj 2008, dhe politikan serb nga Kosova, Graçanicë, prill 2008.

²⁶⁶ Presidenti Tadiq i tha agjencisë së lajmeve FoNet se, edhe pse serbët e Kosovës kanë të drejtë në institucionet e veta, ato duhet të themelohen në atë mënyrë që to mos jenë kërcënim për sigurinë e tyre apo të shqiptarëve vendorë, apo të largojë vëmendjes nga politika e Serbisë mbi Kosovën. *Shih VIP Daily News Report*, 30 qershor 2008.

shpalli përkrahjen për Asamblenë Serbe të Kosovës, duke thënë se anëtarët e partisë së tij do të merrnin pjesë në të.²⁶⁷

Në muajt në vijim qeveria do të mundohet që të dëmtojë kundërshtarët e saj ekstrem në Kosovë, dhe të sjellë nën kontroll shpenzimet e saj në territor. Në reagim të pavarësisë së Kosovës, koalicioni i përparshëm serb rriti në mënyrë të konsiderueshme fondin shtetëror për serbët e Kosovës. Ministri i Financave nga DS-ja, Cvetković (tani kryeministër) përmendi një shumë vjetore prej 500 milionë euro,²⁶⁸ pjesërisht në përpjekje të racionalizimit të shpenzimeve, pasi që më parë ekzistonin aq shumë kanale të fondeve sa që ishte e vështirë të bëhej kjo, ndërsa ministria për Kosovë e udhëhequr nga DSS-ja kishte refuzuar që të diskutojë mbi atë se sa po kushtonte mbrojtja nga Serbia e sovranitetit dhe e zyrtarëve lojalë të saj. Samarxhiqi kishte thënë se vëllezërit në pjesët e rrezikshme si Mitrovica e kanë fjalën e parë në atë se çka bën Beogradi për Kosovën dhe se sa para shpenzohen.²⁶⁹

Shefat e përparshëm të QKK-së duket se i kishin prishur raportet me Jakshiqin, DSS-në dhe KNS-në mbi kontrollin e fondeve.²⁷⁰ Në fushatën zgjedhore të vitit 2008, ministrat e DS-së dhe G17+ kishin aluduar se ministria favorizonte të vetët në veriun e Kosovës, duke i lënë serbët e enklavave që “të jetojnë në baltë”.²⁷¹ Cvetković propozoi në prill që të ndërpritet dhënia e dy pagave për serbët e veriut të Kosovës, dhe të përdoren të hollat për t’i kompenzuar serbët e enklavave, të cilët pas 17 shkurtit i kanë braktisur vendet e tyre të punës në qeverinë e Kosovës, por ka qenë i paaftë në implementimin e kësaj ideje.²⁷² Në fund të gushtit, shefi i ri i QKK-së Zvonimir Steviq, gjithashtu propozoi përfundimin e dhënies së pagave të dyfishta.²⁷³

Qasja më e butë dhe më pak agresive ndaj Kosovës e qeverisë së udhëhequr nga DS-ja, në krahasim me atë të paraardhëses së saj DSS-së, i ka ndihmuar opinionin publik serb që të fokusohet më pak në këtë çështje. Në një anketë të realizuar në fund të gushtit, vetëm 12 përqind e konsideronin Kosovën problem numër një të vendit të tyre – papunësia, varfëria, kriminaliteti dhe korrupsioni ishin më të rëndësishme.²⁷⁴ Për më shumë, mediat që kanë raporte të mira me qeverinë janë duke e përgatitur opinionin publik për ndryshimet të cilat janë duke ardhur në mënyrën se si shteti do të veprojë me serbët e Kosovës.²⁷⁵

²⁶⁷ “DS: Ucesce u ‘srpskoj skupstini” [“DS: të marrë pjesë në ‘kuvendin serb”], B92, 11 korrik 2008.

²⁶⁸ “Cvetković thotë se qeveria do të gjejë vende pune”, *Tanjug*, 10 prill 2008.

²⁶⁹ Intervistë e Dragana Matović, “Nije vazno sta misli ‘krug dvojke” [“Nuk është me rëndësi çka mendon ‘rethi i dytë”], *Politika*, 26 prill 2008.

²⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Shtërpce, prill dhe qershor 2008; gazetar serb, Llaplasellë, qershor dhe korrik 2008; dhe biznesmen, Mitrovicë e veriut, dhjetor 2007.

²⁷¹ Dragan Sutanovac and Mladjan Dinkić në “Pres Pretres” [“Dridhja e shtypit”], TV Pink, 17 prill 2008.

²⁷² “Duple plate samo za enclave” [“Pagat e dyfishta vetëm për enklavat”], B92, 2 prill 2008.

²⁷³ Nedeljko Zejak, “Ukinuti duple plate” [“Hiqni pagat e dyfishta”], *Blic*, 31 gusht 2008.

²⁷⁴ Një anketë strategjike për treg, e përmbledhur në “SPS pao ispod cenzusa!” [“SPS-i bjen nën pragun zgjedhor!”], *Press*, 4 shtator 2008.

²⁷⁵ Në fund të korrikut gazeta *Blic* publikoi një ekspozë mbi abuzimet e buxhetit të shtetit serb në Kosovë, mbi pagat e larta të paguara për punëtorë dhe punëdhënës joekzistues, nepotizëm dhe njerëz me vende të shumta pune. Nedeljko Zejak, “I Umrlji na Platnim Spiskovima” [“Edhe njerëzit e vdekur me paga”], *Blic*, 27 korrik 2008. Një artikull tjetër zbuloi të dhëna nga Ministria e Financave e Serbisë se në Kosovë paguhet 8,127 paga të dyfishta, ndërsa shumë prej tyre marrin disa paga të dyfishta. Nedeljko Zejak dhe I. Radissavljević, “Bogacenje na kosovskim mukama” [“Pasurimi nga vuajtjet e Kosovës”] *Blic*, 21 shtator 2008. Programi i televizionit B92 “Insajder” është duke përgatitur dokumentarë hetues në të njëjtën temë. Revista *Vreme* pohoi se Bishopi radikal Artemije i Graçanicës është në krye të një firme të ndërtimit dhe eksport-importit, e cila ka marrur kontrata për rindërtim të kishave serbe në Kosovë dhe e cila i është shmangur taksave. “Pune sake brada” [“Një grusht bukë”], *Vreme*, 28 gusht 2008.

IV. SI TË FUNKSIONOJË RIKONFIGURIMI

Muajt të vijim janë test kyç për kredibilitetin e politikës së jashtme të BE-së dhe për EULEX-in si misioni i saj më i madh deri më tani në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes (PESM). Vendimi për të zëvendësuar EULEX-in dhe PSBE-në u mor në shkurt, por as njëri as tjetri nuk i kanë marrë plotësisht përsipër funksionet e tyre. Tani BE-ja duhet të bashkëudhëheqë rikonfigurimin e të mos mbështetet që vetëm OKB-ja të prijë përpara.

Pas nëntë muajsh në Kosovë, OKB-ja nuk dëshiron të humbasë arritjet që i ka bërë me shumë mund në themelimin e institucioneve funksionale dhe në ndonjë rast edhe multi-etnike. Por në raportin e tij të 15 korrikut 2008 drejtuar Këshillit të Sigurimit, Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon tregoi më pak i përkushtuar se më parë ndaj atyre arritjeve. OKB-ja duhet të ketë kujdes që t'i shmanget rolit të të qenit patron i ndarjes institucionale të serbëve nga shumica shqiptare. Opsioni i të qenit "neutral ndaj statusit" nuk ekziston në qoftë se Prishtina dëshiron që UNMIK-u të shkojë e Beogradi dëshiron që ai të qëndrojë, nëse njëra anë mundohet që të ndërtojë mbi trashëgiminë institucionale të OKB-së, ndërsa tjetra përpiqet që ta shembë atë.

A. PËRPEKJET PËR RIKONFIGURIM

Janë dy aspekte kryesore të rikonfigurimit: turrja e UNMIK-ut dhe dorëzimi tek BE-ja; dhe finalizimi i bisedimeve me Serbinë në gjashtë fusha funksionale. Beogradi ka të drejtë fjale në këtë të fundit, por jo në atë të parën.²⁷⁶

1. Roli i OKB-së

OKB-ja ka vështirësi të mëdha në ndarjen e operacioneve BE-së duke ruajtur përgjegjësinë politike për Kosovën nën Rezolutën 1244. Ban-i ka thënë, "kuptohet që përgjegjësia ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara do të jetë e kufizuar deri në masën e një kontrolli efektiv operacional".²⁷⁷ As OKB-ja e as BE-ja nuk janë duke parashikuar "dyfishimin e kapelave" të personelit të misionit. BE-ja

dëshiron një dorëzim procedural dhe ligjor të lehtë të kompetencave. Ajo deshi një memorandum të mirëkuptimit me OKB-në që të sqarohet zinxhiri komandues i EULEX-it dhe t'i ofroheshin privilegjet dhe imunitetet e OKB-së,²⁷⁸ por nuk dëshironte një memorandum aq formal sa që të kishte nevojë të kërkonte konensus të shteteve anëtare të BE-së për pëlqim nga Brukseli.²⁷⁹

Që nga fillimi i korrikut, një grup punues i UNMIK-ut filloi të planifikojë uljen substanciale të stafit të misionit dhe të detyrave të tyre, ndërsa procesi që do të çojë në reduktimin e 70 për qind të stafit u zyrtarizua më 11 gusht.²⁸⁰ Duke lënë anash kontigjentin e saj policor, të përbërë prej 2,000 vetave, buxheti i tashëm i UNMIK-ut do të mund të akomodonte një staf civil prej 775 ndërkombëtarëve (përfshirë 162 vullnetarë të OKB-së) dhe 2,038 vendasve, por në muajt e fundit ajo ka lejuar që shumë pozita të mbesin pa u plotësuar, kështu që kapaciteti para fillimit të rikonfigurimit është afro 2,500, prej të cilëve 600 janë ndërkombëtarë dhe 1,900 janë staf kombëtar.

Raporti për qershor 2008 i Sekretarit të Përgjithshëm premtoi turrjen e të gjitha kapaciteteve, përveç atyre që duhen për monitorim dhe raportim; po ashtu, kur të kërkohej, lehtësim të kyçjes së Kosovës në marrëveshjet ndërkombëtare; lehtësim të dialogut Prishtinë-Beograd në çështje të shqetësimeve praktike; dhe dialog në implementimin e aranzhimeve praktike në gjashtë fushat. Por Ban-i po ashtu la hapësirë që prania e OKB-së të kryejë funksione "që mbesin të definohen",²⁸¹ dhe udhëzimet e tij për rikonfigurim drejtuar UNMIK-ut më 25 qershor lanë hapësirë për krijimin e departamenteve të reja të UNMIK-ut.²⁸²

PSSP-ja Zannier është duke e ndryshuar rolin e tij në atë të një ndërmjetësuesi dhe implementuesi të kompromiseve praktike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Kjo përshtatet edhe me mandatin e tij për të arritur "aranzhime të përkohshme", e kompromise me Beogradin. Mirëpo, ka rrezik që pozita e UNMIK-

²⁷⁶ Zëvendës-zëdhënësi i UNMIK-ut Russell Geake, i cituar në Bekim Greicevci "Fillimisht policia dhe gjyqësia", *Express*, 24 korrik 2008.

²⁷⁷ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 korrik 2008.

²⁷⁸ Personeli i EULEX-it nga shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën nuk mund të shfrytëzojnë privilegjet dhe imunitetet që ofrohen nga Prishtina. Sidoqoftë, në gusht zyrtarët e BE-së i konsideruar ato si "të mjaftueshme për momentin". Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 26 gusht 2008.

²⁷⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i Këshillit të BE-së, Bruksel, 1 korrik 2008.

²⁸⁰ Zëdhënësi i UNMIK-ut Aleksander Ivanko e bëri këtë lajm në mediat vendore. Planifikohet reduktimi i 600 anëtarëve të stafit.

²⁸¹ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 qershor 2008.

²⁸² Informata që i janë dhënë Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, 23 korrik 2008.

ut të konsolidohet deri në atë masë në mes të shqiptarëve dhe serbëve sa që e lë jashtë ZCN/PSBE-në. Mungesa e një ekzekutivi të qartë – as PSSP, as ZCN, e as qeveria e Kosovës nuk janë duke e luajtur këtë rol – inkurajon sfida nga serbët lokalë ndaj institucioneve të Kosovës, gjë që pastaj krijon një treg për ndërmjetësim të UNMIK-ut, që është rol i cili mund të adaptohet gjithashtu nga misioni i OSBE-së “neutrale ndaj statusit”, së cilës i mungon roli i definuar i pranisë në nivel komunal.²⁸³

Më 23 korrik Beogradi filloi të diskutojë aranzhimet e përkohshme me Zannier-in, duke nënvizuar se “procesi i rikonfigurimit filloi pa pëlqimin e Beogradit dhe ne besojmë se kjo ishte e gabuar. Ky proces nuk bën të përfundojë pa pëlqimin e Beogradit dhe pa konfirmimin eksplicit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së”.²⁸⁴ Ai vazhdon të refuzojë EULEX-in, por OKB-ja, BE-ja dhe Pesëshja duhet të insistojnë që Faith-i të marrë pjesë në bisedime si PCN/PSBE. Duket se Zannier-i ka propozuar që bisedimet të fokusohen në kthimin e doganave në dy portat e veriut. Biseduesit e tij serbë²⁸⁵ insistuan që së pari të adresohen policia dhe gjykatat.²⁸⁶ Agjendës së bisedimeve të 11 shtatorit ata ia shtuan pronën e marrur serbe, personat e kidnapuar e të zhdukur, si dhe transportin e ndihmës humanitare, pa përmendur doganat.²⁸⁷

Involvimi i Zannier-it në këto bisedime nuk i ka ndihmuar atij aspak që të bëhet më i dashur për autoritetet e Prishtinës apo mediat. Në fund të korrikut ai publikisht rekomandoi rihapjen e gjykatës rajonale të Mitrovicës me gjykatës ndërkombëtarë, dhe u duk se po sugjeronte se serbët e ShPK-së të kenë aranzhime speciale autonome të një “policie etnike”, e cila vetëm sa për sy e faqe të jetë brenda zinxhirit komandues të ShPK-së, si dhe të krijohet një distrikt i

veçantë i doganës në veri (të bazuar në modelin jo qartë të definuar të Hong Kongut). Në pjesën e dytë të gushtit ai u duk se bëri një kthesë mbrapa.²⁸⁸ Derisa ai thotë se është lehtësues, ai po ashtu po e rezervon, të paktën formalisht, të drejtën për të imponuar vendime.²⁸⁹

Në raundin e bisedimeve të 30 qershorit për policinë dhe gjykatat, kërkesat e ministrit të ri serb për Kosovën, Bogdanoviq, ndryshuan pak nga ato të paraardhësit të tij. Policia në pjesët me shumicë serbe, insistoi ai, duhet të udhëhiqen nga komuna relevante serbe, të jenë të lidhura me Beogradin, dhe t’i raportojnë jo Prishtinës por një zinxhiri komandues të Policisë së UNMIK-ut. Gjykatat në pjesët me shumicë serbe duhet të funksionojnë me ligj serb, me pjesëmarrjen e ministrisë së drejtësisë në emërimin e gjykatëve, dhe me një rol për gjykatën e UNMIK-ut. Kërkesat e tij nuk ishin deri në atë masë specifike për enklavat ashtu si ishin ato për veriun.²⁹⁰ Zëvendësi i Bogdanoviqit, Oliver Ivanoviq, sinjalizoi më shumë fleksibilitet pas bisedimeve të shefit të tij në gusht me zëvendësshëfin e përkohshëm të UNMIK-ut, Nikolas Jeisom, si dhe potencoi nevojën që UNMIK-u të sjellë Prishtinën në këtë proces. Ai tha që një “policie etnike” e ndarë nuk ishte e dëshirueshme, dhe se ishte nevoja për një zgjidhje për serbët që të vazhdojnë të punojnë në polici dhe dogana pa qenë e domosdoshme që ata të përfaqësojnë Kosovën e pavarur: “Që të kënaqet ujku, pa e prekur delen”.²⁹¹ Në shtator Ivanoviqi shtoi se lëshimi i vendeve të punës së serbëve të enklavave nga ShPK-ja ishte bërë për shkak “të këshillave jo të mira... Është dashur të rrimë brenda”.²⁹²

BE-ja nuk ka qenë e përfshirë në bisedime deri më tani. Prishtina ka dyshime në to, dhe qeveria serbe

²⁸³ Në një fjalim pranë Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, PSSP-ja Zannier propozoi që misioni i OSBE-së në Kosovë të shfrytëzojë praninë e saj të terren që të marrë përsipër rolin e “intervenimit të butë” në fushën e administrimit civil. “UNMIK downsizing gives OSCE opportunity for larger role in Kosovo, UNMIK head says” [“Tkurja e UNMIK-ut ia jep shansin OSBE-së për një rol më të madh në Kosovë, thotë shefi i UNMIK-ut”], raport për shtyp i OSBE-së, Vjenë, 4 shtator 2008.

²⁸⁴ Ministri i jashtëm Vuk Jeremiq, i cituar në *VIP Daily News Report*, 21 korrik 2008.

²⁸⁵ Ministri i jashtëm Jeremiq dhe ministri për Kosovë Bogdanoviq.

²⁸⁶ Në radhitjen sipas letrës së Sekretarit të Përgjithshëm Ban-it. “A mund të arrihet Marrëveshja midis PSSP-së Zannier dhe Qeverisë së Serbisë?”, *Zëri*, 25 qershor 2008.

²⁸⁷ Deklaratë për shtyp e qeverisë serbe, “Minister for Kosovo and Metohija Bogdanovic meets with the Head of UNMIK Zannier” [“Ministri për Kosovë dhe Metohi Bogdanoviq takohet me kryesuesin e UNMIK-ut Zannier”], 12 shtator 2008.

²⁸⁸ Në një konferencë për shtyp, Prishtinë, 20 gusht 2008. Një gazetë djallëzisht ripublikoi intervistën e tij para pushimeve në anglisht dhe në përkthimin shqip për qëllim krahasimi. Shih Fatmir Aliu, “Zannier kundër Zannierit”, *Koha Ditore*, 21 gusht 2008.

²⁸⁹ Fatmir Aliu, “Zannier: Negociata po, madje të zorshme”, *Koha Ditore*, 1 gusht 2008.

²⁹⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 31 korrik 2008.

²⁹¹ Intervistat e Ivanoviqit në *Express*, 2 shtator 2008, dhe në *Koha Ditore*, 24 gusht 2008.

²⁹² Ai sugjeroi se në vend se të lëshojnë vendet e punës, oficerët serbë do të duhej të kishin hequr bexhat e ShPK-së dhe të kishin vendosur ato të UNMIK-ut. “Por kjo thjesht nuk u mendua. Nganjëherë e kam përshtypjen se qeveria e përparshme është munduar që ta përkeqësojë situatën sa më shumë që të ishte e mundur... Tani duhet të bëjmë çkado që të jetë e mundshme që të ndreqim gabimet.” Shih “KPS problems ‘fault of previous gov’t’” [“Problemet në ShPK ‘faji i qeverisë së përparshme’”], B92, 10 shtator 2008.

s'para do t'u përkushtohet bisedimeve më përfshirëse, deri pasi që të ketë krijuar hapësirë të mjaftueshme nga opozita nacionaliste, duke miratuar me përkrahjen e tyre rezolutën mbi politikën e vetme shtetërore për Kosovën, dhe pasi të ketë kaluar mocioni për GjND-në në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. As njëra e as tjetra nuk mund të pritët deri në mes të tetorit.

2. Roli i BE-së

Fillimisht shtetet anëtare të BE-së dhe Sekretariati i Këshillit të BE-së kishin qenë të kënaqura që t'i japin EULEX-it mandatin në bazë të Veprimeve të Përbashkëta të Këshillit, ftesën sovranë nga Kosova, planin e Ahtisaarit dhe autoritetin e ZCN/PSBE-së. Mirëpo, për arsye se legjitimiteti i misioneve të BE-së është kontestuar aq ashpër nga Rusia dhe Serbia, dhe disa shtete anëtare të BE-së kanë refuzuar që ta njohin Kosovën, ata tani duan që OKB-ja të ofrojë një legjitimitet ndërkombëtar për EULEX-in. Por OKB-ja me qëndrim neutral ndaj statusit rrezikon të tërheqë EULEX-in nga roli i saj i qartë i përparshëm për përkrahjen e qeverisë së Kosovës, kushtetutës dhe PCN-së, dhe ta bëjnë pjesërisht të varur në politikën e OKB-së.

BE-ja po ashtu është e lidhur për OKB-je sepse ka nevojë që të trashëgojë logjistikën, mjetet dhe objektet e UNMIK-ut, përveçse nëse është e gatshme të marrë përsipër shpenzimet e shumta, por interesi për këtë nuk ekziston. Të dy organizatat kanë nevojë për një dorëzim detyrues, me një koreografi në përputhje me njëra tjetrën. Deri më tani rikonfigurimi i UNMIK-ut është disajnuar për së brendshmi, ndërsa BE-ja nuk ka marrë pjesë në këtë planifikim.²⁹³ Pasi që BE-ja ende nuk mund të thotë kur dhe si është e gatshme të zbarkohet në veri të Ibrit, UNMIK-u akoma nuk mund të planifikojë që të tërhiqet.²⁹⁴ Në këto rrethana ka hapësirë të mjaftueshme për paraqitjen e dyfishimeve e të boshllëqeve.

Tash EULEX-i thotë se do të bëhet operacionale deri në fund të nëntorit apo në fillim të dhjetorit 2008.²⁹⁵ Deri në përfundimin e raundit të dytë të 120

ditëve dhe të rikonfigurimit, EULEX-i planifikon që të përgatisë stafin, të zhvillojë kontaktet lokale, dhe të fillojë me mentorim dhe dhënien e këshillave.²⁹⁶ Ai nuk do të marrë përsipër tërë madatin e vet të plotë, apo të duket se po operon vetëm në pjesët shqiptare të Kosovës,²⁹⁷ kështu që po pret fundin e rikonfigurimit. Për pasojë, përsëri koha është e shkurtër deri në kompletimin e trajnimit dhe të zbarkimit të 1,000 anëtarëve të stafit që nuk është ende në vend.

Zbarkimi i BE-së në veri – edhe në numër të vogël – është sfida më e madhe. ZCN-ja priste të kishte një zyre në Mitrovicën e veriut, si dhe një prani të vogël monitoruese në terren. EULEX-i konsideron se një grup prej 75 policësh dhe zyrtarësh të doganave është i mjaftueshëm. Ka plane për një grup prej 330 policëve shtesë, nëse EULEX-i ka nevojë që të zëvendësojë serbët e ShPK-së që refuzojnë të shërbejnë në veri.²⁹⁸ Planifikuesit e EULEX-it janë të pasigurtë se a të ndërtohet ky kapacitet tani apo vetëm në rast se serbët e ShPK-së në veri nuk vijnë në punë.²⁹⁹ Një pakicë e shteteve anëtare të BE-së duan që EULEX-i të qëndrojë jashtë veriut. Në fund të vitit 2007 dhe prapë në korrik 2008 Suedia rekomandoi formimin e një divizioni në mes të EULEX-it dhe UNMIK-ut afër Ibrit.³⁰⁰ Në mesin e shteteve anëtare që nuk njohin Kosovën, Spanja insiston se është duke lobuar me Beogradin që të pranojë shtrirjen e EULEX-it në tërë Kosovën, në mënyrë që të zbuten presionet për ndarje,³⁰¹ gjersa Qiproja thotë se EULEX-i duhet të zbarkohet “duke respektuar integritetin dhe sovranitetin territorial të Serbisë dhe në vijë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244”.³⁰²

jmëron vonesa”, *Koha Ditore*, 30 korrik 2008; dhe intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i UNMIK-ut, Prishtinë, 31 korrik 2008.

²⁹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, staf i lartë i EULEX-it, Bruksel, qershor 2008.

²⁹⁷ “Dëshirojmë që EULEX-i të zbarkojë në tërë Kosovën. Çkado që të bëjmë në një pjesë të Kosovës do të ketë ndikim mbi perceptimet në pjesët e tjera”, stafi i EULEX-it, Bruksel, qershor 2008.

²⁹⁸ Buxheti është aprovuar, por jo edhe rekrutimi.

²⁹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, qershor 2008.

³⁰⁰ Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë të jashte suedeze, korrik 2008.

³⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë, Madrid, 30 maj 2008.

³⁰² Vërejtje nga Ministri i Jshëm Marcos Kyprianou në Beograd, “EULEX only with Belgrade’s agreement” [“EULEX-i vetëm me marrëveshjen e Beogradit”], B92, 23 korrik 2008.

²⁹³ Informatat të dhëna Grupit të Krizave mbi propozimin për rikonfigurim nga grupi punues i UNMIK-ut dhe debate i brendshëm mbi këtë temë, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, 23 korrik 2008.

²⁹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Sekretariati i Këshillit të BE-së, Bruksel, 2 korrik 2008.

²⁹⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 26 gusht 2008. Kjo përshtatet me llogaritë e hershme të PSSP-së Zannier. Shih intervistën e tij, Fatmir Aliu, “Zannier paral-

3. Puna me Beogradin

Procesi i integritimit në BE i Serbisë nuk duket se do të ecë përpara pa ndonjë lidhje me rastin e Kosovës. Edhe pse BE-ja nuk ka bërë ndonjë lidhje formale deri më tani,³⁰³ Franca të paktën ka thënë se Serbia nuk mund t'i bashkangjitet bllokut pa njohur së pari Kosovën.³⁰⁴ Në fakt, ky është kushti esencial për normalizimin e raporteve Serbi-Kosovë, që duhet të shfrytëzohet. Në fund, si pjesë të kandidaturës së saj për në BE Serbia duhet të “marrë një qëndrim konstruktiv drejt përpjekjeve të BE-së për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit”,³⁰⁵ si dhe ta përputhë politikën e vet të jashtme më shumë me atë të BE-së (siç pritet normalisht nga një vend kandidat). Po ashtu duhet të përkufizojë dhe kontrollojë kufijtë dhe doganat e veta – gjë që nuk është duke e bërë tani, pasi që nuk është duke i kontrolluar kufijtë e jashtëm të Kosovës,³⁰⁶ ndërsa regjimi i doganave në mes saj dhe Kosovës tani është shkatërruar pjesërisht. Ajo ka argumente të varfëra që të refuzojë dialogun me Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian (PSBE). Një hap pozitiv u ndërmorr në korrik, kur i ktheu ambasadorët e vet nëpër vendet evropiane që kishin njohur Kosovën.

Në bisedime me Serbinë për integrimin e saj, BE-ja, përfshirë këtu dhe Komisionin Evropian, nuk duhet të anashkalojnë çështjen e Kosovës. Deri më tani ka ekzistuar një tendencë anashkalimi i tillë, për të përkrahur forcat pro-evropiane në Beograd kundër radikalëve, dhe për të mos sfiduar liderët e DS-së të cilët thoshin se Serbia mund të ketë të dyjat – edhe BE-në edhe Kosovën. Diplomacia e DS-së kundër

pavarësisë së Kosovës është më e mirë se qasja agresive e DSS-së, por edhe kjo do ta sfidojë BE-në.

Tani që Radikalët dhe DSS-ja janë në opozitë për të paktën disa vite,³⁰⁷ Presidenti Tadiq nuk mund të vazhdojë me pohimin e tij se kompromiset rreth Kosovës mund të rrëzojnë qeverinë e tij stabile. BE-ja nuk duhet të forcojë Serbinë në një skaj prej nga ku ajo mund të bie, por së pari duhet të hulumtojë për fusha në të cilat Beogradi ka interes për bashkëpunim dhe të promovojë zgjidhjet të cilat i ndihmojnë asaj që të shpëtojë fytyrën e vet. Shtetet anëtare të cilat nuk kanë njohur Kosovën por të cilat planifikojnë të jenë aktive në EULEX, dhe të cilat janë tradicionalisht përkrahëse për një PESHM të fuqishëm, si Spanja, mund të luajnë një rol special bilateral në këtë aspekt.³⁰⁸ Kurse 21 shtetet anëtare që cilat e kanë njohur Kosovën duhet t'ia bëjnë më eksplicite Serbisë se progresi i saj drejt anëtarësisë varet nga akomodimi që ajo ia bën Kosovës. Të gjitha këto duhet të insistonë që Serbia të lejojë EULEX-in në veri të Ibrit.

BE-ja duhet t'i bëjë presion Beogradit që të pranojë pjesë nga plani i Ahtisaarit, sidomos dispozitat mbi decentralizimin, si “neutrale ndaj statusit” dhe të bashkëpunojë në implementimin e tyre. Ajo duhet të insistonë që Serbia të krijojë dhe gradualisht të zgjerojë fushën e punës me qeverinë e Kosovës, dhe për arsye praktike të pranojë dokumentet që ajo i lëshon, si pasaportat apo lejet e veturës,³⁰⁹ edhe pa e njohur shtetin formalisht.³¹⁰ Eventualisht, dhe para

³⁰³ Gjatë vizitës së liderëve të Serbisë në Bruksel më 3 shtator, Presidenti i Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso e ngriti çështjen e Kosovës, por vetëm në mënyrë të mjegullt. Shih http://ec.europa.eu/commission_barroso/president/archives/2008/index_en.htm.

³⁰⁴ Presidenti i Francës Sarkozy deklaroi në dhjetor 2007 se njohja e pavarësisë së Kosovës ishte kusht për anëtarësim të Serbisë në BE. Shih “EU offering Serbia early membership, with strings attached” [“Ofertë e hershme për Serbinë në BE, por me kushte”], B92, 15 dhjetor 2007. Mediat në Prishtinë cituan një deklaratë të ngjashme nga ministri gjerman për Evropë Gunter Glosler kur ai vizitoi Kosovën në korrik 2008, mirëpo më vonë ambasada gjermane tha se ai e kishte fjalën për akomodim, jo njohje. Intervistë me telefon e Grupit të Kontaktit, Prishtinë, shtator 2008.

³⁰⁵ Konkluzionet e Këshillit mbi Ballkanin Perëndimor, 22 korrik 2008, Bruksel. Referenca specifike kishte të bënte me Procesin për Stabilizim-Asociim, që është në proces e sipër me Serbinë.

³⁰⁶ Edhe pse në të vërtetë Serbia mban kontroll të plotë të kufirit dhe doganave në kufirin e vet me Kosovën. Rruga e Serbisë drejt liberalizimit të plotë të vizave me BE-në do të komplikohet nëse ajo vijon të pohojë se shqiptarët e Kosovës janë qytetarë të saj dhe nëse vijon t'u lëshojë pasaporta serbe.

³⁰⁷ Partia Radikale u përça në mes të përkrahësve të liderit të saj ultra-ekstremist Sheshel, i cili është në gjyq në Hagë për krime lufte, dhe zëvendës liderit Nikoliq, i cili dha dorëheqje më 6 shtator 2008, pasi Shesheli u tërhoq nga marrëveshja e tij me qeverinë e udhëhequr nga DS-ja mbi formulën e përkrahjes së Radikalëve për ratifikimin e MSA-së. Nga 77 ish-deputetët e SRS-së, tetëmbëdhjetë u bashkuan me Nikoliqin në një grup të ndarë parlamentar, me të cilin ai planifikon të formojë një parti të re, “Napred Srbijo!” [“Përpara Serbi!”] më 21 tetor. Marrëveshja ishte që në mënyrë të njëanshme të shtohet një aneks në MSA ku thuhej se Kosova mbetej pjesë e Serbisë. Parlamenti e ratifikoi MSA-në pa të më 9 shtator 2008.

³⁰⁸ Spanja insiston se është duke e bërë këtë. Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i lartë spanjoll, Madrid, 30 maj 2008.

³⁰⁹ Aktualisht Serbia refuzon të njohë jo vetëm pasaportat e Kosovës dhe pasaportat e tjerë të vultosur nga Republika e Kosovës, por edhe dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut.

³¹⁰ Pas lobimit nga OJQ-ja rajonale Nisma e Rinisë për të Drejtat e Njeriut, ministria e brendshme e Serbisë (MUP) vitet e fundit ka krijuar një procedurë të veçantë sipas së cilës dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut mund të pranohen për hyrje në Serbi, pas procesimit të dokumentit-ftesë. Kjo fillimisht duhet të aplikohet edhe për pasaportat e Kosovës si paralojë e një metode më të zgjeruar dhe të thjeshtësuar, siç është vu-

anëtarësimin në BE, Beogradi dhe Prishtina duhet të konkludojnë një marrëveshje që rregullon raportet ndërmjet tyre dhe që garanton se Serbia nuk do të pengojë anëtarësimin e Kosovës në BE nëse ajo hyn aty e para, e megjithatë kjo i ofron Serbisë hapësirë që të përmbahet nga njohja e Kosovës si shtet, nëse i duket se një gjë e tillë është ende e domosdoshme.³¹¹

Ka merita në argumentin që për t'iu shmangur protestës së brendshme, qeveria e Tadiqit nuk duhet të shtyhet shumë shpejt, por në mënyrë që BE-ja dhe OKB-ja të mos mbesin edhe më mbrapa në rikonfigurimin e pranive të tyre, gjë që do të rrezikonte një dështim të dytë të tranzicionit dhe do të testonte durimin e shqiptarëve të Kosovës, BE-ja së shpejti duhet të fillojë me zbarkim në pjesët serbe të Kosovës. Edhe nëse qeveria e Serbisë e udhëhequr nga DS-ja pajtohet me një formulë të tillë, serbët e veriut të Kosovës mund të mos e pranojnë atë, sepse në nivelin lokal janë të udhëhequr nga KNS-ja, shumica syresh përkrahin partitë opozitare nacionaliste DSS dhe SRS, dhe në shumë raste kanë treguar gatishmëri që të përdorin taktika detyrimi dhe dhunë. Anipse një nga shtetet anëtare më të zëshme konsideron se EULEX-i së shpejti duhet të vendosë faktet në terren në veri të vendit,³¹² shumica nga ta janë të kujdesshëm. Ata sidomos frikësohen nga ndonjë përleshje në mes të EULEX-it dhe serbëve, gjë që do t'i shtynte ata në rolin e okupatorit,³¹³ që rrjedhimisht do të tho-

losja e tyre për hyrje si përjashtim dhe për një kohë të kufizuar, d.m.th. vizë me emër tjetër.

³¹¹ Si kryesues i bisedimeve të "Treshes" ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në fund të vitit 2007, diplomati gjerman Wolfgang Ishinger sugjeroi Traktatin Bazë të vitit 1972 në mes dy shteteve gjermane si një precedent i rëndësishëm për kryeqytetet e Ballkanit, të zbatueshëm për nevojat e tyre. Traktati ishte gurrthemel i Ostpolitik-ës që ia solli Uilli Brandt-it Çmimin e Nobelit për Paqe dhe hapi erën e détente-s, që e bëri Perëndimin (Republikën Federale) dhe Lindjen (Republikën Demokratike Gjermane, RDGj) të normalizonin marrëdhëniet dhe hapi rrugën që të dyjat të bëheshin anëtare të OKB-së më 1973, pa pasur nevojë për Bonin që të njihje se shteti komunist ishte i huaj për të apo se ndarja ishte e përhershme, dhe pa pasur nevojë që RDGj të heqte dorë nga qëndrimi i saj se ishte shtet plotësisht i pavarur. Elementi kyç ishte pranimi nga ana e RDGj-së, pa përgjigje, e "një letre... mbi unitetin gjerman" nga Republika Federale, duke përfshirë deklaratën se "ky Traktat nuk bie ndesh me qëllimin politik të Republikës Federale të Gjermanisë për të punuar për një situatë paqeje në Evropë, në të cilën kombi gjerman do të rifitojë unitetin e tij nëpërmjet vetëvendosjes së lirë". Përkthimi anglisht i tekstit të Traktatit Bazë, 21 dhjetor 1972, në http://germanhistorydocs.ghi-dc.org/sub_document.cfm?document_id=172.

³¹² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar, Bruksel, 9 korrik 2008.

³¹³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë, Bruksel, korrik 2008.

shte se qeveria pro-BE e Beogradit do të ishte në pozicion pa opsione përpos që të përkrahë rezistencën serbe në veri të Kosovës.

B. SFIDAT E ZBARKIMIT

Nëse nuk planifikohen si duhet, aranzhimet për polici, gjykata dhe dogana do ta hendikepojnë EULEX-in, ndërsa edhe më shumë ZCN-së, e cila duket të ketë pak qasje apo kontroll në atë se çka i propozon OKB-ja Beogradit. BE-ja ka dy skaje brenda të cilave mund të zgjedhë se si të zbarkohet "në tërë Kosovën". Ajo ose mund të veprojë me vendosmëri, duke u mbështetur në autoritetin e vet si një organizatë në të cilën Serbia ka aspirata të hyjë, ose të qëndrojë mbrapa, duke u mbështetur në OKB-në që të negociojë për të praninë e saj në veri. Deri më tani, ajo ka zgjedhur qasjen e fundit. Në shkëmbim për "çadër të OKB-së", EULEX-i pret që eventualisht të jetë në gjendje të zbarkohet në tërë Kosovën. Mirëpo, është e paqartë se për sa kohë do të bashkëpunojë Prishtina në qoftë se nuk mund të vendosë autoritetin e saj në katër komunat dhe në enklava. Ajo nuk do të pranojë ndarjen e Kosovës në zona të BE-së dhe OKB-së: EULEX-i për shqiptarë, UNMIK-u për serbë.³¹⁴

1. Gjykatat

Më 16 korrik 2008 në Mitrovicën e veriut PSSP Zannier sugjeroi që gjykatat duhet të hapeshin, me gjykatës ndërkombëtarë që zbatonin ligjin e UNMIK-ut.³¹⁵ Argumentet praktike në favor të një aranzhimi të tillë janë se kjo do të restauronte një gjykatë funksionale dhe do të parandalonte konsolidimin e gjykatave serbe. Zannier-i nuk e specifikoi se a do të ishin gjykatësit dhe prokurorët nga UNMIK-u apo EULEX-i, por kjo e fundit e përkrahu me kujdes nismën e tij si mënyrë për të dërguar personelin e tij në veri. Tani Beogradi duket se ka pranuar nismën e UNMIK-ut që gjykatësit e kësaj të fundit të fillojnë punën në Mitrovicën e veriut.³¹⁶ Në çfarëdo forme finale, nisma po ashtu do të duhej të krijonte hapësirë për rifillimin e punës së gjykatësve vendorë, përkrah homologëve të tyre ndërkombëtarë. Këtu do të përfshihej një ristrukturim i gjykatës së Mitrovicës dhe më shumë gjykatës serbë të Kosovës. Prishtina mbase do ta gëlltiste një aranzhim të tillë nëse EULEX-i është pjesë e tij, por ka aversion ndaj zgjerimit të

³¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i Kosovës, Prishtinë, maj 2008

³¹⁵ Izedin Krasniqi, "Zannier kërkon gjykatë të UNMIK-ut në veri", *Koha Ditore*, 17 korrik 2008.

³¹⁶ Shih intervistën me zëvendësin e parë të PSSP-së David Harland, "Kthet rendi", *Express*, 23 shtator 2008.

gjykatave të UNMIK-ut. Do të duhej të caktohej një datë për rishqyrtim të çfarëdo marrëveshjeje mbi gjykatat e veriut. Kjo do të mund të inkorporohej në rishqyrtimin e parë të kompetencave të ZCN-së, dy vjet pas pavarësisë, në fillim të vitit 2010.³¹⁷ Beogradi dhe serbët e Kosovës së veriut nuk do të pranojnë përfshirjen e thjeshtë të kësaj zone në sistemin juridik të Kosovës, por mund të preferojnë dykuptimësinë e një aranzhimi tranzitor. Deri në fund të vitit 2008 ata mund të pranojnë një sistem të drejtuar nga EULEX-i, me një zyre të veçantë apelesh, të drejtuar nga EULEX-i në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Në fillim UNMIK-u dha përshtypjen se po konsideronte hapjen e gjykatave komunale nëpër enklavat serbe, me një gjykatë rajonale në shërbim të tyre.³¹⁸ Kjo ide tani është hedhur poshtë.³¹⁹ Por problemi shkon përtej gjykatave në formën e tyre fizike, në atë të vendosjes së çfarë ligji të zbatohet, nën cilin juridiksion shërbejnë ata, si dhe raporti me gjykatat e larta. Për shkak se serbët e Kosovës refuzojnë që të njohin ligjin e Kosovës, OKB-ja ka sugjeruar zbatimin e ligjit të UNMIK-ut në pjesët ku ata janë shumicë.³²⁰ Mund të ketë nevojë për legjislacion të veçantë që të bëjë urëzimin e të dyjave, mirëpo aprovimi i tyre në Kuvendin e Kosovës do të ishte shumë i vështirë.

2. Policia

Mbetet e paqartë se kush do të ketë autoritet final mbi policinë. Propozimi i Ban Ki-moon-it që serbët e ShPK-së t'i raportojnë policisë ndërkombëtare "nën autoritetin e përgjithshëm" të PSSP-së të OKB-së, mbetet shumë i mjegullt, dhe do të mund të thoshte që EULEX-i i përgjigjet drejtpërdrejtë atij zyrtari ose të

paktën selisë së OKB-së.³²¹ Sidoqoftë, puna e policisë është një fushë në të cilën ishte e qartë se OKB-ja do t'ia kalonte detyrat EULEX-it. OKB-ja dëshiron të heqë dorë nga përgjegjësia, e megjithatë duhet të jetë e kujdesshme që të mbrojë imazhin e rikonfigurimit dhe çadrën e OKB-së, sidomos karshi Ruisë kundërshtarë. Ajo po ashtu mund ta gjejë veten të kredhur në punë policore të cilat nuk i dëshiron, nëse dështojnë përpjekjet për të siguruar zbarkimin e EULEX-it në veri.

Sipas kushtetutës së Kosovës, policia do të ketë zinxhir të unifikuar komandues nëpër tërë vendin,³²² dhe do t'i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Kushtetuta, ligji i ri për policinë dhe plani i Ahtisaarit nuk flasin për autoritet më të lartë ndërkombëtar. EULEX-i është i mandatuar të "monitorojë, mentorojë dhe këshillojë", por ushtron një autoritet të limituar ekzekutiv.³²³ Për shkak të përgjegjësisë të Rezolutës 1244, disa presin që të paktën në fillim OKB-ja të ruajë disa prerogativa në udhëzime, dhe të ketë fjalën e fundit në policim, edhe pse BE-ja do të ofrojë shumicën apo të gjitha resurset e policisë ndërkombëtare pas rikonfigurimit, ndërsa qeveria e Kosovës do të vazhdojë, sikurse tani, që të financojë forcën vendore 7,000 anëtarëshe. In fakt, qeveria, EULEX-i apo UNMIK-u ende do të mund të udhëheqin policimin dhe të emëronin shefin e policisë pas rikonfigurimit. Dykuptimësia se kush ka autoritet final është anatëmë për policinë, e cila ka nevojë për një zinxhir të qartë komandues.

Edhe pse plani për rikonfigurim nënkupton se Policia e UNMIK-ut do të hapë rrugën gjithkund për EULEX-in,³²⁴ nuk duket se ajo do të ketë shkuar në tërësi deri në fund të procesit, në mënyrë ideale deri më 1 dhjetor 2008. Nëse kërcënohet siguria e zbarkim të EULEX-it në veri apo në enklava, ajo do të mbetet në vend. Vetë UNMIK-u ka planifikuar të mbajë 450 veta, si dhe komisionerin e vet të policisë dhe dy komandantë rajonalë, në rast se EULEX-i nuk mund të zbarkojë gjithkund. Edhe në një rast të tillë ai nuk dëshiron të mbyllet me

³¹⁷ Shih Propozimin Gjithpërfshirës të Ahtisaarit, Aneksi IX Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, Neni 5.

³¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, Zëvendëskryeministri Ramë Manaj, 18 korrik 2008.

³¹⁹ Për arsye të mira: ato do të kishin ndërhyrë në procedurën për krijimin e gjykatave të specifikuar në projekt-ligjin e Kosovës, ndërsa vetë gjykatat do të kishin qenë në jopërpunshmëri me organin e legjislaturës që hyri në fuqi më 15 qershor. Ato do ta kishin zgjatur mungesën e bashkëpunimit të enklavave me Prishtinën dhe ZCN-në dhe do të kishin penguar administrimin e unifikuar dhe implementimin e planit të Ahtisaarit, të cilat duhet të prodhojnë më shumë komuna me shumicë serbe, si dhe më shumë gjykata vendore, të udhëhequra nga serbët në Kosovë.

³²⁰ Të paktën në çështje kriminale, ekzistojnë pak diferenca ndërmjet ligjit të UNMIK-ut dhe atij të Kosovës, mirëpo ligji civil është më kompleks, sidomos po të kemi parasysh se gjykatat civile serbe të cilat zbatojnë ligjin serb, kanë vazhduar operimin e tyre në veri të Ibrit që nga viti 1999.

³²¹ Gjuha e Sekretarit të Përgjithshëm në raportin e 12 qershorit 2008 mbi vijimin e mbikëqyrjes nga OKB-ja ishte më specifike sa i përket policimit sesa çfarëdo fushe tjetër. Letra e tij shitesë drejtuar Tadiqit thoshte, "Shërbimi Policor i Kosovës që operon në pjesët relevante me shumicë serbe duhet t'i raportojë policisë ndërkombëtare nën autoritetin e përgjithshëm të Përfaqësuesit tim Special".

³²² Kushtetuta e Kosovës, Neni 128.

³²³ Shih Nenin 3 (a) të Veprimeve të Përbashkëta të BE-së, mbi Misionin e Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX Kosova, Bruksel, 2008/124/CFSP, 4 shkurt 2008.

³²⁴ PSSP Zannier nuk dëshiron që Kosova të ndahet në mes të policisë së UNMIK-ut dhe EULEX-it, në veri dhe në jug të Ibrit.

policim vetëm në veri. Çfarëdo përpjekje për të balancuar mbajtjen e komandantit të policisë rajonale në Mitrovicë me riemërimin e një komandanti në rajonin e Prishtinës, është jorealiste.³²⁵ Nëse ShPK-ja bie në një situatë ku policia në pjesët me shumicë serbe mbetet nën autoritetin e UNMIK-ut, ndërsa pjesa tjetër punon nën Prishtinën dhe EULEX-in, do të zhbëhen vite të tëra krijimi të një institucioni relativisht multi-etnik.

OKB-ja dhe BE-ja ende duhet të vendosin së bashku se a vlejné aranzhimet speciale për pjesët me shumicë serbe në tërë Kosovën apo vetëm në veri. UNMIK-u do të mund të vendoste serbët e ShPK-së nën komandën ndërkombëtare në “pjesët relevante me shumicë serbe”, mirëpo duhet të punohet drejt bashkëpunimit propavarësisë në mes Prishtinës dhe policisë në enklava, dhe jo të cenohet ky bashkëpunim. Mekanizmat speciale raportuese për ShPK-në në pjesët me shumicë serbe në veri nuk duhet të shtrihen edhe në jug, përveç nëse kjo është mënyra e vetme e ruajtjes së një policie të unifikuar të Kosovës.

Të paktën për një kohë të përkohshme, është esenciale vendosja e një komandanti ndërkombëtar në veri të Ibrit. Pa këtë ShPK-ja serbe gjysmë e distancuar do të ndante hallkat e fundit të saj me Prishtinën. Komandanti i veriut duhet të jetë i emëruar nga EULEX-i, por kjo duhet të mirret në shqyrtim pas një viti, në pritje të transferimit të këtij posti të një zyrtar kombëtar. Pasi që policia rajonale e Mitrovicës akoma nuk i është transferuar komandës rajonale, kjo nuk do të trazonte strukturën ekzistuese të ShPK-së, por do të pengonte zhvillimin e saj. EULEX-i duhet të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi me qeverinë e Kosovës, që do të definonte rolin e komandantit ndërkombëtar. Kjo do t’ia shtonte mandatin kosovar mandatit ekzistues të 1244-shit të komandantit të Mitrovicës, sado të përafërt, me ligjin e policisë së Kosovës.³²⁶

Enklavat paraqesin problem më të rëndë. Shumica e serbëve të ShPK-së në enklavën qendrore të Graçanicës dhe në enklavat lindore, 300 nga 800 serbët e ShPK-së, janë duke bojkotuar që nga shkurti 2008, duke kërkuar që t’i raportojnë zinxhirit komandues të OKB-së, edhe pse këto rajone policore (Prishtina dhe

Gjilani) ishin transferuar në zinxhirin komandues kombëtar të ShPK-së para disa viteve dhe kishin funksionuar mirë deri në pavarësi. Edhe nëse këta oficerë serbë pajtohen që t’i raportojnë eprorëve të EULEX-it dhe të zbatojnë ligjin e Kosovës e jo të UNMIK-ut, riinstalimi i zinxhirit komandues ndërkombëtar do ta vendoste ShPK-në në një situatë ku ajo kishte qenë para 17 shkurtit.

Do të ishte më mirë që të mbaheshin këta oficerë serbë sesa të largoheshin nga puna, por me këtë nuk guxon të ndërtohet një precedent që do të mund të shfrytëzohej nga serbët e ShPK-së, si për shembull ata në Shtërpce. Nëse stacionet policore në ato pjesë lejohen që të anashkalojnë eprorët e tyre dhe t’i raportojnë ndërkombëtarëve, kjo do të fragmentonte shërbimin dhe do të keqësonte sigurinë, sidomos në enklava. Zëvendësimi i komandantëve kombëtarë me ata të EULEX-it në dy zonat e prekura, Prishtinë dhe Gjilan, do të ishte edhe më pak i mundshëm politikisht për qeverinë, pasi që do të vendoste prapë shumë shqiptarë nën komandën ndërkombëtare, dhe do të trazonte misionin monitorues dhe mentorues të EULEX-it.

Kompromisi më i mundshëm është që EULEX-i të ndërtojë një strukturë konsultimi të dedikuar për serbët e ShPK-së në Graçanicë, në enklavat lindore dhe Shtërpce, që për një periudhë fillestare deri në një vjet të luajnë rolin e ndërmjetësuesit opsional, edhe me komandantët e tyre rajonalë të ShPK-së edhe me liderhipin e EULEX-it. Kjo nuk do të ishte strukturë e mirëfilltë komanduese, por do t’ua mundësonte oficerëve serbë që të kthehen apo të vijojnë me shërbimin e tyre.

3. Doganat

OKB-ja i kishte ikur detyrës së ballafaqimit me dy portat e prishura në veri që nga 19 shkurti, derisa Kosova dhe Serbia janë duke humbur në të ardhura. Edhe kontrolli i kufirit edhe ndalimi i humbjeve në të ardhura janë të rëndësishme për Prishtinën, e cila merr 70 për qind të buxhetit të saj nga të ardhurat në dogana. Për Serbinë është i neveritshëm një kufi funksional që ndan Kosovën dhe popullatën kompakte serbe lart Ibrit, edhe pse trajtimi i Kosovës si hapësirë e ndarë doganore është praktike (dhe kështu mendohet edhe nga BE-ja),³²⁷ ndërsa humbja e kontrollit të doganave në Kosovën e veriut tani dëmton edhe vetë Serbinë. Qeveria e re e udhëhequr nga DS-ja do të jetë më sensitive ndaj kësaj sesa që ishte paraardhësja e saj e udhëhequr nga DSS-ja. Serbët e veriut të Kosovës refuzojnë çfarëdo

³²⁵ Një dispozitë e planit të hershëm për rikonfigurimin e UNMIK-ut. Informata e dhënë Grupit të Krizave dhe intervistat, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, korrik 2008.

³²⁶ Ligji definon qartësisht strukturën komanduese të policisë, duke mos lënë hapësirë për komandantë ndërkombëtarë jashtë zinxhirit komandues të ShPK-së, por Neni 9, mbi “bashkëpunimin ndërkombëtar”, ia jepë policisë hapësirën që të “bashkëpunojë me organizatat ndërkombëtare të policisë... në përputhje... me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat është nënshkruese shteti i Kosovës”.

³²⁷ Një aranzhim i tillë ka ekzistuar para pavarësisë së Kosovës.

ndërmjetësimi nga Prishtina në mes tyre dhe Serbisë, por mbase do të mund të bënin kompromis: pa poste doganore në kufijtë e veriut, por në poste kyçe brenda Kosovës; shumica e të ardhurave t'u shpërndahet komunave lokale, jo Prishtinës.³²⁸

Plani për rikonfigurim i Ban-it ia jepë detyrën PSSP-së Zannier që të “vendosë... një strukturë organizative që i lejon Kosovës të vazhdojë të funksionojë si një rajon i vetëm doganor”, duke pranuar kontributin e gjithë “hisedarëve relevantë”. Ai planifikon zyrtarë ndërkombëtarë të doganave në “pikat relevante doganore.”³²⁹ Sugjerimi që u duk se e bëri Zannier-i në fund të korrikut për një zonë të ndarë doganore të llojit të Hong Kongut, nuk përfitoi nga konsultimet me ekspertët apo hisedarët doganorë të UNMIK-ut, përfshirë dhe BE-në dhe Marrëveshjen për Tregi të Lirë në Evropën Qendore (CEFTA), dhe që atëherë ai ka riinterpretuar deklaratën e tij të mëhershme duke ripohuar nevojën e Kosovës që të vazhdojë të funksionojë si një zonë e vetme doganore.³³⁰

Prishtina dhe OKB-ja presin që EULEX-i të marrë përsipër doganat në veri në fund të rikonfigurimit, por zyrtarët e BE-së pajtohen se “do të jetë shumë vështirë të bëjmë diçka që UNMIK-u nuk ka mundur ta bëjë”.³³¹ UNMIK-u vetëm se ka folur për rizbarkimin e stafit doganor me mbrojtje nga KFOR-i. Gjatë 120 ditëve të para NATO-ja dhe KFOR-i premtoan të përgatisin një plan brenda tetë javësh për të rivendosur kontrollin dhe buxhetin e doganave për trupat e nevojshme, pajisjet dhe instalimet, për të arritur siguri për transport dhe aktivitete të tri ndërrimeve të zyrtarëve doganorë ndërkombëtarë. Në parim ata qëndrojnë të gatshëm ta bëjnë këtë, por kanë frikë që pasoja e kësaj do të ishte dhuna, e pasuar me evakuim nga EULEX-i.³³² Shumica e shteteve anëtare të BE-së besojnë se kthimi i Kosovës në një zonë të vetme

doganore “është një prioritet në një plan shumë afatghatë... Askush, as edhe vetë britanikët, nuk janë të gatshëm që të rrezikojnë jetët e tyre për dogana në Kosovë”.³³³ Por as qeveria e re e Serbisë nuk është e përgatitur të humbasë jetë për postet doganore, dhe të paktën flet rreth mundësisë së rivendosjes së tyre.³³⁴

Në këto rrethana, bisedimet OKB-Beograd mund të zhvillohen drejt arritjes së një kompromisi ku doganat e EULEX-it do të monitoronin zyrtarët serbë, të rekrutuar në një njësit të ri të shërbimit doganor të Kosovës nën komandën e EULEX-it, që do të administronte komunikacionin komercial nëpërmjet dy portave. Regjimi i doganave në veri do të mund të theksonte përdorimin e depove të doganave, të vendosura larg kufirit (në Zubin Potok dhe Leposaviq, si u pat propozuar UNMIK-u kryetarëve të komunave më 2006), dhe të mblidhte pagesat nën kodin doganor të Kosovës, që të distribuohet sipas një formule buxhetit të Kosovës dhe katër komunave në veri të Ibrit. Ky aranzhim do të mund të shqyrtohej në fillim të vitit 2010 (kur parashikohet shqyrtimi i parë i kompetencave të ZCN-së), në mënyrë që eventualisht të përputhet plotësisht në një zonë të vetme doganore. Pjesa që i takon katër komunave duhet të jetë në ekuacion me grantet që u takojnë atyre nga Prishtina, të cilat ata i refuzojnë.³³⁵

Ky kompromis do të rivendoste lidhje paksa në mes të katër komunave dhe buxhetit të Kosovës, duke minimizuar potencialin për aranzhime të trazimit të atij buxheti, në rast të ndryshimit të vëllimit të komunikacionit komercial apo mbështetjes në pagesa doganore në vitet e ardhshme. Kjo do t'i mbante të kënaqur serbët e veriut duke e mbajtur Prishtinën në distancë dhe duke u dhënë atyre hise në mbledhjen e doganave, Beogradin duke e mbyllur vrimën e zezë doganore por duke mos e njohur simbolikën e pavarësisë së Kosovës, dhe Prishtinën duke mbyllur

³²⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, Nebojsa Miniq, lider i degës së DSS-së, Mitrovicë e veriut, 30 maj 2008.

³²⁹ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un, 12 qershor 2008. Gjatë 120 ditëve të para pas pavarësisë, UNMIK-u kërkoi nga EULEX-i që të ofrojë këta oficerë. Gjashtë ishin të kontraktuar dhe vazhdojnë të jenë të huazuar te UNMIK-u, por nuk janë vendosur në terren. Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtar, Prishtinë, maj-korrik 2008.

³³⁰ Konferencë për shtyp, Prishtinë, 20 gusht 2008.

³³¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, korrik 2008.

³³² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të KFOR-it dhe NATO-s, maj-korrik 2008. KFOR-i nuk ka mandat nga Këshilli i NATO-s që të marrë përsipër detyra në polici apo dogana, por heshturazi ka filluar planet për çdo eventualitet nëse UNMIK-u thjesht largohet nga veriu, gjë që me siguri do të sillte deri te kolapsi i ShPK-së atje. Në atë rast KFOR-i të paktën do të ofronte policim bazik të llojit të rendit publik.

³³³ Intervistë e Grupit të Krizave, përfaqësues i Komisionit për Ballkanin Perëndimor (COWEB) të një shteti anëtar të BE-së, Bruksel, 8 korrik 2008. MB-të janë të vetme në mesin e shteteve anëtare të BE-së në qëndrimin e tyre për të dërguar zyrtarë ndërkombëtarë të doganave në dy portat veriore me mbështetje nga KFOR-i dhe pa kërkuar pëlqimin paraprak as nga Beogradi e as nga serbët e Kosovës.

³³⁴ Ivanoviqi në intervistë në *Koha Ditore*, 24 gusht 2008. Por privatisht qeveria serbe kërkon kohë për të zbutur armiqësinë dhe reagimet e tepërta të mundshme të KNS-së dhe serbëve lokalë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 14 gusht 2008.

³³⁵ Fondet mund të mblidheshin dhe të depozitoheshin ashtu si në portat e tjera, ndërsa përqindja e komunave veriore llogaritej dhe paguhej nëpërmjet një xhirollogarie ndërmjetësuese me status neutral, ose Fondi i Konsoliduar për Kosovë i UNMIK-ut, ose një xhirollogari e re e BE-së.

hemorragjinë e të ardhurave dhe duke e lidhur veriun më afër me sistemin doganor të Kosovës pas një periudhe të shkurtër.

4. Administrata civile

Task forca, i krijuar nga UNMIK-u më 2 korrik 2008, pyeti shefat e departamenteve dhe rajoneve që të jepnin arsyet për stafin që ata dëshironin të mbanin, dhe në mes të korrikut ia dorëzoi Nju Jorkut planin për largimin nga puna të 40 deri 70 përqind të stafit jopolicor, ndoshta deri kah tetori. OKB-ja tani pret të zvogëlojë UNMIK-un për 70 përqind deri në nëntor, ose të paktën deri në fund të vitit 2008.³³⁶ Deri atëherë, nga 2,000 anëtarë të Policisë së UNMIK-ut duhet të mbesin 450. Parashihet edhe një zvogëlim i departamentit të drejtësisë së UNMIK-ut, nga 177 në 14 deri në fund të 120 ditëshit, por kjo mund të ndryshojë nëse PSSP-ja arrin një marrëveshje me Beogradin për rihapjen e gjyqeve në veri nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut. UNMIK-u po ashtu pret që reduktimet në polici dhe drejtësi të bëhen me vijimin e dialogut me EULEX-in.³³⁷

Reduktimet e propozuara të task forcës dhe nënshtrimi i departamentit të administratës civile (DCA) të UNMIK-ut ndaj zyres për çështje politike krijoi një debat të gjallë. Më parë DCA ishte “Shtylla e dytë” e UNMIK-ut dhe mban struktura në pesë ish-rajonet administrative të Kosovës. E tërhequr nga roli i saj paraprak për udhëzimin e administratës komunale në tërë Kosovën, ajo ka ruajtur prani në pjesë me popullatë pakicë – shumica serbë por edhe shqiptarë në disa vende – monitoron situatën e tyre dhe vepron si ndërmjetësues në mes tyre dhe shumicës. Koncepti për “zgjidhjen e problemeve” i PSSP-së Zannier ka ndikuar në rekomandimin e task forcës që e ardhmja e UNMIK-ut mund të shtyhet përtej monitorimit dhe raportimit të zyreve mbi zgjidhjen e problemeve.³³⁸ Derisa UNMIK-u do të mbajë zyrat e saj në

terren në Pejë, Graçanicë dhe Shtërpce, si dhe përfaqësim rajonal në Mitrovicë, tani ai ka propozuar që struktura në terren e misionit të OSBE-së të marrë përsipër pjesën dërrmuese të kësaj detyre.³³⁹ Do të ishte më mirë që këtë prani ta mbushë prania në terren e ZCN-së, por asaj ende i mungon përkrahja e nevojshme politike.

Përfaqësia e DCA-së së UNMIK-ut në Mitrovicë është prania më e madhe e saj në terren. Ajo ka ofruar (shumica staf lokal serb) administrim të përkohshëm në Mitrovicën e veriut, ndërsa kryesuesi i saj, ish diplomat amerikan Gerard Gallucci, ka bërë beteja politike me shefat e UNMIK-ut, Joakim Ruker dhe Lerry Rosin, gjatë 120 ditëve të para pas pavarësisë. Ai kundërshtoi përdorimin e forcës ndërkombëtare për të ruajtur apo imponuar institucionet e Kosovës të refuzuara nga serbët lokalë. Sekretariati i OKB-së i largoi nga puna armiqtë e Galluccit që ishin “pro-Prishtinës” në mes të korrikut, ndërsa atë e mbajtën në Mitrovicë, që ishte shumë e pakëndshme për zyrtarët e Pesëshes dhe BE-së. Raportet e tij me zyrën e ZCN-së në Mitrovicë janë të tendosura, dhe ai refuzoi që t’ia prezantonte task forcës planin e tij për rikonfigurim.³⁴⁰ Task forca nuk propozoi tkurrjen e stafit 50 anëtarësh, por rekomandoi që kah gjysma e periudhës së rikonfigurimit PSSP-ja të emërojë një panelë, të përkrahur nga përfaqësuesi i DPKO-së në Nju Jork, për të shqyrtuar funksionet dhe nivelet e stafit.³⁴¹ Kjo tani mund të ndodhë, pasi një zyrtar i lartë i DPKO-së u emërua zëvendësues i përkohshëm i UNMIK-ut në fillim të shtatorit.³⁴²

Edhe pse PSSP-ja dëshiron që dy proceset t’i mbajë të veçuara, ai mund të ketë nevojë për riaranzhime për të akomoduar rezultatet e negociatave të tij me Beogradin. Serbia do që UNMIK-u të vazhdojë të qëndrojë me numër të madh, dhe insiston se ai është ndërmjetësuesi dhe partneri i vetëm civil ndërkombëtar në Kosovë, të paktës derisa të vendoset ndryshe nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Ajo sidomos do të pëlqente një operator me status neutral, në detyrë të një roli të “intervenimit të butë”, në mënyrë që të mos lirohet asnjë hapësirë për ZCN-së. Në negociata me BE-në, OKB-ja ka refuzuar të dorëzojë bazën logjistike në perëndim të Kosovës, duke dhënë kështu indikacione se pret të mbajë të paktën një pjesë të stafit të saj.

³³⁶ Deklaratë nga zëdhënësi i UNMIK-ut Aleksander Ivanko, Prishtinë, 11 gusht 2008, dhe letër për shtyp i UNMIK-ut, “SRSG on UNMIK’s reconfiguration” [“PSSP-ja mbi rikonfigurimin e UNMIK-ut”], 19 shtator 2008.

³³⁷ Informatat mbi planet për rikonfigurimin e UNMIK-ut i dhanë Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, 23 korrik 2008.

³³⁸ Para se të kundërshtohet, DCA-ja u rezistoi ca kursimeve të propozuara, dhe rekomandoi që roli i butë ndërmjetësues dhe intervenues të futet në UNMIK-un e rikonfiguruar dhe të mbahet i pavarur nga zyra për çështje politike, në mënyrë që puna e saj prej “ndërmjetësuesi të ndershem” në terren të mbetet e padamkosur nga agjendat politike. Po aty. Kjo do ta kishte ngrirë ZCN-në dhe vetë do të kishte qenë politike, pasi që i ashtuqajturit ndërmjetësim i DCA-së do të operonte pa referencë apo njohje të qeverisë së Kosovës.

³³⁹ Shih “UNMIK downsizing” [“Zvogëlimi i UNMIK-ut”], letër për shtyp e OSBE-së.

³⁴⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat, Prishtinë, 22 korrik 2008.

³⁴¹ Informatat mbi planet për rikonfigurimin e UNMIK-ut i dhanë Grupit të Krizave, Prishtinë, 23 korrik 2008.

³⁴² David Harland, kryesues i Drejtoratit për Evropë dhe Amerikë Latine.

Në fund, sfida e vërtetë do të jetë veriu dhe enklavat me shumicë serbe në jug, ku të paktën në fillim OKB-ja dhe EULEX-i do të punojnë për së afërmi. Sa më herët që BE-ja të mund të përfshihet në bisedimet e OKB-së me Beogradin në të gjashtë fushat, aq më mirë, në mënyrë që të shmangët zbarkimi dhe operimi i BE-së pa negociata paraprake. Një nga shkaqet kryesore të vonesës së zbarkimit të EULEX-it ka qenë mbështetja e tepërt në OKB-në. Lejimi i OKB-së që të marrë rolin udhëheqës në negociatat me Serbinë rrezikon të pengojë hapësirën për manovrim të EULEX-it në pjesët me shumicë serbe të Kosovës për shumë vite të tjera në vijim.

Prishtinë/Bruksel, 25 shtator 2008

ANEKSI A

HARTA E KOSOVËS DHE RAJONI



ANEKSI B

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, parti politike shqiptare e Kosovës, e udhëhequr nga ish-komandanti i UÇK-së dhe ish-Kryeministri i IPVQ-së Ramush Haradinaj
AKR	Aleanca për Kosovën e Re, parti e re politike shqiptare e Kosovës, e krijuar nga magnati i Behgjet Pacolli
BBC	Shërbimi Transmetues Britanik
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim, parti politike shqiptare e Maqedonisë, e udhëhequr nga Ali Ahmeti
CCK (QKK)	Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi, degë e qeverisë së Serbisë në Kosovë
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
CFSP	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë e BE-së
Grupi i Kontaktit	Grup gjashtë-kombësh që udhëheqë me politikën në Ballkan: Franca, Gjermania, Italia, Rusia, MB-të dhe SHBA-të
COWEB	Komisioni për Ballkanin Perëndimor i BE-së
DCA	Departamenti për Administratë Civile i UNMIK-ut
DS	Partia Demokratike, e udhëhequr nga Presidenti i Serbisë Boris Tadiq
DSS	Partia Demokratike e Serbisë, e udhëhequr nga ish-Kryeministri Vojislav Koshtunica
DPKO	Departamenti për Operacione Paqeruajtëse i OKB-së
ESDP (PESM)	Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje
EUSR (PSBE)	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
EU (BE)	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë
G17+	Parti politike serbe, në aleancë me DS-në, e udhëhequr nga Mladjan Dinkiç
GAERC (KÇPMJ)	Këshilli i BE-së për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme
GDR (RDGj)	Republika Demokratike Gjermane, ish-Gjermania Lindore
ICO (ZCN)	Zyra Civile Ndërkombëtare
ICR (PCN)	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, shefi i ZCN-së
ICJ (GjND)	Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi
ICTY	Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë
ISG (GUN)	Grupi Udhëheqës Ndërkombëtar, udhëheqë punën e PCN-së
IMF (FMN)	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IMP (PUN)	Prania Ushtarake Ndërkombëtare, emri i ri i propozuar për KFOR-in në planin e Ahtisaarit, i cili nuk është miratuar
KPC (TMK)	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, trup kuazi-ushtarak, civil për emergjenca, që ka buruar nga UÇK-ja
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës, ndërmarrja publike elektrike
KFOR	Forca e Kosovës (e NATO-s)
KGB	Ish-Shërbimi Sekret Sovjetik
KLA (UÇK)	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPS (ShPK)	Shërbimi Policor i Kosovës
KSF (FSK)	Forca e Sigurisë së Kosovës, të krijuar nën planin e Ahtisaarit
K-SHIK	Agjenci jozyrtare e inteligjencës e shqiptarëve të Kosovës, e asociuar me PDK-në
KTA (AKM)	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë, parti shqiptare e Kosovës, e formuar nga Nexhat Daci pas ndarjes nga LDK-ja më 2007
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës, parti politike shqiptare e Kosovës, e udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova deri në vdekjen e tij më 2006, tani e udhëhequr nga Presidenti Fatmir Sejdiu

MNTF	Task Forca Shumëkombëshe, pesë brigadat rajonale të KFOR-it
MCA	Këshilla Ushtarake Civile, divizion i ri KFOR-it që do të mbikëqyrë shpërbërjen e TMK-së dhe krijimin e FSK-së
MTEF (KShA)	Korniza për Shpenzime Afatmesme, e miratuar nga qeveria e Kosovës
MUP	Ministria e Brendshme e Serbisë
NATO	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik
NS	Serbia e Re, parti politike në aleancë me DSS-në e Koshtunicës, e udhëhequr nga Velimir Iliq
OSCE (OSBE)	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PAK (AKP)	Agjencia Kosovare për Privatizim, trashëgimtarja e AKM-së
PDK	Partia Demokratike e Kosovës, parti shqiptare e Kosovës, e udhëhequr nga ish-komandanti i UÇK-së dhe Kryeministri aktual Hashim Thaçi
PDSH	Partia Demokratike e Shqiptarëve, parti politike e shqiptarëve të Maqedonisë, e udhëhequr nga Menduh Thaçi
PISG (IPVQ)	Insitucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, qeveria e Kosovës në sistemin e UNMIK-ut, para pavarësisë
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
Quint (Pesëshja)	Grupi i Kontaktit minus Rusia
SAA (MSA)	Marrëveshja për Stabilizim-Asociim, traktat bilateral në mes të BE-së dhe një vendi i cili kërkon anëtarësim, pararendëse e statusit të kandidatit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës, transmetues publik
SAP (PSA)	Procesi i Stabilizim-Asociimit, që çon deri në përmbyllje të MSA-së
SRS (PSSP)	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
SNC (KNS)	Këshilli Nacional Serb-Veri, grup politik radikal i serbëve të Kosovës, i udhëhequr nga Dr Marko Jakshiq, i asociuar afër me DSS-në e Serbisë
SPS	Partia Socialiste e Serbisë, më parë e udhëhequr nga Slllobodan Millosheviq, tani partneri i vogël në qeverinë e koalicionit me DS-në
SRS	Partia Radikale Serbe, parti radikale nacionaliste, e themeluar nga Vojisllav Sheshel
SLS	Partia Liberale Serbe, parti e vogël e serbëve të Kosovës që i është bashkangjitur qeverisë së Kosovës
“Troika” (“Treshja”)	Treshja e diplomatëve SHBA, BE dhe Rusi, që u mundua të ndërmjetësojë në mes Kosovës dhe Serbisë në gjysmën e dytë të vitit 2007
UN (OKB)	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i OKB-së
UNGA (APOKB)	Asambleja e Përgjithshme e OKB-së
UNSC (KSOKB)	Këshilli i Sigurimit i OKB-së
UNSCR (RKSOKB)	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së
UNSCR 1244	Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 10 qershor 1999
UNSG (SPOKB)	Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Administratës së OKB-së në Kosovë
UNMEE	Misionet e OKB-së në Etiopi dhe Eritre
VAT (TVSh)	Taksa mbi vlerën e shtuar